



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport përfundimtar i auditimit tematik “Mbi vlerësimin e ecurisë, performancës dhe efektivitetit të masave të marra në lidhje me borxhin tatimor”

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT TEMATIK

“Mbi vlerësimin e ecurisë, performancës dhe efektivitetit të masave të marra në lidhje me borxhin tatimor”

Tiranë, korrik 2025

PËRMBAJTJA

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	3
I.1. Përshkrim i shkurtër i Raportit të Auditimit	3
II. HYRJA	5
a. Objektivat dhe qëllimi	6
b. Identifikimi i çështjes	6
c. Përgjegjësitë e Strukturave Drejtuese	6
d. Përgjegjësia e Audituesve të KLSH:	6
e. Kriteret e vlerësimit:	7
f. Standardet e Auditimit	7
g) Metodatat e auditimit	7
h) Dokumentimi i auditimit	8
III. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT	8
1. Informacion i Përgjithshëm	8
2. Përshkrimi i auditimit, sipas drejtimeve të auditimit	11
2.1 Mbi vlerësimin e nivelit të borxhit tatimor, ecuria e detyrimeve të papaguara për periudhën objekt auditimi, sipas drejtorive rajonale	11
-Mbi analizimin e detyrimeve tatimore sipas statusit të tatimpaguesit;	
-Mbi analizimin e detyrimeve tatimore të ndara sipas pronësisë;	
-Mbi analizimin e detyrimeve sipas llojit të tatimit, i ndarë në principal/gjobë/interesa dhe mosha e tyre;	
-Mbi evidentimin dhe raportimin mujor i detyrimeve për veprime të mëtejshme nga sektorët përkatës;	
-Mbi vlerësimin e masave shtrënguese të marra për mbledhjen e detyrimeve tatimore të papaguara;	
2.1.1. Drejtoria e Mbledhjes së Detyrimeve Tatimore të Papaguara në Rajonin Qendror	13
2.1.2. Drejtoria e Mbledhjes së Detyrimeve Tatimore të Papaguara në Rajonin Jugor	22
2.1.3. Drejtoria e Mbledhjes së Detyrimeve Tatimore të Papaguara në Rajonin Verior	33
2.1.4. Drejtoria e Mbledhjes së Detyrimeve Tatimore të Papaguara në Drejtorinë e Tatimpaguesëve të Mëdhenj	45
IV. GJETJET DHE REKOMANDIMET	54

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

I.1. Përshkrim i shkurtër i Raportit të Auditimit.

a. Mbështetur në ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Mbi organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, si dhe bazuar në Programin e Auditimit nr. 23/1, datë 17.01.2025, Kontrolli i Lartë i Shtetit (këtu e në vazhdim KLSH) kreu auditimin tematik “Mbi vlerësimin e ecurisë, performancës dhe efektivitetit të masave të marra në lidhje me borxhin tatimor” për periudhën 01.01.2024 deri me datën 31.12.2024. Auditimi u ushtrua në Drejtorinë e Përgjithshme e Tatimeve, Drejtorinë e Mbledhjes së Detyrimeve Tatimore të Papaguara në Rajonin Qendror, Drejtorinë e Mbledhjes së Detyrimeve Tatimore të Papaguara në Rajonin Jugor, Drejtorinë e Mbledhjes së Detyrimeve Tatimore të Papaguara në Rajonin Verior dhe Drejtorinë e Mbledhjes së Detyrimeve Tatimore të Papaguara në Drejtorinë e Tatimpaguesëve të Mëdhenj.

b. Rëndësia e auditimit.

Auditimi tematik “Mbi vlerësimin e ecurisë, performancës dhe efektivitetit të masave të marra në lidhje me borxhin tatimor” i kryer në Drejtorinë e Mbledhjes së Detyrimeve Tatimore të Papaguara është realizuar në mbështetje të planit vjetor të miratuar nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit për vitin 2025. Ky auditim ka një rëndësi të veçantë në vlerësimin e ecurisë dhe performancës së administratës tatimore në drejtim të evidentimit, ndjekjes dhe mbledhjes së borxhit tatimor, në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi dhe udhëzimet metodologjike të DPT. Përmes këtij auditimi synohet forcimi i transparencës institucionale, përmirësimi i menaxhimit të të ardhurave publike dhe sigurimi i një mbikëqyrjeje efektive mbi strukturat përkatëse, me qëllim rritjen e efektivitetit dhe uljen e riskut fiskal për buxhetin e shtetit.

c. Qëllimi i auditimit

Qëllimi i këtij auditimi ishte dhënia e një konkluzioni mbi vlerësimin e ecurisë, performancës dhe efektivitetit të masave të marra në lidhje me borxhin tatimor në Republikën e Shqipërisë. Për të gjitha problematikat e konstatuara janë dhënë gjetje e rekomandime për përmirësime me synim ndërmarrjen e masave dhe veprimeve korrigjuese nga strukturat përkatëse. Në përmbushje të qëllimit të auditimit janë shqyrtuar çështjet e mëposhtme:

- *Vlerësimi i nivelit të borxhit tatimor, ecuria e detyrimeve të papaguara për periudhën objekt auditimi, sipas drejtorive rajonale.*
- *Analizimi i detyrimeve tatimore sipas statusit të tatimpaguesit, sipas pronësisë, sipas llojit të tatimit, i ndarë në principal/gjobë/interesa dhe mosha e tyre.*
- *Evidentimi dhe raportimi mujor i detyrimeve për veprime të mëtejshme nga sektorët përkatës.*
- *Vlerësimi i masave shtrënguese të marra për mbledhjen e detyrimeve tatimore të papaguara, etj.*

d. Metodologjia e përdorur dhe metodat e mbledhjes së të dhënave.

Realizimi i këtij auditimi u bazua në metodologjinë e auditimit të përcaktuar në Rregulloren e Procedurave të Auditimit në KLSH miratuar me Vendimin e Kryetarit nr. 7, datë 17.01.2024, si verifikimi i procedurave të ndjekura, është marrë informacioni për një rrethanë ose transaksion nga dy burime duke kryer krahasueshmërinë e tyre; Intervistimi, është përdorur intervistimi verbal i marrjes së informacionit nëpërmjet pyetjeve drejtuar personelit kyç të subjektit që auditohet; Raporte dhe informacione, janë shfrytëzuar raporte, analiza dhe informacione të cilat lidhen me objektivat e auditimit dhe problemet që lidhen me të.

e. Nga shqyrtimi i evidencave rezultoi se Insitucionet për periudhën në auditim, paraqet të meta dhe mangësi në disa prej drejtimeve të veprimtarisë. Grupi i auditimit ka konstatuar 7 gjetje/masa organizative dhe ka rekomanduar 13 masa.

g. Gjetjet kryesore të rezultuara nga auditimi vijojnë si më poshtë:

- Procesi i ndjekjes dhe ekzekutimit të masave shtrënguese nga administrata tatimore është kryer në mënyrë të fragmentuar, pa pasqyrim të plotë në sistemin elektronik dhe pa dokumentim të standardizuar,

duke ulur efektivitetin e mbledhjes së detyrimeve me forcë.

- Evidentimi dhe raportimi i borxhit tatimor është realizuar në mungesë të një metodologjie të standardizuar, me përpunim manual të të dhënave dhe mungesë krahasueshmërie ndërinstitucionale, duke ndikuar në saktësinë dhe integritetin e informacionit financiar.

- Në raportimet për borxhin tatimor të papaguar në datën 31.12.2024 nuk janë përfshirë detyrime për tatimpagues që kanë kryer pagesa për periudha të mëparshme, për shkak të mungesës së deklarimit, çka ka sjellë nënvlerësim të konsiderueshëm të borxhit të raportuar, **në vlerën 174,894,747 lekë për TVSH-në** dhe në vlerën **205,085,119 lekë për kontributet e sigurimeve**.

- Akt-marrëveshjet për pagesë me këste janë trajtuar pa një format të unifikuar, me regjistrime të paplota dhe pasaktësi në ndarjen e detyrimeve, duke penguar ndjekjen e saktë të performancës së këtyre marrëveshjeve dhe ndikimin e tyre në uljen e borxhit.

- Pjesa dërmuese e stokut të borxhit tatimor, rreth 81.8%, përbëhet nga detyrime me moshë mbi dy vjet, duke përfaqësuar risk të lartë për mosarkëtim dhe duke rritur mundësinë e parashkrimit ligjor të këtyre detyrimeve.

- Gjobat dhe interesat e llogaritura nga sistemi nuk janë pasqyruar si detyrime zyrtare në evidencat e sistemit C@TS, gjë që ka sjellë pasaktësi në raportimet analitike dhe nënvlerësim të stokut real të borxhit tatimor në vlerën 71,694 mijë lekë.

h.Paraqitja e rekomandimeve kryesore:

Me qëllim zgjidhjen e problematikave, janë dhënë disa rekomandime si vijon:

1.1. DMDPT të marrë masa për përmirësimin e ndjekjes dhe dokumentimit të masave shtrënguese, duke siguruar pasqyrimin e plotë dhe në kohë të të gjitha masave shtrënguese në sistemin C@TS, me qëllim garantimin e saktësinë së të dhënave për monitorimi dhe raportimi; përmirësimin dhe përditësimin në mënyrë të vazhdueshëm të regjistrimit të masave shtrënguese, duke përfshirë të dhëna të detajuara për secilin tatimpagues dhe për çdo masë të aplikuar; përfshirjen në raportimet mujore edhe vlerat e arkëtuara nga masat shtrënguese, pavarësisht muajit të pagesës/ arkëtimit, për të reflektuar ndikimin real të tyre në uljen e borxhit tatimor dhe rritjen e disiplinës fiskale/përmirësimin e përmbushjes së detyrimeve tatimore.

2.1. DPT të marrë masa për përmirësimin e funksionalitetit të sistemit C@TS për të mundësuar përpunimin automatik të të dhënave mbi borxhin dhe për të eliminuar nevojën për ndërhyrje manuale të databazës, DPT të marrë masa që DMDPT në bashkëpunim me drejtorinë e teknologjisë së informacionit ti mundësohet akses dhe analizë të përbashkët të të dhënave në kohë reale, me qëllim raportim të saktë dhe të krahasueshëm ndërmjet strukturave të administratës tatimore.

3.1. Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, të marrë masat për ngritjen dhe zbatimin e një mekanizmi të integruar identifikimi të tatimpaguesve mosdeklarues në bashkëpunim ndërmjet Drejtorisë së Kontrollit nga zyra, Drejtorisë së IT-së dhe DMDTP për zhvillimin dhe integrimin në sistemin C@TS një funksionalitet automatik për identifikimin e tatimpaguesve mosdeklarues, përfshirë edhe ata që paraqiten me vlerë 0 në deklaratë, por nuk kanë realizuar deklarimin e detyrueshëm ligjor.

4.1. DPT të marrë masa për të siguruar pasqyrimin e plotë dhe të saktë të të gjitha akt-marrëveshjeve në sistemin C@TS, përfshirë ngarkimin në kohë dhe në mënyrë të saktë të të dhënave që lidhen me detyrimet përkatëse. Gjithashtu nga çdo DRT që harton aktmarrëveshjet , të merren masat për ndarjen e qartë të zërave financiarë (principal, gjoba dhe interesi), duke siguruar që të gjitha komponentët e përfshirë në marrëveshje të regjistrohesh në evidencat zyrtare të raportimit të borxhit tatimor.

5.1. Drejtoritë e Mbledhjes së Detyrimeve Tatimore të Papaguara në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, të marrin masa për hartimin dhe zbatimin e një plani të posaçëm veprimi për trajtimin e borxhit të vjetër, me fokus në tre kategoritë kryesore të borxhit (mbi 2, 5 dhe 10 vjet), të cilat përbëjnë 81.8% të totalit të detyrimeve, me qëllim arkëtimin dhe marrjen e masave për parandalimin e rritjes së mëtejshme të tyre.

6.1. DPT të marrë masa për garantimin e cilësisë dhe besueshmërisë së të dhënave në sistemin informatik C@TS, duke siguruar që të gjitha gjobat dhe interesat e llogaritura nga sistemi të pasqyrohen dhe të regjistrohen në kohë reale në llogaritë individuale të tatimpaguesve, si dhe të jenë pjesë integrale e raporteve analitike të gjeneruara për përpunimin dhe llogaritjen e detyrimeve të papaguara, duke mundësuar kontabilizimin automatik dhe të menjëhershëm të të gjitha detyrimeve të llogaritura, përfshirë dhe ato që janë aktualisht të paregjistruara; me qëllim përmirësimin e cilësisë së raportimit financiar, transparencën në pasqyrimin e detyrimeve tatimore, duke kontribuar në rritjen e efektivitetit së administratës tatimore.

I.2. Konkluzioni dhe Opinioni i auditimit.

Referuar të dhënave të siguruar nga Drejtoria e Mbledhjes së Detyrimeve të Papaguara pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve – përfshirë Drejtorinë e Mbledhjes së Detyrimeve Tatimore në Rajonin Qendror, Rajonin Jugor, Rajonin Verior dhe Drejtorinë e Tatimpaguesve të Mëdhenj – rezultoi se në fund të vitit 2024, gjendja e detyrimeve tatimore të papaguara paraqitet **në vlerën 162,535,463 mijë lekë**, duke shënuar një rritje prej 7,370,054 mijë lekë krahasuar me fundin e vitit 2023. Nga analiza rajonale, Rajoni Qendror përfaqëson pjesën më të madhe të këtij borxhi, duke u renditur si drejtoria me peshën më të lartë të borxhit tatimor në nivel kombëtar rreth 77% të totalit të detyrimeve të papaguara.

Nga auditimi mbi vlerësimin e ecurisë, performancës dhe efektivitetit të masave të marra në lidhje me borxhin tatimor, u konstatua se administrata tatimore përballet me mangësi në të gjitha hallkat e procesit të ndjekjes dhe menaxhimit të detyrimeve të papaguara. Struktura aktuale e ndjekjes së borxhit, në nivel qendror dhe rajonal, nuk funksionon mbi bazën e një sistemi të integruar, të automatizuar dhe të unifikuar, duke ndikuar negativisht në kapacitetin institucional për të kontrolluar dhe reduktuar në mënyrë efektive stokun e borxhit tatimor.

Proceset kyçe, përfshirë pasqyrimin e detyrimeve në sistemin C@TS, përpunimin dhe analizën e të dhënave mbi debitorët, trajtimin e akt-marrëveshjeve për këste, si dhe zbatimin e masave shtrënguese ligjore, u konstatua se nuk janë të standardizuara dhe shpeshherë të pambështetura në dokumentacion të plotë e të gjurmueshëm.

Mosrakordimi midis të dhënave të regjistruara në sistem dhe atyre të pasqyruara në raportimet zyrtare ka krijuar mospërputhje të konsiderueshme, duke ndikuar në pasaktësi në evidencat zyrtare, nënvlerësim të borxhit të raportuar në vlerën prej 391,290 mijë lekë dhe ulje të transparencës fiskale. Gjithashtu, u konstatua se rreth 81.8% e borxhit tatimor të papaguar në nivel kombëtar i përket detyrimeve me moshë mbi dy vjet, kategori që përfaqësojnë një risk të shtuar për parashkrim dhe humbje të të ardhurave buxhetore. Ky fakt tregon për mungesën e një strategjie të dedikuar për trajtimin e borxhit të vjetër dhe tregon një fokus të pamjaftueshëm në parandalimin dhe reduktimin e stokut të borxhit afatgjatë.

Dobësitë në sistemin informatik, mungesa e metodologjive të standardizuara/unifikuara për përpunimin e të dhënave, si dhe kapacitetet e kufizuara njerëzore dhe teknike të strukturave përgjegjëse, kanë ndikuar drejtpërdrejt në uljen e efektivitetit operacional, mungesën e koordinimit ndër-institucional dhe mosrealizimin e objektivave të administrimit fiskal në këtë drejtim.

II. HYRJA

Mbështetur në Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e KLSH”, në zbatim të Programit të Auditimit nr. 23/1 prot., datë 17.01.2025, miratuar nga Kryetari i KLSH, në Drejtorinë e Përgjithshme e Tatimeve, Drejtorinë e Mbledhjes së Detyrimeve Tatimore të Papaguara në Rajonin Qendror, Drejtorinë e Mbledhjes së Detyrimeve Tatimore të Papaguara në Rajonin Jugor, Drejtorinë e Mbledhjes së Detyrimeve Tatimore të Papaguara në Rajonin Verior dhe Drejtorinë e Mbledhjes së Detyrimeve Tatimore të Papaguara në Drejtorinë e Tatimpaguesëve të Mëdhenj, nga data

22.01.2025 deri më datën 25.04.2025, për periudhën e auditimit 01.01.2024-31.12.2024. u krye auditimi tematik “Mbi vlerësimin e ecurisë, performancës dhe efektivitetit të masave të marra në lidhje me borxhin tatimor”. Auditimi u ushtrua nga Grupi i Auditimit me përbërje:

1. J. G
2. E.H
3. A. Gj
4. E. B
5. Xh. N

a. Objektivat dhe qëllimi.

Objekt i këtij auditimi është auditimi tematik i përputhshmërisë, ku do të përcaktohet niveli i zbatimit të kriterëve të vlerësimit, referuar kuadrit rregullator të cilësuar në paragrafin nr. 5 “Kriteret e vlerësimit”. Ky auditim ka si qëllim:

Dhënien e një vlerësimi objektiv e të pavarur, nëse aktivitetet, transaksionet dhe informacioni përputhen, në të gjitha aspektet materiale, me kriteret e aplikuara si: rregullat, ligjet, politikat, kodet e vendosura apo termat dhe kushtet, mbi të cilat është rënë dakord, ku mund të përmendim si burim të këtyre kriterëve: standarde, ligje, vendime të Këshillit të Ministrave, rregullore, kontrata, marrëveshje, instrumente të tjerë që përmbajnë rregulla se si duhet të menaxhohen transaksionet dhe zbatohen buxhetet, etj.

Aspektet e përputhshmërisë (respektimi i kriterëve formale siç janë ligjet përkatëse, rregulloret dhe marrëveshjet) dhe korrektësisë (respektimi i parimeve të përgjithshme që rregullojnë veprimtarinë dhe sjelljen e zyrtarëve publik), referuar ISSAI/IFPP 4900 të INTOSAI-t.

Promovimin e qeverisjes së mirë, duke identifikuar dhe raportuar devijimet nga kriteret, në mënyrë që të merren veprime korrigjuese si dhe të identifikohen personat përgjegjës për veprimet e tyre.

Dhënien e vlerësimeve të pavarura mbi funksionimin e sistemeve dhe nënsistemeve të kontrollit të brendshëm dhe komponentëve të menaxhimit financiar të subjektit, nëpërmjet përcaktimit nga ana e audituesve, nëse janë zbatuar parimet e përgjithshme të sistemit të menaxhimit financiar të sektorit publik dhe të sjelljes me integritet të zyrtarëve të sektorit publik.

b. Identifikimi i çështjes

Referuar tematikës së auditimit, u identifikuan çështjet si më poshtë:

- Vlerësimi i nivelit të borxhit tatimor, ecuria e detyrimeve të papaguara për periudhën objekt auditimi, sipas drejtorive rajonale.
- Analizimi i detyrimeve tatimore sipas statusit të tatimpaguesit, sipas pronësisë, sipas llojit të tatimit, i ndarë në principal/gjobë/interesa dhe mosha e tyre.
- Evidentimi dhe raportimi mujor i detyrimeve për veprime të mëtejshme nga sektorët përkatës.
- Vlerësimi i masave shtrënguese të marra për mbledhjen e detyrimeve tatimore të papaguara.

c. Përgjegjësitë e Strukturave Drejtuese

Drejtimi i institucioneve të DPT-së dhe Drejtoritë e Mbledhjes së Detyrimeve Tatimore të Papaguara nëpër rajone janë përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare dhe njerëzore në përputhje me politikat, ligjet dhe rregulloret e aplikuara. Stafi drejtues është përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare në përputhje me të gjitha ligjet dhe rregulloret në fuqi.

d. Përgjegjësia e Audituesve të KLSH:

Objektivi ynë lidhet me garantimin e sigurisë së arsyeshme, nëse veprimtaria e subjekteve të audituara është zhvilluar në përputhje me kriteret e paracaktuara, si dhe për të konkluduar me një raport auditimi që përfshin një konkluzion dhe/ose opinion. Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë sigurie, por nuk garanton që auditimi i kryer në përputhje me standardet mundëson identifikimin e çdo gabimi apo

anomalie që mund të ekzistojë. Përveç standardeve ISSAI, audituesi i KLSH, gjithashtu aplikon edhe gjykimin dhe skepticizmin e tij profesional në punën audituese.

- Auditimi identifikon çështjet më të rëndësishme lidhur me auditimin e veprimtarisë së subjektit, në raport me kriteret e paracaktuara të auditimit, të nxjerra nga aktet ligjore, nënligjore, si dhe ato rregullative mbi të cilat subjekti i audituar mbështetet në ushtrimin e veprimtarisë së tij;

- Audituesit në të gjithë llojet e auditimit, kanë përgjegjësi që të zbatojnë parimet që lidhen me procesin e auditimit, të sanksionuara në ISSAI/IFPP-100 "Parimet themelore të auditimit të sektorit publik", paragrafi 44-51.

e. Kriteret e vlerësimit:

Auditimi u krye duke mbajtur parasysh legjislacionin e mëposhtëm:

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë;

- Ligji organik i KLSH-së nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "*Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit*";

- Ligji 10296, datë 08.07.2010 "*Mbi menaxhimin Financiar dhe Kontrollin*", i ndryshuar;

- Ligji nr.9920, datë 19.05.2008 "*Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë*" i ndryshuar;

- Ligji nr. 92/2014 "*Për tatimin mbi vlerën e shtuar (TVSH) në Republikën e Shqipërisë*", i ndryshuar;

- Ligji nr. 29/2023 "*Për tatimin mbi të ardhurat*", i ndryshuar;

- Ligji nr.9136, datë 11.9.2003 "*Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në Republikën e Shqipërisë*" i ndryshuar;

- Ligji nr. 9975, datë 28.07.2008 "*Për taksat kombëtare*", i ndryshuar;

- Ligji nr. 9632, datë 30.10.2006 "*Për sistemin e taksave vendore*", i ndryshuar

- Udhëzimi nr.24 datë 02.09.2008 "*Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë*", i ndryshuar,

- Manuali i mbledhjes së detyrimeve tatimore të papaguara, miratuar me shkresën nr.11912 prot., datë 29.06.2021;

- Akte të tjera ligjore/nënligjore në zbatim të ligjeve të sipërcituar.

f. Standardet e Auditimit

Auditimi është kryer në përputhje me procedurat e përgjithshme të pranuar të kuadrit ligjor, rregullator dhe Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit. Raporti Përfundimtar i Auditimit është hartuar në përputhje me kërkesat e Rregullores së Procedurave të Auditimit në KLSH, nr .07, dt 17.01.2024, mbështetur në:

- Ligjin nr. 154/2014 "*Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit*";

- INTOSAI – P - 1 "*Deklarata e Limës*";

- INTOSAI – P – 10 - 99 "*Parimet themelore të INTOSAI*";

- INTOSAI – P - 10 "*Deklarata e Meksikës mbi pavarësinë e SAI*";

- INTOSAI – P - 12 "*Vlerat dhe përfitimet e SAI – sjellja e ndryshimit në jetën e qytetarëve*";

- INTOSAI – P - 20 "*Parimet e Transparencës dhe Llogaridhënies*";

- INTOSAI – P - 50 "*Parimet e juridiksionit të SAI*";

- ISSAI 100 - 129 "*Parimet themelore të auditimit të sektorit publik*";

- ISSAI 400 "*Parimet e Auditimit të Përputhshmërisë*";

- ISSAI 4000 "*Standardet e Auditimit të Përputhshmërisë*";

- Manualin e Auditimit të Përputhshmërisë, miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH nr. 245, datë 29.12.2022.

g) Metodat e auditimit

Përzgjedhja e metodave të përdorura, u mbështetet në vlerësimin e riskut, materialitetit, kostos dhe efikasitetit të auditimit, duke patur në fokus përmbushjen e qëllimit të procedurës së auditimit. Përsa i përket funksionimit të sistemit të kontrollit të brendshëm, zbatueshmërisë nga ana e subjektit të audituar të MFK-së, Grupi i auditimit ka kryer intervista verbale dhe teste kontrolli. Nga vlerësimi i riskut në fazën

e planifikimit dhe në fazën e auditimit në terren, ka rezultuar se sistemi i kontrollit të brendshëm, nuk ka funksionuar në mënyrën e duhur, si dhe është konsideruar me risk të mesëm, për këtë arsye për dhënien e një vlerësimi sa më objektiv, profesional e të pavarur, të saktë, të plotë e të qartë për zbatimin e ligjshmërisë dhe korrektësisë (në auditimin e përputhshmërisë) nga ana e subjektit të audituar, janë aplikuar:

- Verifikimi i transaksioneve, ku është marrë informacioni për një rrethanë ose transaksion nga dy burime duke kryer krahasueshmërinë e tyre;
- Intervistimi, ku është përdorur intervistimi verbal i marrjes së informacionit nëpërmjet pyetjeve drejtuar personelit kyç të subjektit që auditohet;
- Raporte dhe informacione, ku janë shfrytëzuar raporte, analiza dhe informacione të cilat lidhen me objektivat e auditimit dhe problemet që lidhen me të.

h) Dokumentimi i auditimit

Nga audituesit u përgatit dokumentacioni i auditimit i mjaftueshëm për të mundësuar dhe kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit të kryera në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat e zbatueshme ligjore dhe rregullatore, rezultatet e këtyre procedurave dhe evidencat e marra të auditimit, si dhe çështje të rëndësishme, që dolën gjatë auditimit, janë reflektuar në përfundimet e arritura në drejtim të tyre dhe gjykimet profesionale në arritjen e këtyre konkluzioneve. Në këtë mënyrë, dokumentimi i auditimit është kryer nëpërmjet shënimeve, pyetësorëve, intervistave, verifikimeve të finalizuara në Akt Konstatimet, si dhe observacionet e subjektit, të cilat kanë shërbyer si bazë për hartimin e këtij Raporti Përfundimtar të Auditimit.

III. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT

1. Informacion i Përgjithshëm

Misioni i Administratës Tatimore është mbledhja e të ardhurave tatimore përmes procedurave të thjeshta dhe me kosto minimale, duke zbatuar në mënyrë rigoroz legjislacionin tatimor, me qëllim financimin e buxhetit të shtetit shqiptar. Për realizimin e këtij misioni, Administrata Tatimore i asiston tatimpaguesit me shërbime cilësore dhe të qasshme, në mënyrë që ata të përmbushin vetë detyrimet e tyre tatimore, sipas legjislacionit në fuqi.

Në rastet kur pagesat nuk realizohen brenda afateve të përcaktuara për pagesën mbi bazën e vetëdeklarimit, detyrimi tatimor kalon për ndjekje nga strukturat përgjegjëse për mbledhjen e detyrimeve në Drejtorinë Rajonale Tatimore (DRT).

Mbledhja e detyrimeve tatimore të papaguara realizohet nga drejtoritë përgjegjëse për mbledhjen me forcë të detyrimeve, të ndara në katër rajone dhe që varen nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve (DPT), në përputhje me nenet 88-103 të Ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, ku përcakton përgjegjësinë ligjore të Administratës Tatimore për mbledhjen e detyrimeve tatimore të papaguara, për të cilat: nuk është ushtruar e drejta e ankimit ose janë përfunduar të gjitha fazat e shqyrtimit administrativ dhe gjyqësor.

Në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve (DPT), procesi i koordinimit të mbledhjes së detyrimeve tatimore të papaguara kryhet nga Drejtoria e Mbledhjes së Detyrimeve Tatimore të Papaguara. Megjithatë, është në përgjegjësinë e DPT që, nëpërmjet drejtorive të saj, të garantojë udhëheqjen metodologjike dhe strategjike, zhvillimin e politikave dhe procedurave në funksion të mbledhjes së detyrimeve tatimore të papaguara, zhvillimin e planeve operacionale, përcaktimin dhe monitorimin e targeteve operacionale, si dhe varësinë funksionale mbi drejtoritë e mbledhjes së detyrimeve tatimore të papaguara në rajone.

Puna e Drejtorisë së Mbledhjes së Detyrimeve të Tatimore të Papaguara (DMDTP), rregullohet me Ligjin nr.9220, datë 19/05/208 ”Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar Kreu XI

“Mbledhja me forcë e detyrimit tatimor të papaguar”, Udhëzimin nr.24, datë 02.09.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, manualin i mbledhjes së detyrimeve të papaguara, miratuar me shkresën nr.11912 prot., datë 29.06.2021, akte të tjera ligjore dhe nënligjore në fuqi.

Struktura funksionale rregullohen me VKM nr.33, datë 12.02.2020 “Për miratimin e strukturës organizative dhe të numrit të përgjithshëm të personelit të administratës tatimore qendrore”, protokolluar në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve me nr.3259 prot., datë 12.02.2020, lidhja nr.1(1/2), miratuar me urdhër nr.192 datë 12.08.2020 “Për miratimin e rregullores së funksionimit të administratës rajonale tatimore” të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë me nr.14858/1 prot., datë 12.08.2020, protokolluar në DPT me nr..15960 prot., datë 12.08.2020 dhe urdhër nr.193 datë 12.08.2020 “Për miratimin e rregullores së funksionimit të administratës tatimore qendrore” të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë me nr.14858/2 prot., datë 12.08.2020, protokolluar në DPT me nr.15961 prot., datë 12.08.2020, në të cilën përcaktohen qartë kompetencat, detyrimet dhe përgjegjësitë e secilit punonjës, kryesisht në përgjegjësinë personale, zbatimin e ligjit, marrëdhëniet me publikun (subjektet) etj..

Drejtoritë funksiononin të përbëra nga 3 (tre) sektor:

- Sektori i Monitorimit, Analizës për Masat Shtrenguese,
- Sektori i Zbatimit në Terren të Masave Shtrenguese,
- Sektori i Procedurave Ligjore të Mbledhjes me Forcë.

Organi tatimor ka një sërë kompetencash lidhur me masat shtrenguese që burojnë nga Ligji Nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat Tatimore në RSH”, i ndryshuar. Masat shtrenguese duhet të merren për totalin e borxhit të të njëjtit tatimpagues.

Procedurat e Masave Shtrenguese në Mbledhjen e Detyrimeve Tatimore

1. Njoftimi dhe kërkesa për të paguar

Njoftimi dhe Kërkesa për Pagesë: Identifikohen detyrimet e papaguara për tatimpaguesit që nuk kanë ankimuar dhe nuk kanë paguar. Dërgohet “Njoftim dhe kërkesë për të paguar” brenda 3 ditëve nga data e detyrimit. Tatimpaguesi duhet të paguajë brenda 10 ditëve nga dërgimi i postës ose 3 ditëve nga dorëzimi dorazi. Pas afatit fillon mbledhja me forcë.

Procedura për Mbledhjen me Forcë: Pas kalimit të afatit, Drejtoria për Mbledhjen e Borxheve nis procedurat për mbledhjen me forcë. Nëse ka rrezik shmangie, nuk pritët njoftimi, por nis menjëherë mbledhja me forcë.

Kallëzimi Penal: Në rast shmangie, transferimesh ose falimentimi i qëllimshëm, administrata mund të bëjë kallëzim penal. Kërkohet masa sigurimi dhe ndalohet transferimi i parave jashtë vendit për tatimpaguesin dhe personat lidhur me të.

Monitorimi dhe Konfiskimi i Qarkullimit: Tatimpaguesi njoftohet 1 ditë para kontrollit. Kontrollonhet qarkullimi ditor dhe detyrohet të paguajë 50% të tij ditë për ditë. Nëse nuk paguan, konfiskohet 50% e qarkullimit.

2. Urdhëri i bllokimit të llogarive bankare të tatimpaguesit

Bllokimi i Llogarive Bankare: Nëse tatimpaguesi nuk paguan detyrimet, nxirret urdhër bllokimi për llogaritë bankare. Urdhëri përmban identitetin, shumën, shkakun dhe detajet e llogarive. Bankat bllokojnë shumën më të vogël midis detyrimit dhe gjendjes në llogari. Drejtoria jep urdhër ekzekutimin për të transferuar shumën e bllokuar në llogarinë e administratës tatimore.

3. Masa e sigurimit të detyrimit tatimor

Masat e Sigurimit të Detyrimit Tatimor: Drejtoritë e Mbledhjes së Detyrimeve sipas Rajoneve konstatojnë se detyrimet tatimore nuk janë paguar prej tatimpaguesit në afatin e caktuar, ajo kërkon sigurimin e pagimit të këtij detyrimi nëpërmjet vendosjes së masave të sigurisë për të gjithë pasurinë e tatimpaguesit dhe të pezullimit të aktivitetit të tij tregtar. Pas skadimit të bllokimit të llogarive bankare dhe nëse detyrimet janë ende të papaguara, brenda 10 ditëve jepen:

- Njoftim për tatimpaguesin; I dërgohet tatimpaguesit për njohjen dhe ushtrimin e ankimimit.
- Njoftim i përgjithshëm për publikim; Publikohet për informimin e palëve të treta dhe institucionet përkatëse, për të ndaluar transaksionet mbi pasuritë.
- Vendosje barrë hipotekore & barrë siguroese; Vendosen për të siguruar mos humbjen apo tjetërsimin e pasurisë pa paguar detyrimet. brenda 10 ditëve pas bllokimit të pasuksesshëm të llogarive.
- Pezullim aktiviteti në doganë: Aplikohen për import/eksport në rast papagimi, dhe kërkesat bëhen elektronikisht pranë Drejtorisë së Doganave.
- Ankimimi: Tatimpaguesi mund të ankimojë masat nëse ato nuk janë ekzekutuar rregullisht.
- Revokimi: Në rast të parregullsive të vërtetuara, masa mund të revokohet me vendim të arsyetuar dhe brenda afateve ligjore. Kërkesa për revokim duhet brenda 30 ditëve.

4. Sekuestrimi dhe konfiskimi i pasurisë

Kur një tatimpagues nuk paguan detyrimin tatimor brenda afatit, edhe pas marrjes së masave të tjera (si barrë siguroese apo pezullim aktiviteti), administrata tatimore mund të kalojë në masën më të ashpër: sekuestrimin e pasurisë.

1. Fillimi i procedurës Sekuestrimi fillon vetëm kur janë provuar të pasuksesshme masat më të lehta dhe nuk ka mënyra të tjera për arkëtimin e borxhit. Autorizimi jepet nga drejtori përkatës i administratës tatimore rajonale.
2. Identifikimi i pasurisë; Nëse administrata gjen pasurinë e tatimpaguesit, ajo regjistrohet në sistemin C@TS dhe përgatitet urdhri i sekuestrimit. Nëse pasuria nuk gjendet, çështja i kalon Drejtorisë së Hetimit Tatimor për verifikime të mëtejshme.
3. Urdhri i Sekuestrimit; Urdhri nxirret me shkrim dhe përmban informacion për shumën, pasurinë që do sekuestrohet, afatin e pagesës dhe të drejtën për ankimim.
4. Zbatimi i sekuestrimit; Zbatimi bëhet nga një grup pune i ngritur nga Drejtoria Rajonale dhe njoftohen institucionet përkatëse si Kadastra. Vizitat për sekuestrim kryhen në terren dhe mbahet procesverbal i detajuar.
5. Përjashtime nga sekuestrimi; Ligji përjashton nga sekuestrimi pasuritë e nevojshme për jetesën (veshje, ushqime, pajisje pune, pensione etj.) dhe pasuritë që nuk i përkasin debitorit.
6. Konfiskimi; Nëse borxhi nuk paguhet brenda 15 ditësh nga data e njoftimit për sekuestrim, pasuria sekuestruar konfiskohet.
7. Shitja e pasurisë; Pas konfiskimit, pasuria shitet përmes ankandit publik, në përputhje me ligjin “Për ankandin publik”. Këtë proces e organizon Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve si autoritet shitës.

Transferimi i Detyrimit Tatimor Palës së Tretë

E drejta për transferim; Detyrimi mund t’i transferohet një personi të tretë që ka përfituar pasuri nga tatimpaguesi gjatë periudhës së mbledhjes me force.

Duhet të jenë përmbushur 2 kushte:- Detyrimi nuk është mbledhur edhe pas shitjes së pasurive të tatimpaguesit.

- Pala e tretë ka përfituar pasuri gjatë kësaj periudhe.
2. Njoftimi dhe Kërkesa për Pagesë; Lëshohet një akt administrativ me shkrim, i titulluar “Njoftimi dhe kërkesa për pagesë”, ku përmban të dhëna për: emrin, NIPT-in, shumën, pasurinë e përfituar, afatin, llogarinë bankare, emrin e tatimpaguesit origjinal, etj. 3. Afatet kryesore procedural; 14 ditë nga data e marrjes dijeni të njoftimit për të bërë pagesën (shtyhet nëse bie në ditë pushimi). 37 ditë nga data e nisjes së njoftimit për të përmbushur pagesën. 10 ditë nga marrja dijeni për pagesën nga pala e tretë → afati që administrata ka për të përgatitur njoftimin.4. Përlllogaritja e detyrimit; Bëhet mbi vlerën reale të tregut të pasurisë së përfituar, mbështet në: të dhëna nga INSTAT, çmime tregu, të dhëna nga transaksione të ngjashme, apo nga zyra pasurish.5. Fillimi i mbledhjes me forcë (nëse nuk paguan); Pas 37 ditësh, nëse

nuk ka pagesë dhe nuk është paraqitur ankim fillojnë masat e mbledhjes me forcë të njëjta si ndaj tatimpaguesit.6. Përgjegjësia e ortakëve, aksionarëve dhe administratorëve

Nëse është person juridik dhe nuk paguan:

Detyrimi i transferohet ortakëve, aksionarëve dhe/ose administratorëve.

Këta persona bëhen debitorë solidarë.

Vetëm nëse janë regjistruar me ato cilësi pas njoftimit të detyrimit.


7. Njoftimi dhe Mbledhja me Forcë ndaj tyre.

2. Përshkrimi i auditimit, sipas drejtimeve të auditimit.

2.1 Mbi vlerësimin e nivelit të borxhit tatimor, ecuria e detyrimeve të papaguara për periudhën objekt auditimi, sipas drejtorive rajonale.

Në zbatim të kërkesave të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 6 i tij përcakton se “Detyrim tatimor” quhet “Detyrimi tatimor lind kur personi realizon të ardhura, kur bëhet pronar i një pasurie apo kryen pagesa, të cilat janë objekt i tatimit, sipas legjislacionit tatimor.... Detyrimi tatimor përfshin tatimin, kamatëvonesat, si dhe gjobat, për rastet e parashikuara nga ky ligj”. Nenet 88-103 të këtij ligji përcaktojnë përgjegjësinë ligjore të Administratës Tatimore për mbledhjen e detyrimit tatimor të papaguar për të cilat nuk është ushtruar e drejta e ankimit apo kanë kaluar të gjitha fazat e shqyrtimit administrativ dhe gjyqësor. Mbledhja e detyrimeve të papaguara kryhet nga Drejtoritë e Mbledhjes së Detyrimeve Tatimore të Papaguara të ndarë në katër Rajone, në varësi të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve. Për periudhën objekt auditimi këto drejtori kanë zbatuar “Manualin e rishikuar të Drejtorisë së Mbledhjes së Detyrimeve Tatimore të Papaguara” e dërguar me shkresën nr. 11912, prot., datë 29.06.2021 të Drejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve.

Referuar të dhënave të vëna në dispozicion nga Drejtoria e Mbledhjes të Detyrimeve të Papaguara në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, ku përfshihet Drejtoria e Mbledhjes së Detyrimeve Tatimore të Papaguara në Rajonin Qendror; në Rajonin Jugor; në Rajonin Verior dhe në Drejtorinë e Tatimpaguesëve të Mëdhenj, rezultoi se gjendja e detyrimeve të papaguara në fillim të vitit 2024 paraqitet në vlerën rreth 155,165,409 mijë lekë, ndërsa në fund të vitit 2024 këto detyrime rezultojnë në vlerën rreth **162,535,463 mijë lekë**. duke rezultuar me një rritje prej **7,370,054 mijë lekë** të detyrimeve të papaguara.



Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të DPT

1. Analizimi i detyrimeve tatimore sipas statusit të tatimpaguesit.

Në fund të vitit 2024, numri i përgjithshëm i tatimpaguesve me borxh rezultoi të jetë 202,387 raste, duke përfshirë si subjekte aktive, ashtu edhe ato pasive. Nga analiza e të dhënave vërehet se pesha më e madhe

e borxhit tatimor rrjedh nga tatimpaguesit pasiv (rreth 75%), të cilët përbëjnë 120,557 raste dhe kanë një vlerë të detyrimeve të papaguara në shumën prej 120,983,035 mijë lekë, ndërsa subjekte aktive rezultoi në 81,830 raste në shumën prej 41,552,427 mijë lekë

2. Analizimi i detyrimeve tatimore të ndara sipas pronësisë.

Borxhi tatimor i akumuluar në vitin 2024 ka një shpërndarje midis bizneseve të mëdha, ndërmarrjeve shtetërore dhe enteve buxhetore në shumën prej 141,113,037 mijë lekë. Këto shifra janë një tregues i rëndësishëm i disiplinës fiskale të subjekteve ekonomike dhe efektivitetit të administratës tatimore në arkëtimin e të ardhurave të buxhetit të shtetit. Bizneset e mëdha përbëjnë pjesën më të madhe të borxhit tatimor të regjistruar deri më 31 dhjetor 2024, rreth 87% të totalit kombëtar, ku ndërmarrjet shtetërore ndonëse më të pakta në numër, zënë një pjesë të konsiderueshme të borxhit të bizneseve të mëdha në shumën 16,082,958 mijë lekë.

3. Analizimi i detyrimeve sipas llojit të tatimit, i ndarë në principal/gjobë/interesa dhe ecuria e tyre çdo muaj

Nga të dhënat e vëna në dispozicion dhe të analizuar rezultoi se detyrimet e papaguara mbeten të përqendruara kryesisht tek Tatimi mbi Fitimin dhe TVSH, ndërsa tatime të tjera, si sigurimet shoqërore dhe tatimi në burim, kanë një ndikim më të moderuar në stokun total të borxhit.

3.1. Tatimi mbi Fitimin

Në fillim të vitit 2024, borxhi i regjistruar për Tatimin mbi Fitimin në nivel kombëtar ishte në shumën prej 47,177,968 mijë lekë. Nga analiza e tendencave mujore rezultoi se në disa rajone është vërejtur një ulje progresive e borxhit gjatë muajve maj–dhjetor, si rezultat i përmirësimit të performancës në mbledhjen e të ardhurave. Ndërkohë, në rajone të tjera është regjistruar rritje neto e detyrimeve, si rrjedhojë e shtimit të gjobave dhe interesave për vonesa në pagesa.

Në fund të vitit 2024, borxhi i akumuluar për Tatimin mbi Fitimin rezultoi në shumën 47,331,355 mijë lekë,

3.2. Tatimi mbi Vlerën e Shtuar (TVSH)

Tatimi mbi Vlerën e Shtuar (TVSH) vazhdon të mbetet një ndër kategoritë më të rëndësishme të të ardhurave në strukturën e detyrimeve tatimore. Në fillim të vitit 2024, borxhi i regjistruar për këtë kategori ishte 56,723,987 mijë lekë, ndërsa në fund të vitit arriti në vlerën 57,008,514 mijë lekë, duke reflektuar një rritje prej 284,547 mijë lekë.

Gjatë vitit u vu re një rritje e qëndrueshme e detyrimit në shumicën e rajoneve, me përjashtime të kufizuara në muaj të caktuar si maj ose në fund të vitit, kur janë regjistruar ulje të përkohshme. Veçanërisht, muajt janar dhe shkurt kanë shënuar rritje të ndjeshme të borxhit në disa rajone, ndërsa nëntori është evidentuar si muaji me rritjen më të lartë mujore për disa njësi.

3.3. Sigurimet Shoqërore

Në vitin 2024, borxhi i papaguar për sigurimet shoqërore në Shqipëri ka shënuar një rritje të konsiderueshme, duke arritur në 24,158,039 mijë lekë me një rritje prej 7,142 mijë lekë krahasuar me vitin e kaluar. Detyrimet e papaguara nga punëdhënësit, përfshirë edhe institucione publike, ndikojnë negativisht në skemën e pensioneve dhe në stabilitetin e sistemit të sigurimeve shoqërore. Ky trend rritës i borxhit për sigurimet shoqërore ndikon në qëndrueshmërinë e sistemit të pensioneve dhe mund të çojë në vonesa të pagesave për pensionistët.

3.4. Tatimi mbi të Ardhurat Personale (TAP)

Tatimi mbi të Ardhurat Personale, në fillim të vitit 2024, borxhi i regjistruar për këtë kategori ishte 56,723,987 mijë lekë, ndërsa në fund të vitit paraqitet në vlerën 2,645,792 mijë lekë, duke reflektuar një ulje prej 8,621 mijë lekë nga çelja e vitit 2024.

3.5. Tatimi në Burim

Tatimi në burim, në fillim të vitit 2024, borxhi i regjistruar për këtë kategori ishte 6,435,278 mijë lekë, ndërsa në fund të vitit paraqitet në vlerën 6,440,549 mijë lekë, duke reflektuar një ulje prej 5,271 mijë lekë nga çelja e vitit 2024.

3.6. Analizë e borxhit sipas moshës:

Nga auditimi i detyrimeve tatimore të papaguara, rezultoi se borxhi i akumuluar është i shpërndarë në periudha të ndryshme kohore, duke përfshirë detyrime të krijuara në tre muajt e fundit deri te borxhi me më shumë se dhjetë vjet.

Borxhi deri në 3 muaj; Kategoria e borxhit deri në 3 muaj përbën një kategori me probabilitet të lartë rikuperimi, pasi detyrimet janë krijuar së fundmi dhe janë shpesh pasojë e mosrespektimit të afateve nga tatimpaguesit aktivë. Vlera totale e kësaj kategorie borxhi është në shumën prej 4,229,900 mije lekë.

Borxhi nga 3 deri në 6 muaj; Vlera totale e kësaj kategorie borxhi është në shumën prej 2,898,305 mije lekë.

Borxhi nga 6 deri në 12 muaj; Vlera totale e kësaj kategorie borxhi është në shumën prej 7,331,906 mije lekë.

Borxhi nga 1 deri në 2 vjet; Kategoria tregon një total borxhi ndërmjetës, që përfaqëson një kalim nga borxhi afatshkurtër tek ai afatgjatë. Vlera totale e kësaj kategorie borxhi është në shumën prej 10,422,079 mije lekë.

Borxhi nga 2 deri në 5 vjet; Vlera totale e kësaj kategorie borxhi është në shumën prej 32,879,530 mije lekë.

Borxhi mbi 5 vjet; Kategoria më e rëndësishme dhe me probabilitet më të ulët rikuperimi për shkak të kohës së gjatë së mos mbledhjes së detyrimit, zë dhe peshën me të madhe rreth 54 % të total detyrimit.

Nga auditimi mbi ecurinë dhe administrimin e borxhit tatimor për vitin 2024 sipas rajoneve u konstatua se:

-DMDTP në Rajoni Qendror rezulton drejtoria me peshën më të lartë të borxhit tatimor në nivel vendi. Në fillim të vitit 2024, stoku i borxhit ishte 114,110,869 mijë lekë, ndërkohë që në fund të vitit arriti në 124,809,858 mijë lekë, duke reflektuar një rritje prej 10,698,989 mijë lekë.

-DMDTP në DTM ka paraqitur një tendencë pozitive, duke shënuar ulje të borxhit nga 12,609,965 mijë lekë në fillim të vitit në 8,160,530 mijë lekë në fund të vitit, me një reduktim prej 4,449,435 mijë lekë. Kjo rënie pasqyron performancë të përmirësuar në menaxhimin dhe arkëtimin e detyrimeve, e cila mund të shërbejë si model referimi për drejtori të tjera rajonale.

-DMDTP në Rajonin Jugor rezulton me një rritje të lehtë të stokut të borxhit nga 11,855,732 mijë lekë në fillim të vitit në 12,585,841 mijë lekë në fund të vitit, me një rritje neto prej 730,109 mijë lekë.

-DMDTP në Rajonin Verior rezulton me një rritje të lehtë të stokut të borxhit nga 16,588,843 mijë lekë në 16,979,234 mijë lekë, me një rritje neto prej 390,391 mijë lekë.

Gjatë vitit 2024, në të gjitha drejtoritë përveç DTM-së, është konstatuar një rritje e stokut të borxhit tatimor të papaguar, duke reflektuar dobësi në sistemin e ndjekjes dhe arkëtimin të detyrimeve tatimore, si dhe nevojë për masa të përforcuara dhe të personalizuara sipas specifikave rajonale.

Në analizë DMDTP sipas Rajoneve:

2.1.1. Drejtoria e Mbledhjes së Detyrimeve Tatimore të Papaguara në Rajonin Qendror

Struktura e DMDP, Rajoni Qendror rezulton një drejtori e krijuar mbi bazën ligjore, e cila ka qendrën në Tiranë dhe ushtron funksionin e saj në juridiksionin territorial të Drejtorive Rajonale Tatimore Tiranë, Durrës, Elbasan, Korçë.

Drejtoria funksionon e përbërë nga 3 (tre) sektorë:

1. Sektori i Monitorimit, Analizës për Masat Shtëruese,

2. Sektori i Zbatimit në Terren të Masave Shtrënguese,
3. Sektori i Procedurave Ligjore të Mbledhjes me Forcë.

Struktura për periudhën e vitit 2024, DMDTP Rajoni Qendror krahasuar me strukturën e miratuar në Drejtorinë e Përgjithshme Tatimore, paraqitet si më poshtë:

Rajoni Qendror (1+3+71)	Plan sipas urdhrin të KM nr. 69, dt. 26.05.2023	Pas implement. të strukturës dt.01.02.2024	Fakt 31.12.2024	Diferenca Plan /Fakt
Drejtor Drejtorie	1	1	1	-
Sektori i Monitorimit, Analizës për masat shtrënguese				
- Përgjegjës Sektori	1	0	1	-
- Inspektorë	30	21	29	1
Sektori i Zbatimit në Terren të Masave Shtrënguese				
- Përgjegjës Sektori	1	1	0	1
- Inspektorë	27	15	22	15
Sektori i Procedurave Ligjore të mbledhjes me forcë				
- Përgjegjës Sektori	1	1	1	-
- Inspektorë	14	14	12	2
	75	52	66	9

Burimi: Drejtoria e Burimeve Njerëzore në DPT, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së


Sa më sipër, u konstatua se struktura e DMDTP Rajoni Qendror është miratuar me 75 punonjës (1 drejtor drejtorie, 3 përgjegjës sektori dhe 71 inspektorë). Nga auditimi u konstatua se implementimi i strukturës së re të Administratës Tatimore Qëndrore është vënë në zbatim 8 muaj pas miratimit me urdhrin nr. 69, datë 26.05.2023 të kryeministrit, në të cilin rezultojnë në strukturë 52 punonjës në total, ndërsa më datë 31.12.2024, rezultojnë 66 punonjës me një diferencë nga plani i miratuar, me 9 punonjës.

1. Analizimi i detyrimeve tatimore sipas statusit të tatimpaguesit.

Në fund të vitit 2024, numri i përgjithshëm i tatimpaguesve me borxh rezultoi të jetë 140,456 raste, duke përfshirë si subjekte aktive, ashtu edhe ato pasive. Nga analiza e të dhënave vërehet se pesha më e madhe e borxhit tatimor rrjedh nga tatimpaguesit pasiv, të cilët përbëjnë 84,688 raste dhe kanë një vlerë të detyrimeve të papaguara në shumën prej 100,280,693 mijë lekë.

Në Drejtorinë Rajonale Qendrore rezultojnë 55,768 raste aktive, me një borxh të akumuluar në shumën prej 24,529,164 mijë lekë.

Detyrimi i papaguar sipas Drejtorive Rajonale Tatimore të cilat përfshihen në raportimin e borxhit në Drejtorinë e Mbledhjes së Detyrimeve Tatimore të Papaguara në Rajonin Qendror paraqitet si më poshtë:



Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të DPT

2. Analizimi i detyrimeve tatimore të ndara sipas pronësisë.

Borxhi tatimor i akumuluar në vitin 2024 ka një shpërndarje midis bizneseve të mëdha, biznese të vogla dhe ndërmarrjeve shtetërore/enteve buxhetore. Këto shifra janë një tregues i rëndësishëm i disiplinës fiskale të subjekteve ekonomike dhe efektivitetit të administratës tatimore në arkëtimin e të ardhurave të buxhetit të shtetit.

- Bizneset e mëdha përbëjnë pjesën më të madhe të borxhit tatimor të regjistruar deri më 31 dhjetor 2024, me një vlerë prej 109,275,844 mijë lekë ose 88% të detyrimit.

3. Analizimi i detyrimeve sipas llojit të tatimit, i ndarë në principal/gjobë/interesa dhe ecuria e tyre çdo muaj

Nga të dhënat e vëna në dispozicion dhe të analizuar rezultoi se detyrimet e papaguara mbeten të përqendruara kryesisht tek Tatimi mbi Fitimin dhe TVSH, ndërsa tatime të tjera, si sigurimet shoqërore dhe tatimi në burim, kanë një ndikim më të moderuar në stokun total të borxhit.

3.1. Tatimi mbi Fitimin

Në fillim të vitit 2024, borxhi i regjistruar për Tatimin mbi Fitimin ishte në shumën prej 29,814,196 mijë lekë, duke pësuar ndryshime gjatë vitit si më poshtë vijon:

-Në janar, detyrimi u rrit në shumën prej 71,311 mijë lekë, si rezultat i shtimit të detyrimeve nga tatimpaguesit për fitimet e realizuara në periudhën e mëparshme.

-Në shkurt, borxhi shënoi një rritje të ndjeshme në shumën prej 3,136,805 mijë lekë, duke reflektuar rritjen më të madhe të detyrimit gjatë vitit 2024.

-Në mars dhe prill, shënohet një shtim i borxhit përkatësisht me shumën prej 236,802 mijë lekë dhe shumën prej 1,477,541 mijë lekë, duke pasqyruar një rritje të lartë të detyrimeve të papaguara.

-Në maj, borxhi shënoi një ulje të konsiderueshme në shumën prej 183,781 mijë lekë, ndërsa në qershor u ul me shumën prej 146,266 mijë lekë, duke reflektuar përmirësim në arkëtimet dhe pagesat nga tatimpaguesit.

-Në korrik, borxhi u rrit me shumën prej 99,477 mijë lekë, ndërsa në gusht u ul me shumën prej 26,847 mijë lekë, duke treguar luhajtje në nivelin e pagesave dhe të detyrimeve të reja.

-Nga shtatori deri në nëntor, borxhi ka pësuar luhajtje të ndjeshme, ku shtatori solli një rritje në shumë prej 256,896 mijë lekë, tetori një ulje në shumën prej 67,455 mijë lekë, ndërsa nëntori një rritje prej 46,779 mijë lekë.

-Në dhjetor, borxhi është ulur me shumën prej 68,613 mijë lekë, duke mbyllur vitin me një vlerë totale në shumën prej 34,646,846 mijë lekë, ku krahasuar me çeljen e vitit ka pësuar një rritje në shumën prej 4,832,650 mijë lekë.

Gjithashtu, vlera e këtij detyrimi në datë 31.12.2024 është përkatësisht principal në shumën prej 23,212,310 mijë lekë, gjoba në shumën prej 10,524,270 mijë lekë dhe interesa në shumën prej 910,266 mijë lekë.

3.2. Tatimi mbi Vlerën e Shtuar (TVSH)

TVSH-ja është një nga tatimet me ndikimin më të madh në detyrimet totale, duke pësuar ndryshime gjatë vitit 2024 si më poshtë vijon:

-Në muajin janar, detyrimi i papaguar për TVSH-në u rrit në vlerën 529,276 mijë lekë.

-Në muajin shkurt, pati një rritje të ndjeshme të detyrimit në shumën prej 1,637,797 mijë lekë, duke reflektuar rritjen më të madhe të detyrimit gjatë vitit 2024, por nga grupi i auditimit u konstatua se numri i rasteve ka pësuar rënie të konsiderueshme prej 229 raste.

-Në muajt pasues, borxhi ka pësuar rritje të vazhdueshme nga muaji në muaj, përveç muajit maj ku ka pësuar një ulje në shumën prej 38,463 mijë lekë.

-Në fund të vitit, borxhi i TVSH-së rezultoi në shumën prej 43,430,396 mijë lekë, ku krahasuar me çeljen e vitit ka pësuar një rritje në shumën prej 3,449,301 mijë lekë. Nga krahasimi i numrit të debitorëve në fund të vitit me çeljen e vitit, rezultoi se kemi një rritje të numrit të debitorëve prej 7552 raste. Gjithashtu, vlera e këtij detyrimi në datë 31.12.2024 është përkatësisht principal në shumën 25,289,788 mijë lekë, gjoba në shumën prej 16,371,809 mijë lekë dhe interesa në shumën prej 1,768,798 mijë lekë.

3.3. Sigurimet Shoqërore

-Në muajin janar, borxhi për sigurimet shoqërore ka pësuar një rritje në shumën prej 496,064 mijë, ndërsa në muajin shkurt, u regjistrua një rënie në shumën prej 135,181 mijë lekë, ndërsa në mars borxhi u rrit me 60,847 mijë lekë, duke treguar luhajtje në disiplinën e pagesave nga subjektet debitore.

- Në muajin prill, borxhi u rrit ndjeshëm në shumën prej 505,668 mijë lekë, duke arritur një nga nivelet më të larta të rritjes gjatë vitit. Megjithatë, në maj, detyrimi pësoi një rënie të konsiderueshme në shumën prej 307,447 mijë lekë.

- Në muajin qershor, borxhi u rrit në shumën prej 14,230 mijë lekë, ndërsa në korrik pati një rritje në shumën prej 507,449 mijë lekë, duke arritur një nga nivelet më të larta të rritjes gjatë vitit pas muajit prill.

-Në muajin gusht, borxhi pësoi një ulje në shumën prej 116,243 mijë lekë, dhe në muajin shtator vijon me rënie në shumën prej 74,554 mijë lekë.

-Në muajin tetor, rezultoi me një rritje të konsiderueshme në shumën prej 399,265 mijë lekë, ndërsa në muajt nëntor dhe dhjetor borxhi pësoi një rritje më të moderuar përkatësisht në shumën prej 39,677 mijë lekë dhe në shumën prej 8,106 mijë lekë.

-Në fund të vitit, borxhi i sigurimeve shoqërore rezultoi në shumën prej 17,834,438 mijë lekë, ku krahasuar me çeljen e vitit ka pësuar një rritje totale në shumën prej 1,397,880 mijë lekë. Gjithashtu, vlera e këtij detyrimi në datë 31.12.2024 është përkatësisht principal në shumën prej 13,908,492 mijë lekë, gjoba në shumën prej 3,204,491 mijë lekë dhe interesa në shumën prej 721,455 mijë lekë.

3.4. Tatimi mbi të Ardhurat Personale (TAP)

TAP ka pasur një trend të qëndrueshëm, me ndryshime të vogla krahasuar me tatimet e tjera gjatë vitit 2024.

-Nga muaji në muaj TAP ka pësuar rritje të vazhdueshme, ku vetëm në muajin maj ka pësuar rënie në shumën prej 37,930 mijë lekë.

Në muajin janar, borxhi u rrit me 60,829 mijë lekë, ndërsa në muajin shkurt, pati një rënie në shumën prej 43,326 mijë lekë, duke reflektuar një përmirësim në pagesat e tatimpaguesve.

Në fund të vitit, borxhi i TAP rezultoi në shumën prej 2,190,379 mijë lekë, ku krahasuar me çeljen e vitit ka pësuar një rritje në shumën prej 289,226 mijë lekë. Gjithashtu, vlera e këtij detyrimi në datë 31.12.2024 është përkatësisht principal në shumën prej 1,529,061 mijë lekë, gjoba në shumën prej 390,168 mijë lekë dhe interesa në shumën prej 271,150 mijë lekë.

3.5. Deklarata Individuale Vjetore e të Ardhurave (DIVA)

Borxhi për DIVA-n ka qenë relativisht i paqëndrueshëm gjatë vitit 2024, duke reflektuar luhajtje në pagesat dhe menaxhimin e detyrimeve.

-Në muajt janar, shkurt dhe mars, borxhi ka pësuar rënie progresive në shumën prej 26,621 mijë lekë.

-Në muajin prill, borxhi pësoi një rritje të konsiderueshme në shumën prej 36,754 mijë lekë, ndërsa në muajin maj, borxhi pati rritjen më të madhe të vitit 2024 në shumën prej 172,461 mijë lekë.

Në muajt vijues qershor-tetor borxhi pësoi rënie progresive në shumën prej 127,774 mijë lekë, ndërsa në muajt shtator, nëntor dhe dhjetor pësoi rritje në shumën prej 76,216 mijë lekë.

Në fund të vitit, borxhi i DIVA-s rezultoi në shumën prej 511,628 mijë lekë, ku krahasuar me çeljen e vitit ka pësuar një rritje në shumën prej 131,037 mijë lekë.

3.6. Tatimi në Burim

Borxhi për Tatimin në Burim ka qenë relativisht i qëndrueshëm gjatë vitit 2024, duke reflektuar një nivel të moderuar të arkëtimit dhe menaxhimit të detyrimeve.

- Tatimi në Burim ka pësuar rritje dhe rënie të moderuara, ku në muajt shkurt dhe prill, borxhi ka pësuar rritje të konsiderueshme, përkatësisht në shumën prej 138,977 mijë lekë dhe në shumën prej 131,399 mijë lekë.

Në fund të vitit, borxhi i Tatimit në Burim rezultoi në shumën prej 5,639,669 mijë lekë, ku krahasuar me çeljen e vitit ka pësuar një rritje në shumën prej 533,254 mijë lekë.

3.7. Tatime të Tjera

Borxhi për “*Tatime të tjera*” ka pasur një trend të ndryshueshëm gjatë vitit 2024, ku nga muaji në muaj ka pësuar rritje të moderuar, ndërsa vetëm në muajt prill, maj dhe tetor ka pësuar rënie në shumën totale prej 41,640 mijë lekë.

Në fund të vitit, borxhi për tatime të tjera rezultoi në shumën prej 20,556,502 mijë lekë, ku krahasuar me çeljen e vitit ka pësuar një rritje në shumën prej 65,640 mijë lekë.

Vlera e detyrimit për “*tatimin në burim, DIVA dhe të tjera*” në datë 31.12.2024 është përkatësisht principal në shumën prej 16,576,530 mijë lekë, gjoha në shumën prej 9,401,002 mijë lekë dhe interesa në shumën prej 730,267 mijë lekë.

3.8 Analizë e borxhit sipas moshës:

Nga auditimi i detyrimeve tatimore të papaguara, rezultoi se borxhi i akumuluar është i shpërndarë në periudha të ndryshme kohore, duke përfshirë detyrime të krijuara në tre muajt e fundit deri te borxhi me më shumë se dhjetë vjet.

- Borxhi *deri në 3 muaj* përbën një kategori që vlerësohet si borxh me probabilitet të lartë rikuperimi, duke qenë se detyrimet janë krijuar së fundmi dhe mund të jenë rezultat i mosrespektimit të afateve të pagesave nga tatimpaguesit aktivë.

Kjo kategori paraqitet në shumën prej 2,775,312 mijë lekë, ku pjesa më e madhe e borxhit është e lidhur me nga sigurimet shoqërore me 1,200,882 mijë lekë, e ndjekur TVSH-në në shumën prej 947,900 mijë lekë.

- Në kategorinë e *borxhit nga 3 deri në 6 muaj*, vërehet një ulje e ndjeshme në vlerën e borxhit, duke arritur në shumën prej 1,949,754 mijë lekë. Struktura e borxhit në këtë kategori përbëhet në pjesën më madhe nga detyrimet ndaj TVSH-së në shumën prej 677,351 mijë lekë, e ndjekur nga sigurimet shoqërore në shumën prej 623,792 mijë lekë dhe tatimi mbi fitimin në shumën prej 374,681 mijë lekë.

- Për detyrimet *nga 6 deri në 12 muaj*, evidentohet një rritje e ndjeshme e vlerës së borxhit, e cila arrin në shumën prej 5,265,036 mijë lekë, ku rritja më e madhe në këtë kategori vërehet në tatimin mbi fitimin, i cili paraqitet në shumën prej 1,980,291 mijë lekë. TVSH-ja vijon të jetë komponent i rëndësishëm në shumën prej 1,421,919 mijë lekë, si dhe sigurimet shoqërore në shumën prej 1,098,313 mijë lekë.

- Analiza e detyrimeve *nga 1 deri në 2 vjet* tregon një total borxhi në shumën prej 7,571,440 mijë lekë, duke reflektuar një kategori të ndërmjetme mes borxhit afatshkurtër dhe atij afatgjatë. TVSH-ja dhe tatimi mbi fitimin mbeten komponentët kryesorë të këtij borxhi, përkatësisht në shumën prej 2,378,921 mijë lekë dhe 2,428,574 mijë lekë.

- Për detyrimet nga 2 deri në 5 vjet, borxhi i akumuluar është në shumën prej 22,939,845 mijë lekë, duke përfaqësuar një rritje të ndjeshme krahasuar me kategoritë e mëparshme. Gjatë kësaj periudhe, Tatimi mbi Fitimin ka vlerën më të lartë të detyrimit në shumën prej 9,043,608 mijë lekë, duke vijuar me TVSH-në, e cila paraqitet në shumën prej 8,626,116 mijë lekë, dhe sigurimet shoqërore në shumën prej 3,526,589 mijë lekë.

- Borxhi mbi 5 vjet rezultoi në shumën prej 59,613,087 mijë lekë, me peshën më të lartë prej 48 ndaj totalit të detyrimeve të papaguara. TVSH-ja dhe Tatimi mbi fitimin kanë vlerën më të lartë të këtij borxhi, përkatësisht në shumën prej 20,228,808 mijë lekë dhe në shumën prej 15,346,720 mijë lekë, duke reflektuar një bazë të gjerë të tatimpaguesve që nuk kanë përmbushur detyrimet e tyre për një periudhë të gjatë kohe. Kjo kategori përfaqëson një risk të lartë të humbjes fiskale, pasi probabiliteti i arkëtimit të detyrimeve është shumë i ulët, për shkak të kohës së gjatë të mbartjes së detyrimeve dhe gjasave të larta për mbylljen e aktiviteteve të debitorëve.

- Detyrimet mbi 10 vjet përbëjnë shumën prej 24,695,384 mijë lekë, duke përfshirë shumën prej 9,149,381 mijë lekë nga TVSH-ja dhe shumën prej 5,361,572 mijë lekë nga tatimi mbi fitimin. Sigurimet shoqërore dhe kontributet shëndetësore përbëjnë shumën prej 3,984,925 mijë lekë, ndërsa tatimet e tjera paraqiten në shumën prej 5,575,763 mijë lekë.

4. Evidentimi dhe raportimi mujor i detyrimeve për veprime të mëtejshme nga sektorët përkatës.

- Metodologjia në raportimin e borxhit

Nga Sektori i Monitorimit dhe Analizës për Masat Shtrënguese në Drejtorinë e Mbledhjes së Detyrimeve të Papaguara Rajoni Qendror, për hartimin e evidencave mujore dhe raportimin e borxhit, bazuar në raportet e debitorëve bruto të sjella nga IT në DPT, në fillim të çdo muaji kryen këto veprime:

Bëhet filtrimi i detyrimeve bazuar në datën e kontabilizimit duke hequr detyrimet koherente, të cilat sipas DMDP nuk përmbushin kushtet për të qenë borxh, duke e bërë pasqyrimin e debitorëve bazuar në numrin e rasteve dhe vlerës së borxhit.

Raportimet bëhen sipas evidencave ku përfshihet:

- Evidenca sipas llojit (Për shembull në evidencat e muajit Dhjetor, nga Drejtoria janë cilësuar si periudhë koherente);
- Të gjitha taksat për periudhën 2412;
- Parapagimet 24-A;
- BV pa TVSH për periudhat 2410,2411,2412.

Në këtë evidencë pasqyrohet shtesa e borxhit duke u bazuar në datën e kontabilizimit.

Konkluzion: Për shkak të kufizimeve teknike të sistemit C@ts në përpunimin automatik të të dhënave, plotësimi i databazave është kryer në mënyrë manuale. Ky proces, ndonëse i domosdoshëm për vijimin e punës, ka rritur ngarkesën e punës dhe riskun për gabime njerëzore. Gjithashtu përpunimi i të dhënave manualisht paraqet risk të konsiderueshme në drejtim të saktësisë dhe përputhshmërisë së të dhënave, si dhe mund të ndikojë negativisht në pasqyrimin e plotë dhe të besueshëm të informacionit të nevojshëm për analizat institucionale.

Kjo qasje, përveç rritjes së rrezikut për gabime dhe pasaktësi, ka sjellë edhe mungesë unifikimi në metodologjitë e përdorura gjatë përpunimit dhe raportimit të të dhënave. Si pasojë, janë raportuar të dhëna që nuk janë gjithmonë të krahasueshme ndërmjet institucioneve, çka ndikon negativisht në cilësinë, saktësinë dhe vlerën analitike të informacionit të grumbulluar.

Nisur nga kjo situatë grupi i auditimit me qëllim vlerësimin e saktësisë së raportimit të borxhit në datën 31.12.2024, ka kryer verifikime mbi databazën e debitorëve.

Për subjekte mosdeklarues të cilët duhet të rezultojnë si debitorë më 31.12.2024

- Referuar testeve të kryera për llojin e detyrimit “Tatim fitimi” u konstatua se nga lista e debitorëve të raportuar me datën 31.12.2024 nuk përllogariten gjobat/interesat e lindura për mosdeklarimet e detyrimeve të periudhës koherente. Nga testimet e realizuara nga grupi i auditimit u konstatua se për llojin e tatimit “*Tatim fitimi*”, ku subjekti bën vetëdeklarimin, por pagesa kryhet në vitin pasardhës, nga DMDTP e Rajonit Qendror, nuk është pasqyruar në listën e detyrimeve me datë 31.12.2024 një shumë prej **2,912,724 lekë**. Kjo shumë i përket gjobave të aplikuara për mosdeklarimin e deklaratave tatimore të tipit 24-A dhe nuk është evidentuar si detyrim në pasqyrat përkatëse.

- Gjithashtu, referuar raportit të dërguar nga DMDTP e Rajonit Qendror mbi debitorët e datës 31.12.2024, grupi i auditimit ka testuar saktësinë e raportimit, duke krahasuar listën analitike të përcjellë me pagesat e kryera në muajin **Janar 2025**. Më specifikisht, testimi është kryer për detyrimin mbi TVSH dhe kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, ku janë evidentuar subjekte mosdeklarues të këtyre tatimeve, të cilët duhet të ishin klasifikuar si debitorë në muajin Dhjetor 2024.

Nga testimi i të dhënave për Rajonin Qendror, referuar DRT Tiranë, Durrës, Elbasan dhe Korçë, u konstatuan 356 raste në vlerë totale **21,820,081 lekë**, si si detyrime të paguara për TVSH në muajin Janar 2025 për efekt TVSH muaji Nëntor 2024 dhe më herët, të cilët nuk janë pjesë e debitorëve më 31.12.2024. Vlera totale përfshin: detyrime, interesa, gjoba. Rezultoi se vetëm për vitin 2024, kjo vlerë është 11,526,985 lekë. Lista e debitorëve pasqyrohet në Aneksin nr. 1/1 bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit

E njëjta situatë vërehet edhe në lidhje me detyrimet për kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, duke përfshirë Biznesin e Vogël me ose pa TVSH, të cilët kanë afat deklarimi dhe pagese çdo tre muaj. Nga analiza e të dhënave për Rajonin Qendror, që përfshin DRT Tiranë, Durrës, Elbasan dhe Korçë, janë identifikuar 570 raste me një vlerë totale prej 39,338,245 lekë, që përfaqësojnë pagesa të kryera në Janar 2025 për detyrime që i përkasin muajit Nëntor 2024 dhe më herët. Këto raste nuk figurojnë si debitorë në datën 31.12.2024. Vlera totale përfshin detyrimet principal, interesat dhe gjobat përkatëse.

- Për DRT Tiranë:

Nga testimi janë konstatuar 383 raste në vlerën 30,744,286 lekë, të cilët kanë paguar detyrimin në muajin Janar 2025 për efekt periudhe Nëntor 2024 dhe më herët dhe nuk janë njohur si debitorë më 31.12.2024. Vlera vetëm për vitin 2024 është 21,058,021 lekë. Vlera totale përfshin: detyrimet për principal, interesa, gjoba. . Lista e debitorëve pasqyrohet në Aneksin nr. 1/2 bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Për DRT Elbasan, Korçë dhe Durrës:

Nga testimi janë konstatuar 187 raste në vlerën 8,593,959 lekë lekë të cilët kanë paguar detyrimin në muajin Janar 2025 për efekt periudhe Nëntor 2024 dhe më herët dhe nuk janë njohur si debitorë më 31.12.2024. Vlera vetëm për vitin 2024 është 6,542,121 lekë. Vlera totale përfshin: detyrimet për principal, interesa, gjoba. Lista e debitorëve pasqyrohet në Aneksin nr. 1/3 bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

5. Mbi vlerësimin e masave shtrënguese të marra për mbledhjen e detyrimeve tatimore të papaguara

Akt-Marrëveshjet me Këste

Në rastet kur, Tatimpaguesi paraqet pranë DRT-së së juridiksionit, një kërkesë me shkrim, për të hyrë në një marrëveshje pagese me këste për detyrimet e papaguara, afatet dhe procedurat që ndiqen janë ato të

parashikuara në nenin 77 dhe 78, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar. Kërkesa duhet të trajtohet brenda 10 ditëve kalendarike nga data e paraqitjes.

Trajtimi i kërkesës bëhet nga Inspektori i kontrollit nga zyra që ka në ndjekje tatimpaguesin i cili analizon kërkesën, verifikon situatën e tatimpaguesit lidhur me gjendjen kreditore dhe debitorë, kryen kompensimin e detyrimeve nëse është e nevojshme dhe verifikon statusin e masave shtrënguese, kryesisht nëse kanë filluar procedurat e shitjes në ankand të pasurive të konfiskuara për efekt të detyrimit tatimor të pashlyer. DMDTP mban regjistrin analitik të aktmarrëveshjeve të pagesës me këste, mbi bazën e të dhënave të dërguara nga Rajonet.

U konstatua se për periudhën 01.01.2024-31.12.2024 në regjistrin e akt-marrëveshjeve nuk janë mbajtur evidenca për detyrimin total të subjekteve përpara lidhjes së akt-marrëveshje, me qëllim raportimin e saktë të detyrimit para lidhjes së akt-marrëveshjeve. Në mungesë të paraqitjes së detyrimit real, grupi i auditimit nuk mund të testojë nëpërmjet databazës nëse vlera e raportuar e pagesës rezultoi sa 20% e detyrimit total. Nga auditimi me zgjedhje i akt-marrëveshjeve për periudhën u konstatua se, detyrimi i subjekteve paraqitet në akt-marrëveshje si vlerë dhe e detajuar sipas zërave, por nuk është i shoqëruar me dokumentacion bashkëlidhur, që të vërtetojë detyrimin në kohë reale nga sistemi C@ts. Për sa më sipër, u konstatua se akt-marrëveshja është përdorur si një mënyrë për të mos kaluar në masa të tjera shtrënguese nga ana e Drejtorisë së Mbledhjes së Detyrimeve të Papaguara. Nga ana e Drejtorisë së Mbledhjes së Detyrimeve të Prapambetura masat e marra janë me urdhër bllokim të llogarive bankare. Nuk konstatohen masa shtrënguese të plota.

Referuar verifikimit të akt-marrëveshjeve të lidhura në muajin Nëntor-Dhjetor 2024, rezultoi se janë lidhur 55 akt-marrëveshje, nga të cilat 46 prej tyre janë hedhur në sistemin C@ts:

- 36 akt-marrëveshje nga DRT Tiranë;
- 11 akt-marrëveshje nga DRT Korçë;
- 5 akt-marrëveshje nga DRT Durrës;
- 3 akt-marrëveshje nga DRT Elbasan.

Në 7 raste rezultoi se, në akt-marrëveshje nuk është ndarë gjoba/interesi në të regjistruar/ paregjistruar.

Në total, për këto 55 raste evidentohen **gjoba të paregjistruara në vlerën 14,550,475 lekë dhe interesa të paregjistruar në vlerën 6,604,258 lekë, duke sjellë nënvlerësim të vlerës së raportuar të borxhit.** Lista e detajuar e akt marrëveshjeve pasqyrohet në Aneksin nr. 1/4 bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Veprimet e mësipërme janë kryer në kundërshtim me *Manualin e Mbledhjes së Borxhit, Pika 3.2.1 – Dokumentimi i masave të ndërmarra: “Për çdo veprim të ndërmarrë nga strukturat e borxhit në drejtim të ndjekjes së detyrimit tatimor të papaguar duhet të mbahet dokumentacion përkatës në dosje, si në format fizik ashtu edhe elektronik. Çdo vendimmarrje administrative apo masë shtrënguese duhet të jetë e dokumentuar dhe e aksesueshme në sistemin elektronik; Pika 3.2.3 – Raportimi dhe analiza e masave, “Drejtoria Rajonale dhe strukturat përkatëse të DMDTP janë të detyruara të përgatisin raporte analitike dhe përmbledhëse periodike (muajore, tremujore, vjetore) mbi veprimtarinë e tyre, numrin e masave të ndërmarra, rezultatet në vlerë dhe në përqindje, si dhe analizën e performancës në lidhje me borxhin tatimor.”*

Masat shtrënguese përgjatë vitit 2024

Nga të dhënat e vendosura në dispozicion, grupi i auditimit ka analizuar dhe paraqitur në mënyrë përmbledhëse, llojet e masave shtrënguese të ndërmarra përgjatë vitit 2024 nga Rajoni Qendror, referuar listës në Aneksin nr. 1/5 “Masat shtrënguese të ndërmarra përgjatë vitit 2024 nga Rajoni Qendror” bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Nga auditimi u konstatua se, masat e marra për njoftimet nuk evidentohet në mënyrë të qartë, nëse numri i rasteve për njoftimet përllëgaritet për secilin debitor si rast unik apo si njoftim i përsëritur.

Referuar Aneksin nr. 1/5 bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit në lidhje me “Efektivitetin e masave shtrënguese” përqindja e arkëtimit kundrejt masave shtrënguese rezultoi në një nivel pothuajse të papërfillshëm krahasuar me detyrimin dhe vlerën e vendosur në masë. Për më tepër, rezultoi se nuk janë ezauruar masat si në vijim:

-Urdhër sekuestrimi

-Njoftim transferimi detyrimi tatimor palës së tretë

-Njoftim dhe kërkesë për të paguar nga palët e treta në zbatim të nenit 98

-Njoftim për transferimin e detyrimit Ortakut, Aksionerit, Administratorit

-Kërkesë për pezullim të aktivitetit në Doganë

-Konfiskim i 50% të xhiros ditore

Nga sa më sipër u konstatua mungesa e efektivitetit të masave shtrënguese të ndërmarra për arkëtimin e borxhit të tatimpaguesve, si dhe moszbatimi i tyre në mënyrë shteruese, e cila ka ndikuar që stoku i borxhit të vijojë me rritje.

Në zbatim të nenit 89 pika 2 të Ligjit Nr.9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në RSH” i ndryshuar, thuhet;

2. Nëse tatimpaguesi nuk përdor të drejtën e ankimit dhe nuk paguan detyrimin tatimor, administrata tatimore duhet ta mbledhë tatimin, duke përdorur njërën ose disa prej mënyrave, të parashikuara Gjithashtu, në funksion të mbledhjes së detyrimit tatimor të papaguar të tatimpaguesit, administrata tatimore mund të angazhojë strukturat e saj për të verifikuar dhe monitoruar në vend aktivitetin tregtar të tatimpaguesit, me qëllim konfiskimin në fund të çdo dite të një shume jo më pak se 50 për qind të qarkullimit të realizuar, por jo më shumë se detyrimi tatimor, për të cilin ka filluar procedura e mbledhjes me forcë të detyrimeve tatimore, për llogari të detyrimeve tatimore të pashlyera të tatimpaguesit. Paga e shumës së qarkullimit të sekuestruar kalohet në llogarinë bankare të administratës tatimore ditën e nesërme. Tatimpaguesi, për të cilin administrata tatimore ka filluar mbledhjen me forcë të detyrimeve tatimore të papaguara, nuk mund të kryejë transferim të shumave të parave nga llogaria e tij apo të shesë\ të transferojë aktivet ose kapitalet e shoqërisë, me përjashtim të rasteve kur, nëpërmjet shitjes\transferimit të aktiveve, synohet shlyerja në masën 100 për qind e detyrimit tatimor të papaguar.”

Nga auditimi rezultoi se nga Sektorit i Monitorimit, Analizës për Masat Shtrënguese nuk ishin dërguar/përgatitur lista tatimpaguesish të veçantë, të planifikuar për konfiskim të 50% të qarkullimit të realizuar (por jo më shumë se detyrimi), te Sektori i Procedurave Ligjore të Mbledhjes me Forcë për zbatim, referuar neneve 35 dhe 36 pikat 7 të rregullores së brendshme miratuar me Urdhër nr.192, datë 12.08.2020, dhe Manualit të Mbledhjes me Forcë.

Bazuar neneve 31 dhe 32 pikat 6 të rregullores së brendshme të Administratës Qendrore të Tatimeve dhe Manualit të Mbledhjes me Forcë në zbatim të programit të auditimit, grupi i auditimit i kërkoi Sektorit të Procedurave Ligjore të Mbledhjes me Forcë, evidencë mbi tatimpaguesit të cilët i janë nënshtruar verifikimit dhe monitorimi në vend të aktivitetit tregtar tatimpaguesve me detyrime të papaguara, me qëllim konfiskimin e jo më pak se 50% të qarkullimit të realizuar (por jo më shumë se detyrimi).

Nga DMDTP për vitin 2024 rezultoi se **në asnjë rast** nuk është kryer procedura e verifikimit dhe monitorimi në vend të aktivitetit tregtar, tatimpaguesve me detyrime të papaguara, me qëllim konfiskimin e jo më pak se 50% të qarkullimit të realizuar (por jo më shumë se detyrimi).

Kjo situatë vë në pah një boshllëk të rëndësishëm në zinxhirin e ndjekjes së ekzekutimit të masave shtrënguese, duke sjellë nevojën për përmirësimin e mekanizmave të ndjekjes, efektivitetit të administratës tatimore dhe rishikimit të procedurave të aplikimit dhe ndjekjes së masave shtrënguese.

Bazuar në manualin e mbledhjes së detyrimeve të papaguara, miratuar me shkresën nr.11912 prot., datë 29.06.2021, pika 3.3.2, përcaktohet: “.....inspektorët e sektorit të monitorimit dhe zbatimit në terren të masave shtrënguese në DMDTP në rajone, duhet të plotësojnë në mënyrë të vazhdueshme regjistrin e masave shtrënguese të marra ndaj tatimpaguesve dhe të ngarkojnë çdo akt administrative në funksion të masave shtrënguese brenda javës të çështjet e menaxhimit të borxhit të hapur për ndjekjen e mbledhjes së detyrimeve. Ndërkohë që strukturat drejtuese kontrollojnë zbatimin e këtyre detyrave.”, pika 4.2.2, përcaktohet: “...gjithashtu përdoruesi i sistemit, ka të drejtë të ngarkoj në këtë folder, çdo dokument (akt administrative), që administron organi tatimor të cilët kanë të bëjnë me çështje të dhe menaxhimin e mbledhjes së borxhit tatimor..”.

Konstatim:

Nga rakordimi i të dhënave nga sistemi C@TS me evidencat e raportimit të masa shtrënguese të vëna në dispozicion nga drejtoria janë konstatuar diferenca, çka tregon se jo të gjitha masat shtrënguese janë hapur në sistem duke ndikuar në kontrole joefektive dhe transparente për procedurat e ndjekura në lidhje me punën e bërë për rikuperimin e borxhit, dhe mungesën e gjurmës së operacioneve të detyrimit të papaguar të klasifikuar si borxh.

Grupi i auditimit bazuar në mbajtja e regjistrin të masave ligjore shtrënguese të zbatuara konstatoi se:

Sektori përgjegjës dispononte një regjistër të miratuar për pasqyrimin e këtyre masave. Megjithatë, analizimi i dokumentacionit përkatës vërtetoi mangësi të theksuara në përmbajtjen dhe përditësimin e të dhënave të regjistrin, konkretisht:

Në rubrikën "Subjekti" dhe "NIPT" ishin të pasqyruara vetëm një herë për tatimpagues me masa të përsëritura, duke shkaktuar:

- Mospasqyrim të borxheve të reja në periudha të ndryshme;
- Mospërfshirje të masave të përsëritura brenda vitit;
- Mungesë të saktësimin të periudhës së krijimit të borxhit.

Në rubrikën "Periudha e krijimit të borxhit" dhe "Lloji i tatimit" rezultuan të paplotësuara ose të pasakta.

Në rubrikën "Shuma e detyrimit" nuk ishte e rifreskuar me të dhënat mujore.

Në rubrikën "Marrëveshje për pagesë me këste" nuk korrespondonte me evidencat e marrëveshjeve të lidhura.

Në rubrikën sistemime rezultoi të mos pasqyrohej asnjë lloj informacioni (e paplotësuar).

Në rubrikën gjendja në fund rezultoi të mos pasqyrohej asnjë lloj informacioni (e paplotësuar).

Në rubrikën "Proces gjyqësor", "Arkëtime", "Sistemime", "Gjendja në fund" rezultuan të paplotësuara.

Në rubrikën "Çbllokim bankar" përmbante të dhëna që nuk përputheshin me evidencat e raportuara.

Mosplotësimi i saktë dhe i vazhdueshëm i rubrikave përkatëse në regjistrin e masave ligjore shtrënguese të aplikuar ndaj secilit tatimpagues ndikon në mospërputhje midis evidencave të mbajtura nga drejtoria dhe raporteve periodike të DMDTP, duke ndikuar në cilësinë e raportimeve dhe në mos dokumentimin e gjurmës së auditimit.

2.1.2. Drejtoria e Mbledhjes së Detyrimeve Tatimore të Papaguara në Rajonin Jugor

Struktura e DMDP, Rajoni Jugor rezultoi një drejtori e krijuar mbi bazën ligjore, e cila ka qendrën në Fier dhe ushtronte funksionin e saj në juridiksionin territorial të Drejtorive Rajonale Tatimore Fier, Vlorë, Gjirokastrë, Sarandë.

Drejtoria funksionon e përbërë nga 3 (tre) sektorë:

4. Sektori i Monitorimit, Analizës për Masat Shtrënguese,
5. Sektori i Zbatimit në Terren të Masave Shtrënguese,
6. Sektori i Procedurave Ligjore të Mbledhjes me Forcë.

Struktura për periudhën e vitit 2024, DMDTP Rajoni Jugor krahasuar me strukturën e miratuar në Drejtorinë e Përgjithshme Tatimore, paraqitet si mëposhtë:

Rajoni Jugor (1+3+20)	Plan sipas urdhrin KM nr. 69, dt. 26.05.2023	Pas impement. të strukturës dt.01.02.2024	Fakt 31.12.2024	Diferenca Plan /Fakt
Drejtor Drejtorie	1	1	1	-
Spektori i Monitorimit, Analizës për masat shtrënguese				
- Përgjegjës Spektori	1	0	0	1
- Inspektorë	10	8	9	1
Spektori i Zbatimit në Terren të Masave Shtrënguese				
- Përgjegjës Spektori	1	0	0	1
- Inspektorë	7	7	6	1
Spektori i Procedurave Ligjore të mbledhjes me forcë				
- Përgjegjës Spektori	1	1	1	-
- Inspektorë	3	3	3	-
	24	20	20	4

Burimi: Drejtoria e Burimeve Njerëzore në DPT, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së


Sa më sipër, u konstatua se struktura e DMDTP Rajoni Jugor është miratuar me 24 punonjës (1 drejtor drejtorie, 3 përgjegjës sektori dhe 20 inspektorë). Më datë 01.02.2024 rezultojnë 20 punonjës në total, po ashtu dhe në fund të vitit 2024, me një diferencë nga plani i miratuar me 4 punonjës, ku 2 nga këto pozicione vakante janë përgjegjës sektori.

1 Analizimi i detyrimeve tatimore sipas statusit të tatimpaguesit.

Në fund të vitit 2024, numri i përgjithshëm i tatimpaguesve me borxh rezultoi të jetë 39,506 raste, duke përfshirë si subjekte aktive, ashtu edhe ato pasive. Nga analiza e të dhënave vërehet se pesha më e madhe e borxhit tatimor rrjedh nga tatimpaguesit pasivë, të cilët përbëjnë 22,510 raste dhe kanë një vlerë të detyrimeve të papaguara në shumën prej 7,361,866 mijë lekë.

Në Drejtorinë Rajonale Qendrore rezultojnë 16,996 raste aktive, me një borxh të akumuluar në shumën prej 5,223,975 mijë lekë.

Detyrimi i papaguar sipas Drejtorive Rajonale Tatimore të cilat përfshihen në raportimin e borxhit në Drejtorinë e Mbledhjes së Detyrimeve Tatimore të Papaguara në Rajonin Jugor paraqitet si më poshtë:



Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të DPT

2. Analizimi i detyrimeve tatimore të ndara sipas pronësisë.

Borxhi tatimor i akumuluar në vitin 2024 ka një shpërndarje midis bizneseve të mëdha, biznese të vogla dhe ndërmarrjeve shtetërore/enteve buxhetore. Këto shifra janë një tregues i rëndësishëm i disiplinës fiskale të subjekteve ekonomike dhe efektivitetit të administratës tatimore në arkëtimin e të ardhurave të buxhetit të shtetit.

- Bizneset e mëdha përbëjnë pjesën më të madhe të borxhit tatimor të regjistruar deri më 31 dhjetor 2024, me një vlerë prej 8,755,118 mijë lekë ose 70% të detyrimit.

3. Analizimi i detyrimeve sipas llojit të tatimit, i ndarë në principal/gjobë/interesa dhe ecuria e tyre çdo muaj

Nga të dhënat e vëna në dispozicion dhe të analizuara rezultoi se detyrimet e papaguara mbeten të përqendruara kryesisht tek Tatimi mbi Fitimin dhe TVSH, ndërsa tatime të tjera, si sigurimet shoqërore dhe tatimi në burim, kanë një ndikim më të moderuar në stokun total të borxhit.

3.1. Tatimi mbi Fitimin

Në fillim të vitit, borxhi i regjistruar për këtë kategori ishte 2,097,706 mijë lekë, duke pësuar ndryshime gjatë vitit 2024 si më poshtë vijon:

- Në muajin janar, detyrimi u rrit me 43,360 raste, ndërsa shuma pësoi një ulje prej 12,082 mijë lekë, si rezultat i pagesave të kryera nga tatimpaguesit për detyrimet e mëparshme.
- Në shkurt, borxhi shënoi një rritje prej 43,860 rastesh, duke u shtuar me 20,027 mijë lekë.
- Në mars, detyrimi shënoi një rritje të konsiderueshme prej 48,374 rastesh, duke arritur një vlerë shtesë prej 222,992 mijë lekë.
- Në prill, ndonëse numri i rasteve u rrit me 48,666, borxhi pësoi një ulje me 50,618 mijë lekë, duke reflektuar arkëtimet nga debitorët.
- Nga muaji maj deri në dhjetor, borxhi ka pësuar ulje të vazhdueshme, ku ndryshimet mujore progresive arrijnë në shumën totale prej 101,552 mijë lekë.

Në fund të vitit, borxhi i regjistruar për Tatimin mbi Fitimin paraqitet në shumën 2,176,472 mijë lekë, duke reflektuar një rritje neto prej 78,766 mijë lekë krahasuar me fillimin e vitit. Nga krahasimi i numrit të debitorëve në fund të vitit me çeljen e tij, rezultoi se numri i rasteve ka mbetur relativisht i qëndrueshëm, por me një tendencë të lehtë uljeje.

3.2. Tatimi mbi Vlerën e Shtuar (TVSH)

Në fillim të vitit, borxhi i regjistruar për këtë kategori ishte 4,347,972 mijë lekë, duke pësuar ndryshime gjatë vitit 2024 si më poshtë:

- Në muajin janar, borxhi u rrit me 44,825 mijë lekë, ndërsa në muajin shkurt shënoi një ulje prej 11,247 mijë lekë.
- Në muajt mars dhe prill, pati rritje të moderuar, me një total shtese prej 19,704 mijë lekë.
- Në muajt maj dhe qershor, borxhi shënoi luhajtje, duke rënë me 4,558 mijë lekë në maj dhe u rrit me 29,909 mijë lekë në qershor.
- Nga korriku deri në tetor, borxhi u rrit ndjeshëm, veçanërisht në muajin korrik me 53,100 mijë lekë dhe tetor me 26,130 mijë lekë.
- Në nëntor dhe dhjetor, borxhi ra me një total prej 25,895 mijë lekë, duke reflektuar pagesa të detyrimeve nga tatimpaguesit.

Në fund të vitit, vlera e përgjithshme e detyrimeve për TVSH-në ishte 4,544,544 mijë lekë, me një rritje neto prej 196,572 mijë lekë krahasuar me fillimin e vitit. Gjatë vitit u vu re një trend rritës në periudhën qershor-tetor dhe një ulje graduale në fund të vitit.

3.3. Sigurimet Shoqërore

Në fillim të vitit, borxhi i regjistruar për Sigurimet Shoqërore ishte 3,225,559 mijë lekë, duke pësuar ndryshime gjatë vitit 2024 si më poshtë:

- Në muajin janar, borxhi u rrit me 98,053 mijë lekë, duke arritur në vlerën 3,323,612 mijë lekë.
- Në shkurt dhe mars, shënoi ulje përkatësisht me 15,728 mijë lekë dhe 14,434 mijë lekë.

- Në prill, pati një rritje të ndjeshme prej 133,411 mijë lekë, duke e çuar detyrimin në 3,426,861 mijë lekë, dhe në muajin maj, borxhi ra ndjeshëm me 56,649 mijë lekë, por në qershor pati një rritje të lehtë prej 11,628 mijë lekë.
 - Nga muaji korrik deri në shtator, borxhi pësoi luhatje, duke u rritur në korrik me 96,323 mijë lekë dhe më pas duke u ulur me 19,011 mijë lekë në gusht dhe 35,327 mijë lekë në shtator.
 - Në tetor dhe nëntor, borxhi u rrit me 51,486 mijë lekë dhe 88,054 mijë lekë, duke arritur në 3,563,365 mijë lekë.
 - Në dhjetor, u regjistrua një ulje prej 25,830 mijë lekë, duke e mbyllur vitin me një vlerë prej 3,537,535 mijë lekë.
- Në fund të vitit, detyrimi për Sigurimet Shoqërore rezultoi në 3,537,535 mijë lekë, me një rritje neto prej 311,976 mijë lekë krahasuar me fillimin e vitit. Vërehet një trend i luhatur, me rritje të konsiderueshme në muajt prill, korrik dhe nëntor, ndërsa uljet më të ndjeshme ndodhën në maj, gusht dhe dhjetor.

3.4. Tatimi mbi të Ardhurat Personale (TAP)

Në fillim të vitit, borxhi i regjistruar për TAP në Rajonin Jugor paraqitet 246,859 mijë lekë, duke pësuar ndryshime gjatë vitit 2024 si më poshtë:

- Në muajin janar, borxhi u rrit me 5,741 mijë lekë, duke arritur në vlerën 252,600 mijë lekë.
- Në muajt shkurt dhe mars, u regjistruan rritje në shumën prej 9,076 mijë lekë, ndërsa në prill u shënuar një ulje e lehtë prej 3,358 mijë lekë.
- Në muajt maj dhe qershor, rezultoi një stabilitet relativ, me një ulje të vogël prej 544 mijë lekë në maj dhe një rritje prej 273 mijë lekë në qershor.
- Në muajt korrik dhe gusht, borxhi pësoi një ulje me 2,230 mijë lekë, por më pas në gusht u rrit me 4,091 mijë lekë.
- Në muajt shtator dhe tetor, borxhi u ul me 3,439 mijë lekë, ndërsa në tetor u shënuar një rritje prej 174 mijë lekë.
- Në muajt nëntor dhe dhjetor, borxhi u rrit përkatësisht me 2,025 mijë lekë dhe 10,177 mijë lekë, duke arritur në 276,388 mijë lekë në fund të vitit.

Në fund të vitit, vlera e përgjithshme e detyrimeve për TAP në Rajonin Jugor paraqitet në shumën 276,388 mijë lekë, me një rritje neto prej 29,529 mijë lekë krahasuar me fillimin e vitit. Vërehet një trend rritës gjatë vitit, me disa luhatje të vogla, ndërsa rritja më e madhe është regjistruar në muajin dhjetor.

3.5. DIVA

Në fillim të vitit, borxhi i regjistruar për DIVA në Rajonin Jugor paraqitet në vlerën prej 28,138 mijë lekë, duke pësuar ndryshime gjatë vitit 2024 si më poshtë:

- Nga muaji janar deri në mars, borxhi pati luhatje të vogla, me një rritje totale prej 937 mijë lekë, duke arritur në vlerën prej 29,075 mijë lekë.
- Në muajin prill, u regjistrua një rritje prej 26,509 mijë lekë, duke arritur në vlerën prej 55,584 mijë lekë, ndërsa në maj dhe qershor, borxhi u ul me 16,167 mijë lekë
- Nga muaji korrik deri në nëntor, borxhi u rrit gradualisht, duke arritur në vlerën prej 56,872 mijë lekë në fund të muajit nëntor.
- Në muajin dhjetor, u shënuar një rritje e konsiderueshme prej 11,339 mijë lekë, duke e mbyllur vitin me 68,211 mijë lekë.

Në fund të vitit, borxhi u rrit me 40,073 mijë lekë, me rritjet kryesore në prill dhe dhjetor, ndërsa uljet më të ndjeshme ndodhën në maj dhe qershor.

3.6. Tatimi në Burim

Në fillim të vitit, borxhi i regjistruar për Tatimin në Burim në Rajonin Jugor paraqitet në vlerën 291,837 mijë lekë, duke pësuar ndryshime gjatë vitit 2024 si më poshtë:

- Nga muaji janar deri në muajin mars, borxhi u rrit në shumën 9,582 mijë lekë, duke arritur në 301,419 mijë lekë.
- Nga muaji prill deri në qershor, u regjistruan luhatje të vogla, me një ulje prej 1,885 mijë lekë në prill dhe një rritje prej 1,890 mijë lekë në qershor.
- Nga muaji korrik deri në gusht, borxhi u rrit me 15,749 mijë lekë, duke arritur në vlerën totale prej 317,173 mijë lekë.
- Në muajt shtator dhe tetor, u shënua një rënie progresive prej 8,375 mijë lekë, ndërsa në muajin nëntor dhe dhjetor, borxhi u rrit sërish me 7,185 mijë lekë, duke e mbyllur vitin 2024 në vlerën 315,983 mijë lekë.

Në përfundim të vitit, borxhi u rrit me 24,146 mijë lekë, me rritjet kryesore në periudhën mars-gusht dhe disa luhatje në fund të vitit.

3.7. Tatime të tjera


Në fillim të vitit, borxhi i regjistruar për kategorinë “Të tjera” paraqitet në vlerën prej 1,617,661 mijë lekë, duke pësuar ndryshime gjatë vitit 2024 si më poshtë:

- Nga muaji janar deri në mars, borxhi u rrit me një vlerë prej 50,714 mijë lekë, duke arritur në 1,668,875 mijë lekë.
- Në muajt prill dhe maj, pati një ulje graduale prej 9,580 mijë lekë, duke reflektuar pagesa të detyrimeve.
- Nga muaji qershor deri në gusht, borxhi u rrit me 10,489 mijë lekë, dhe nga muaji shtator deri në nëntor, u shënua një ulje progresive prej 10,246 mijë lekë, ndërsa në muajin dhjetor, borxhi u rrit me 5,223 mijë lekë, duke e mbyllur vitin në vlerën prej 1,666,709 mijë lekë.

Nga krahasimi i mbylljes me fillimin e vitit rezultoi se borxhi u rrit me 49,048 mijë lekë, me luhatje të lehta gjatë vitit dhe rritje më të theksuar në muajt shkurt dhe gusht.

3.8 Analizë e borxhit sipas moshës:

Nga auditimi i detyrimeve tatimore të papaguara, rezultoi se borxhi i akumuluar është i shpërndarë në periudha të ndryshme kohore, duke përfshirë detyrime të krijuara në tre muajt e fundit deri të borxhi me më shumë se dhjetë vjet.



Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të DPT

- *Borxhi deri në 3 muaj* përfaqëson një total prej 503,225 mijë lekë, ku pjesa më e madhe përbëhet nga sigurimet (239,715 mijë lekë) dhe TVSH-ja (181,857 mijë lekë). Kjo kategori vlerësohet me probabilitet të lartë rikuperimi, pasi përfshin tatimpagues aktivë që mund të kenë vonuar pagesat për arsye operative.
- *Borxhi nga 3 deri në 6 muaj*, në vlerën 392,484 mijë lekë, ka një përbërje të ngjashme: sigurimet (159,931 mijë lekë) dhe TVSH-ja (154,006 mijë lekë) janë komponentët kryesorë. Edhe kjo kategori mban një potencial të arsyeshëm rikuperimi, por me një rrezik pak më të rritur për mosshlyerje krahasuar me kategorinë e mëparshme.
- *Borxhi nga 6 deri në 12 muaj*, në vlerën 680,184 mijë lekë, tregon një rritje të ndjeshme në Tatimin mbi Fitimin (182,768 mijë lekë) dhe TVSH (167,089 mijë lekë), duke sinjalizuar përkeqësim të disiplinës tatimore nga një pjesë e bizneseve që kanë kaluar prapë e borxhit afatshkurtër.
- Në kategorinë e *borxhit nga 1 deri në 2 vjet*, borxhi total arrin në 902,329 mijë lekë, me sigurimet (351,032 mijë lekë) dhe TVSH (247,635 mijë lekë) që vazhdojnë të dominojnë. Kjo kategori sugjeron një përkeqësim të gjendjes financiare të një pjese të tatimpaguesve, me probabilitet mesatar rikuperimi. Sa më sipër, nisur nga mosha e borxhit, kjo kategori paraqet me një probabilitet të ulët arkëtimi, duke qenë se shumë nga këto detyrime i përkasin subjekteve që mund të jenë mbyllur ose që janë në proces gjyqësor me administratën tatimore:
- *Borxhi nga 2 deri në 5 vjet* paraqitet në vlerën 2,737,314 mijë lekë, duke shënuar një rritje të konsiderueshme. TVSH (1,328,227 mijë lekë) dhe Tatimi mbi Fitimin (753,605 mijë lekë) janë zërat kryesorë. Kjo kategori paraqet një probabilitet të ulët rikuperimi, pasi shumë nga detyrimet mund të lidhen me subjekte në vështirësi ose joaktive.
- *Borxhi mbi 5 vjet* përbën pjesën më të madhe të borxhit total, me 7,253,712 mijë lekë, ku dominon Sigurimi Shoqëror (2,483,845 mijë lekë) dhe TVSH (2,465,460 mijë lekë), ndërkohë që Tatimi mbi Fitimin arrin 984,828 mijë lekë.
- *Borxhi mbi 10 vjet*, me një shumë 116,593 mijë lekë, është i papërfillshëm në krahasim me totalin, por mbetet shumë i vështirë për t'u rikuperuar. Përbërësit kryesorë janë Tatimi mbi Fitimin (69,405 mijë lekë) dhe sigurimet (33,704 mijë lekë).

Vlera totale e borxhit tatimor për Rajonin Jugor është 12,585,841 mijë lekë, ku rreth 58% i përket kategorisë së borxhit mbi 5 vjet. Kjo tregon nevojën për përpjekje më të fokusuar në rikuperimin e borxheve afatshkurtra dhe rivlerësimin e portofolit të borxheve të vjetra, për të shmangur humbje të mëtejshme fiskale.

4. Mbi evidentimin dhe raportimin mujor i detyrimeve për veprime të mëtejshme nga sektorët përkatës.

Metodologjia në raportimin e borxhit:

Nga Sektori i Monitorimit dhe Analizës për Masat Shtrënguese në Drejtorinë e Mbledhjes së Detyrimeve të Papaguara Rajoni Jugor për hartimin e evidencave mujore dhe raportimin e borxhit, bazuar në raportet e debitorëve bruto të sjella nga DPT, në fillim të çdo muaji kryen këto veprime:

Bëhet filtrimi i detyrimeve bazuar në datën e kontabilizimit duke hequr detyrimet koherente të cilat sipas DMDP nuk përmbushin kushtet për të qenë borxh, duke e bërë pasqyrimin e debitorëve bazuar në numrin e rasteve dhe vlerës së borxhit.

Raportimet bëhet sipas evidencave ku përfshihet: Evidenca sipas llojit (Për shembull në evidencat e muajit Dhjetor, nga Drejtoria janë cilësuar si periudhë koherente:

- Të gjitha taksat për periudhën 2412,
- Parapagimet 24-A,
- BV pa TVSH për periudhat 2410,2411,2412

Në këtë evidence pasqyrohet shtesa e borxhit, duke u bazuar në datën e kontabilizimit.

Evidenca sipas burimit të krijimit;

- Sipas shtesës së borxhit që ka dalë në evidencën sipas llojit bëhet ndarja e borxhit, i cili është krijuar nga vetdeklarimi apo borxhi i krijuar nga kontrollet, detyrimet e vlerësuara nga administrata tatimore (njoftim vlerësime, gjoba sistemi etj); Evidenca Detyrim gjobë/interes; Evidenca Detyrim gjobe/interes përpunohet për totalin e debitorëve pasi janë hequr periudhat koherente, duke e pasqyruar sa është vlera e detyrimit principal, gjobe, interes.; Evidenca sipas statusit; Evidenca sipas statusit përpunohet për totalin e debitorëve pasi janë hequr periudhat koherente, duke e pasqyruar sa është vlera e borxhit me statusin aktiv dhe në statusin Pasiv/Kërkesë për ç' regjistrim; Evidentohen transferimet/largimet e debitorëve nga Rajoni Jugor në Rajonet e tjera dhe shumat përkatëse të detyrimit; Evidentohen transferimet/ardhjet e debitorëve nga Rajonet e tjera në Rajonin Jugor dhe shumat përkatëse të detyrimit; Evidentohen detyrimet me marrëveshje pagesë me këste; Evidentohen detyrimet në proces gjyqësor.

Konstatim:

Nga auditimi u konstatua se nga lista e debitorëve të raportuar me datën 31.12.2024 nuk përlllogariten gjobat/interesat e lindura për mosdeklarimet e detyrimeve të periudhës koherente. Nga testimet e realizuara nga grupi i auditimit referuar metodologjisë së përdorur nga drejtoria u konstatua një diferencë në shumë prej **7,281,646 lekë** për llojin e tatimit "Tatim fitimi" e pa deklaruar si detyrim. Kjo shumë i përket gjobave të aplikuara për mosdeklarimin e deklaratave tatimore të tipit 24-A dhe nuk është evidentuar si detyrim në pasqyrat përkatëse.

Konkluzion: Për shkak të kufizimeve teknike të sistemit C@ts në përpunimin automatik të të dhënave, plotësimi i databazave është kryer në mënyrë manuale. Ky proces, ndonëse i domosdoshëm për vijimin e punës, ka rritur ngarkesën e punës dhe riskun për gabime njerëzore. Gjithashtu përpunimi i të dhënave manualisht paraqet risk të konsiderueshëm në drejtim të saktësisë dhe përputhshmërisë së të dhënave, si dhe mund të ndikojë negativisht në pasqyrimin e plotë dhe të besueshëm të informacionit të nevojshëm për analizat institucionale.

Kjo qasje, përveç rritjes së rrezikut për gabime dhe pasaktësi, ka sjellë edhe mungesë unifikimi në metodologjitë e përdorura gjatë përpunimit dhe raportimit të të dhënave. Si pasojë, janë raportuar të dhëna që nuk janë gjithmonë të krahasueshme ndërmjet institucioneve, çka ndikon negativisht në cilësinë, saktësinë dhe vlerën analitike të informacionit të grumbulluar."

Për subjekte mosdeklarues të cilët duhet të rezultojnë si debitorë më 31.12.2024

Referuar raportit të debitorëve të datës 31.12.2024, të dërguar nga Drejtoria e Menaxhimit të Detyrimeve Tatimore të Papaguara (DMDTP), grupi i auditimit ka kryer testim krahasues ndërmjet listës analitike të debitorëve me datën 31.12.2024 dhe pagesave të realizuara në muajin janar 2025. Gjatë testimit, u evidentuan **25 subjekte me një vlerë totale prej 6,273,511 lekë**, si detyrime të paguara për TVSH-në në muajin Janar 2025 për efekt të muajit Nëntor 2024 dhe më herët, të cilët nuk ishin pasqyruar si debitorë në raportimin e datës 31.12.2024, duke dikuar në pasaktësinë dhe besueshmërinë e informacionit të raportuar mbi stokun e borxhit tatimor në fund të vitit. Lista e debitorëve pasqyrohet në Aneksin nr. 2/1 bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Ndërsa, për detyrimin mbi kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, janë testuar bizneset me përjashtim të Biznesit të Vogël me TVSH dhe atij pa TVSH, të cilët kanë afat deklarimi dhe pagese 3 muaj. Nga testimi i të dhënave për Rajonin Jugor, referuar DRT Fier, Vlorë, Sarandë, Berat dhe Gjirokastrë, u konstatuan **100 raste në vlerë totale 18,607,606 lekë**, si detyrime të paguara për kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në muajin Janar 2025 për efekt të muajit Nëntor 2024 dhe më herët, të cilët nuk janë pjesë e debitorëve më 31.12.2024. Vlera totale përfshin: detyrimet për principal,

interesa, gjoba. Për vitin 2024 është 18,083,743 lekë, duke dikuar në pasaktësinë dhe besueshmërinë e informacionit të raportuar mbi stokun e borxhit tatimor në fund të vitit. Lista e debitorëve pasqyrohet në Aneksin nr. 2/2 bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Subjektet e listuara sipas aneksit 2/1 dhe 2/2, ndër të tjera, evidentohen të jenë mosdeklarues për periudhat përkatëse, duke shmangur në këtë mënyrë deklarimin, kur potencialisht nuk kanë fonde për pagesë. *Shmangia sistematike e deklarimit duke u shoqëruar me gjoba në vlerë të ulët për mosdeklarim, sjell riskun e vijueshmërisë së kësaj praktike, pasi edhe nga testimi janë evidentuar raste të përsëritura për subjekte të caktuara. Përveç nënvlerësimit të vlerës së borxhit, kjo sjell një boshllëk administrativ që ul efektivitetin e sistemit të mbledhjes së të ardhurave.*

Nga auditimi i databazave që dërgoheshin nga IT/DPT për t'u përpunuar nga DMDTP, Sektori i Monitorimit, Analizës për Masat Shtrënguese këto subjekte nuk gjeneroheshin për shkak të mungesës së vetëdeklarimit dhe mungesës së bashkëpunimit mes drejtorive, për të identifikuar subjektet mosdeklarues. Mosdeklarimi i detyrimeve në kohë nga tatimpaguesit, si dhe mos vlerësimi i tyre nga Sektori i Kontrollit nga Zyra ka bërë të mundur;

- Mospasqyrimin e saktë të detyrimeve të papaguara në fund të viti, duke nënvlerësuar treguesit financiarë të raportuar.

-Mungesën e transparencës/saktësisë dhe besueshmërie në evidencat e raportimit të detyrimeve tatimore, e cila mund të ndikojë në procesin e vendimmarrjes për aplikimin e masave ligjore.

5. Mbi vlerësimin e masave shtrënguese të marra për mbledhjen e detyrimeve tatimore të papaguara.

Akt-Marrëveshjet me Këste në Rajonin Jugor

Nga auditimi i të dhënave të administruara nga DMBP për Rajonin Jugor, rezultoi se deri në fund të vitit 2024 janë në fuqi gjithsej 50 aktmarrëveshje aktive, të lidhura ndërmjet tatimpaguesve dhe Drejtorive Rajonale Tatimore të këtij rajoni, me një vlerë të përgjithshme prej 210,741,653 lekë.

Referuar regjistri të vënë në dispozicion grupit të auditimit u konstatua se:

Përmbajtja dhe hartimi i këtij regjistri nuk kishte elemente për të arritur në një konkluzion për ecurinë e këtyre akt-marrëveshjeve në përputhje me kërkesat ligjore.

Formati i regjistrit nuk është i miratuar as nga Drejtori i Drejtorisë së Mbledhjes së Detyrimeve Tatimore të Papaguara dhe as një format të miratuar dhe dërguar nga DPT, si rrjedhojë ky format është mbajtur sipas gjykimit të inspektorëve. Një ndër elemente shumë të rëndësishëm për të gjykuar për ecurinë e akt marrëveshjeve ishte dhe fakti nëse subjekti gjatë kësaj periudhe ka krijuar apo jo detyrime të reja.

Grupi i auditimit analizoi aktmarrëveshjet e lidhura në muajin Nëntor dhe Dhjetor 2024, të cilat pasqyrohen në Aneksin nr. 2/3 bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Nga të dhënat e vëna në dispozicion, u konstatua se në muajin Nëntor dhe Dhjetor janë lidhur gjithsej 15 akt-marrëveshje, me një vlerë totale prej 57,348 mijë lekë.

Nga auditimi i dokumentacionit rezultoi se nga 15 marrëveshje aktive, vetëm 10 marrëveshje janë të ngarkuara në sistemin c@ts, ndërkohë që 5 marrëveshje rezultuan të pa pasqyruara në sistem, duke sjellë një mungesë dokumentacionit të plotë elektronik mbështetës.

Më konkretisht, situata paraqitet si vijon:

- DRT Berat ka lidhur 2 aktmarrëveshje, nga të cilat 1 është ngarkuar në sistem, ndërsa 1 mungon.
- DRT Sarandë ka lidhur 2 marrëveshje, të dyja nuk janë të ngarkuara në sistemin c@ts.
- DRT Vlorë ka lidhur 6 marrëveshje, nga të cilat 4 janë të pasqyruara, ndërsa 2 mungojnë.

- DRT Fier ka lidhur 5 marrëveshje, të gjitha të ngarkuara në sistem.

Nga auditimi i akt marrëveshjeve të mësipërme, u konstatua se, *në momentin e lidhjes së tyre janë përfshirë detyrimet tatimore në kohë reale, të cilat përfshijnë jo vetëm detyrimin principal, por edhe gjobat dhe interesat e regjistruara, si dhe gjobat dhe interesat e paregjistruara.*

Ndërsa, nga auditimi i raportimit të detyrimit për secilin debitor, u konstatua se raportimi zyrtar i detyrimit të papaguar përfshin vetëm gjobat dhe interesat e regjistruara në sistemin tatimor. Kjo sjell një mospërputhje me realitetin financiar të marrëveshjeve, pasi në urdhrat e pagesës që shoqërojnë këto marrëveshje përfshihet dhe paguhet shuma totale, përfshirë edhe interesat dhe gjobat e paregjistruara.

Kjo mospërputhje mes raportimit dhe përmbajtjes reale të marrëveshjeve krijon mos pasqyrim të saktë të detyrimeve të papaguara, si dhe risk për nënvlerësim të stokut të borxhit në raportimet zyrtare.

Nga analiza e të dhënave mbi interesat e paregjistruara në secilën nga akt-marrëveshjet përkatëse, referuar Aneksit nr.2/3.1 bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit, ku janë paraqitur zërat për secilin debitor, u konstatua, se në një rast është evidentuar vetëm detyrimi për lidhjen e akt-marrëveshjes, jo i detajuar sipas detyrimit, gjobës dhe interesit, ndërsa në 2 (dy) raste nuk është ndarë gjoba/interesi në të regjistruar/ paregjistruar.

- Nga analiza e debitorëve dhe detyrimeve të subjekteve që kanë lidhur akt-marrëveshje për pagesë me këste dhe janë aktive gjatë vitit 2024, u konstatua se, për këto debitorë gjobat dhe interesat janë në 2 (dy) zëra të ndryshëm, përkatësisht gjoba të regjistruara, gjoba të paregjistruara si dhe interesa të regjistruar, interesa të paregjistruara në sistemin tatimor. Në total, për 12 tatimpaguesit e analizuar, vlera e gjobave të paregjistruara arrin në 3,442 mijë lekë, ndërsa interesat e paregjistruara në shumën prej 1,852 mijë lekë. Totali prej 5,295 mijë lekë, ndonëse janë përfshirë në akt marrëveshjet e lidhura ndërmjet palëve, nuk rezultojnë të pasqyruara **si detyrim në evidencat zyrtare të raportuara për borxhin tatimor.**

- Totali i gjobave dhe interesave që rezultojnë për subjektet debitorë është 10,092 mijë lekë, prej të cilave 5,295 mijë lekë janë gjoba dhe interesa të paregjistruara, ndërsa 4,797 mijë lekë janë të regjistruara në sistem, pra 52.46% e vlerës totale nuk pasqyrohet në evidencat zyrtare, ndonëse është përfshirë në akt-marrëveshjet për këste dhe është pjesë e detyrimit të arkëtueshëm.

Si rrjedhojë, **evidencat zyrtare nuk paraqesin një pamje të plotë dhe reale të detyrimit të mbetur dhe të arkëttimeve të realizuara për çdo muaj.**

Veprimet e mësipërme janë kryer në kundërshtim me *Manualin e Mbledhjes së Borxhit, Pika 3.2.1 – Dokumentimi i masave të ndërmarra: “Për çdo veprim të ndërmarrë nga strukturat e borxhit në drejtim të ndjekjes së detyrimit tatimor të papaguar duhet të mbahet dokumentacion përkatës në dosje, si në format fizik ashtu edhe elektronik. Çdo vendimmarrje administrative apo masë shtrënguese duhet të jetë e dokumentuar dhe e aksesueshme në sistemin elektronik; Pika 3.2.3 – Raportimi dhe analiza e masave, “Drejtoria Rajonale dhe strukturat përkatëse të DMDTP janë të detyruara të përgatisin raporte analitike dhe përmbledhëse periodike (muajore, tremujore, vjetore) mbi veprimtarinë e tyre, numrin e masave të ndërmarra, rezultatet në vlerë dhe në përqindje, si dhe analizën e performancës në lidhje me borxhin tatimor”.*

Masat shtrënguese dhe efektiviteti i tyre për vitin 2024

Nga auditimi i zbatimit të masave shtrënguese për mbledhjen e detyrimeve tatimore të papaguara gjatë vitit 2024 në Rajonin Jugor, rezultoi se janë ndërmarrë gjithsej 26,514 masa shtrënguese, me një vlerë totale prej 25,728,189 mijë lekë. Megjithatë, nga këto masa, vetëm 1,925 raste janë arkëtuar, në shumën 655,785 mijë lekë, që përfaqëson vetëm 2.5% të shumës së vendosur si masë shtrënguese. Ndërkohë, janë liruar 2,536 masa, me një vlerë të përgjithshme prej 920,566 mijë lekë, ose 3.6% të totalit të vendosur.

Më hollësisht pasqyruar në Aneksin nr. 2/4 “Masat shtrënguese të ndërmarra përgjatë vitit 2024 nga Rajoni Jugor” bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Në analizë masat shtrënguese sipas llojit :

- Njoftimi dhe kërkesa për të paguar është masa më e përdorur me 6,934 raste të vendosura në vlerën 5,663,073 mijë lekë, por nuk rezultoi të ketë masa të arkëtuara apo të liruar sipas këtij lloji.
- Urdhri për bllokimin e llogarive bankare përbën një ndër mjetet më të përdorura të forcës shtrënguese, me 5,859 raste të vendosura në shumën 5,193,658 mijë lekë. Nga këto, janë arkëtuar 1,925 raste në shumën 655,785 mijë lekë dhe janë liruar 1,972 raste në vlerën 703,594 mijë lekë. Kjo tregon për një përqindje të lartë të lirimeve në raport me masat e vendosura, çka mund të reflektojë dobësi në ndjekjen dhe ekzekutimin e mëtejshëm.
- Urdhrat e ekzekutimit janë vendosur në 467 raste me vlerë 159,111 mijë lekë, por nuk shoqërohen me të dhëna për arkëtime apo lirime.
- Masat që lidhen me barrën hipotekore dhe siguruese, janë zbatuar në mënyrë të njëjtë në tre forma të ndryshme:
 - Njoftimi për tatimpaguesin për vendosjen e barrës: 4,051 raste të vendosura me shumën 4,285,691 mijë lekë.
 - Njoftimi për vendosjen e barrës hipotekore: gjithashtu 4,051 raste me të njëjtën shumë, nga të cilat janë liruar 282 raste në shumën 108,486 mijë lekë.
 - Njoftimi për barrën siguruese: 4,051 raste të vendosura, me të njëjtin nivel lirimi – 282 raste dhe shumë të liruar prej 108,486 mijë lekë.
- Kërkesa për pezullimin e aktivitetit në doganë është zbatuar në 923 raste, me vlerë totale 1,154,524 mijë lekë, por pa të dhëna mbi arkëtimet apo lirimet.
- Njoftimi për masën e sigurimit tatimor në QKB është aplikuar në 178 raste, në shumën 700,750 mijë lekë.

Ndërkohë, masa të tjera si urdhri për sekuestrim, transferimi i detyrimit tatimor te pala e tretë, ose te ortakët, aksionarët dhe administratorët, si dhe konfiskimi i xhiros ditore, nuk janë përdorur gjatë periudhës.

Kjo situatë reflekton një nivel shumë të ulët efektiviteti të masave shtrënguese si instrument për mbledhjen e borxhit tatimor. Pavarësisht përdorimit të gjerë të masës “njoftim dhe kërkesë për të paguar” (6,934 raste me 5.6 miliardë lekë të vendosura), vetëm një përqindje minimale e masave është kthyer në të ardhura të realizuara.

Po ashtu, u konstatua përdorimi i kufizuar i instrumenteve të tjera më efektive, si urdhri i ekzekutimit, sekuestrimi, transfertat te palët e treta apo te ortakët, të cilat në pjesën më të madhe rezultojnë të papërdorura ose me rezultat minimal, duke sjellë mungesë të një strategjie të integruar të ndjekjes së detyrimeve.

Nga auditimi u konstatua një mospërputhje në përdorimin dhe pasqyrimin e masave shtrënguese: në rastin e urdhrave për bllokim të llogarive bankare, janë vendosur 5,859 raste në shumën 5,193,685 mijë lekë, por janë arkëtuar vetëm 1,925 raste në 655,785 mijë lekë, ndërkohë që janë liruar më shumë raste (1,972) sesa janë arkëtuar.

Për më tepër, nga të dhënat e raportuara u konstatua se në raportimet progresive mujore nuk pasqyrohen të gjitha arkëtimet që burojnë nga masat shtrënguese, veçanërisht në rastet kur pagesat kryhen brenda të njëjtit muaj kalendarik. Kjo sjell **nënvlerësim të arkëtimeve reale**, dhe rrjedhimisht, të kontributit të masave shtrënguese në uljen e borxhit tatimor.

Në zbatim të nenit 89 pika 2 të Ligjit Nr.9920, datë 19.05.2008 “Për Proçedurat Tatimore në RSH” i ndryshuar, thuhet;

2. Nëse tatimpaguesi nuk përdor të drejtën e ankimit dhe nuk paguan detyrimin tatimor, administrata tatimore duhet ta mbledhë tatimin, duke përdorur njërën ose disa prej mënyrave, të parashikuara Gjithashtu, në funksion të mbledhjes së detyrimit tatimor të papaguar të tatimpaguesit, administrata tatimore mund të angazhojë strukturat e saj për të verifikuar dhe monitoruar në vend aktivitetin tregtar të tatimpaguesit, me qëllim konfiskimin në fund të çdo dite të një shume jo më pak se 50 për qind të qarkullimit të realizuar, por jo më shumë se detyrimi tatimor, për të cilin ka filluar procedura e mbledhjes me forcë të detyrimeve tatimore, për llogari të detyrimeve tatimore të pashlyera të tatimpaguesit. Paga e shumës së qarkullimit të sekuestruar kalohet në llogarinë bankare të administratës tatimore ditën e nesërme. Tatimpaguesi, për të cilin administrata tatimore ka filluar mbledhjen me forcë të detyrimeve tatimore të papaguara, nuk mund të kryejë transferim të shumave të parave nga llogaria e tij apo të shesë\ të transferojë aktivet ose kapitalet e shoqërisë, me përjashtim të rasteve kur, nëpërmjet shitjes\ transferimit të aktiveve, synohet shlyerja në masën 100 për qind e detyrimit tatimor të papaguar.” Nga auditimi rezultoi se nga sektori i monitorimit, analizës për masat shtrënguese nuk ishin dërguar/përgatitur lista tatimpaguesish të veçantë, të planifikuar për konfiskim të 50% të qarkullimit të realizuar (por jo më shumë se detyrimi), tek sektori i procedurave ligjore të mbledhjes me forcë për zbatim, referuar neneve 35 dhe 36 pikat 7 të rregullores së brendshme miratuar me Urdhër nr.192, datë 12.08.2020, dhe Manualit të Mbledhjes me Forcë.

Bazuar neneve 31 dhe 32 pikat 6 të rregullores së brendshme të Administratës Qendrore të Tatimeve dhe Manualit të Mbledhjes me Forcë në zbatim të programit të auditimit, grupi i auditimit kërkoi sektorit të procedurave ligjore të mbledhjes me forcë evidencë mbi tatimpaguesit të cilët i janë nënshtruar verifikimit dhe monitorimi në vend të aktivitetit tregtar tatimpaguesve me detyrime të papaguara, me qëllim konfiskimin e jo më pak se 50% të qarkullimit të realizuar (por jo më shumë se detyrimi).

Nga DMDTP për vitin 2024 rezultoi se në asnjë rast nuk është kryer procedura e verifikimit dhe monitorimi në vend të aktivitetit tregtar, tatimpaguesve me detyrime të papaguara, me qëllim konfiskimin e jo më pak se 50% të qarkullimit të realizuar (por jo më shumë se detyrimi).

Kjo situatë vë në pah një boshllëk të rëndësishëm në zinxhirin e ndjekjes së ekzekutimit të masave shtrënguese, duke sjellë nevojën për përmirësimin e mekanizmave të ndjekjes, efektivitetit të administratës tatimore dhe rishikimit të procedurave të aplikimit dhe ndjekjes së masave shtrënguese.

Bazuar në manualin e mbledhjes së detyrimeve të papaguara, miratuar me shkresën nr.11912 prot., datë 29.06.2021, pika 3.3.2, përcaktohet: “.....inspektorët e sektorit të monitorimit dhe zbatimit në terren të masave shtrënguese në DMDTP në rajone, duhet të plotësojnë në mënyrë të vazhdueshme regjistrin e masave shtrënguese të marra ndaj tatimpaguesve dhe të ngarkojnë çdo akt administrative në funksion të masave shtrënguese brenda javës të çështjet e menaxhimit të borxhit të hapur për ndjekjen e mbledhjes së detyrimeve. Ndërkohë që strukturat drejtuese kontrollojnë zbatimin e këtyre detyrave.”, pika 4.2.2, përcaktohet: “...gjithashtu përdoruesi i sistemit, ka të drejtë të ngarkoj në këtë folder, çdo dokument (akt administrative), që administron organin tatimor të cilët kanë të bëjnë me çështje të dhe menaxhimin e mbledhjes së borxhit tatimor..”.

Nga rakordimi i të dhënave nga sistemi C@TS me evidencat e raportimit të masa shtrënguese të vëna në dispozicion nga drejtoria janë konstatuar diferenca, çka tregon se jo të gjitha masat shtrënguese janë hapur në sistem duke ndikuar në kontrole joefektive dhe transparente për procedurat e ndjekura në lidhje me punën e bërë për rikuperimin e borxhit, dhe mungesën e gjurmës së operacioneve të detyrimit të papaguar të klasifikuar si borxh.

Grupi i auditimit bazuar në mbajtja e regjistrit të masave ligjore shtrënguese të zbatuara konstatoi:

Sektori përgjegjës dispononte një regjistër të miratuar për pasqyrimin e këtyre masave. Megjithatë, analizimi i dokumentacionit përkatës vërtetoi mangësi të theksuara në përmbajtjen dhe përditësimin e të dhënave të regjistrit, konkretisht:

Në rubrikën "Subjekti" dhe "NIPT" ishin të pasqyruara vetëm një herë për tatimpagues me masa të përsëritura, duke shkaktuar:

- Mospasqyrim të borxheve të reja në periudha të ndryshme;
- Mospërfshirje të masave të përsëritura brenda vitit;
- Mungesë të saktësimit të periudhës së krijimit të borxhit.

Në rubrikën "Periudha e krijimit të borxhit" dhe "Lloji i tatimit" rezultuan të paplotësuara ose të pasakta. Në rubrikën "Shuma e detyrimit" nuk ishte e rifreskuar me të dhënat mujore.

Në rubrikën "Marrëveshje për pagesë me këste" nuk korrespondonte me evidencat e marrëveshjeve të lidhura.

Në rubrikën sistemime rezultoi të mos pasqyrohej asnjë lloj informacioni (e paplotësuar).

Në rubrikën gjendja në fund rezultoi të mos pasqyrohej asnjë lloj informacioni (e paplotësuar).

Në rubrikën "Proces gjyqësor", "Arkëtime", "Sistemime", "Gjendja në fund" rezultuan të paplotësuara.

Në rubrikën "Çbllokim bankar" përmbante të dhëna që nuk përputheshin me evidencat e raportuara.

Mosplotësimi i saktë dhe i vazhdueshëm i rubrikave përkatëse në regjistrin e masave ligjore shtrënguese të aplikuara ndaj secilit tatimpagues ndikon në mospërputhje midis evidencave të mbajtura nga drejtorja dhe raporteve periodike të DMDTP, duke ndikuar në cilësinë e raportimeve dhe në mos dokumentimin e gjurmës së auditimit.

2.1.3. Drejtorja e Mbledhjes së Detyrimeve Tatimore të Papaguara në Rajonin Verior

Struktura e DMDP, Rajoni Verior rezultoi një drejtori e krijuar mbi bazën ligjore, e cila ka qendrën në Shkodër dhe ushtronte funksionin e saj në juridiksionin territorial të Drejtorive Rajonale Tatimore Shkodër, Lezhë, Kukës, Dibër.

Drejtorja funksionon e përbërë nga 3 (tre) sektorë:

1. Sektori i Monitorimit, Analizës për Masat Shtrënguese,
2. Sektori i Zbatimit në Terren të Masave Shtrënguese,
3. Sektori i Procedurave Ligjore të Mbledhjes me Forcë.

Struktura për periudhën e vitit 2024, DMDTP Rajoni Jugor krahasuar me strukturën e miratuar në Drejtorinë e Përgjithshme Tatimore, paraqitet si mëposhtë:

Rajoni Verior (1+3+10)	Plan sipas urdhrit KM nr. 69, dt. 26.05.2023	Pas implement. të strukturës dt.01.02.2024	Fakt 31.12.2024	Diferenca Plan /Fakt
Drejtor Drejtorie	1	1	1	-
Sektori i Monitorimit, Analizës për masat shtrënguese				
- Përgjegjës Sektori	1	1	1	-
- Inspektorë	5	5	5	-
Sektori i Zbatimit në Terren të Masave Shtrënguese				
- Përgjegjës Sektori	1	1	1	-
- Inspektorë	3	3	3	-
Sektori i Procedurave Ligjore të mbledhjes me forcë				
- Përgjegjës Sektori	1	0	1	1
- Inspektorë	2	2	2	-
	14	13	13	1

Burimi: Drejtorja e Burimeve Njerëzore në DPT, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

Sa më sipër, u konstatua se struktura e DMDTP Rajoni Verior është miratuar me 14 punonjës (1 drejtor drejtorie, 3 përgjegjës sektori dhe 10 inspektorë). Më datë 01.02.2024 rezultojnë 13 punonjës në total, po ashtu dhe në fund të vitit 2024, me një diferencë nga plani i miratuar me 1 punonjës.

1. Vlerësimi i nivelit të borxhit tatimor, ecuria e detyrimeve të papaguara për periudhën objekt auditimi, Rajoni Verior

Referuar të dhënave nga DMDTP Rajoni Verior, gjendja e detyrimeve në fillim, shtesat dhe pakësimet gjatë vitit, si dhe gjendja në fund, ndarë në numër rastesh dhe vlerë, paraqiten si më poshtë:

000/lekë

DRT	Gjendja e detyrimeve në fillim të vitit		Detyrime të shtuara				Detyrime pakësuar						Vlera gjithsej e detyrimeve në fund të muajit	
			Detyrime të shtuara		Subjekte të Transferuar		Arkëtuar Gjithsej		Subjekte të Transferuar		Kthyer për Sistemim			
			nr.	shuma	nr.	Shuma	nr.	shuma	nr.	shuma	nr.	shuma		
Dibër	10,267	3,462,795	11,561	887,464	9	6,717	11,033	865,881	5	1,630	1	2,297	10,798	3,487,168
Kukës	5,247	9,973,599	7,926	755,075	7	28,740	7,320	558,319	9	7,894	2	21,681	5,849	10,169,520
Lezhë	3,432	2,354,476	3,223	729,185	8	7,439	3,069	642,116	3	133	-	-	3,591	2,448,851
Shkodër	1,829	797,973	1,851	265,631	6	3,186	1,736	193,071	1	24	-	-	1,949	873,695
Totali	20,775	16,588,843	24,561	2,637,355	30	46,082	23,158	2,259,387	18	9,681	3	23,978	22,187	16,979,234


Burimi: DMDTP Rajoni Verior

2. Analizimi i detyrimeve tatimore sipas statusit të tatimpaguesit.

Në fund të vitit 2024, numri i përgjithshëm i tatimpaguesve me borxh rezultoi të jetë 22,187 raste, duke përfshirë si subjekte aktive, ashtu edhe ato pasive, në vlerë totale 16,979,234 mijë lekë. Nga analiza e të dhënave vërehet se pesha më e madhe e borxhit tatimor rrjedh nga tatimpaguesit pasivë, të cilët përbëjnë 13,353 raste dhe kanë një vlerë të detyrimeve të papaguara në shumën prej 13,221,688 mijë lekë.

Në Rajonin Verior rezultojnë 8,834 raste aktivë, me një borxh të akumuluar në shumën prej 3,757,546 mijë lekë.

Detyrimi i papaguar sipas Drejtorive Rajonale Tatimore të cilat përfshihen në raportimin e borxhit në Drejtorinë e Mbledhjes së Detyrimeve Tatimore të Papaguara në Rajonin Verior paraqitet si më poshtë:



Burimi: Të dhënat nga DMDTP në Rajonin Verior. Përpunuar nga grupi i auditimit, KLSH.

3. Analizimi i detyrimeve tatimore të ndara sipas pronësisë.

Borxhi tatimor i akumuluar në vitin 2024 ka një shpërndarje midis bizneseve të mëdha, biznese të vogla dhe ndërmarrjeve shtetërore/enteve buxhetore. Këto shifra janë një tregues i rëndësishëm i disiplinës fiskale të subjekteve ekonomike dhe efektivitetit të administratës tatimore në arkëtimin e të ardhurave të buxhetit të shtetit.

- Bizneset e mëdha përbëjnë pjesën më të madhe të borxhit tatimor të regjistruar deri më 31 dhjetor 2024, me një vlerë prej 14,921,545 mijë lekë ose 88% të detyrimit.

Peshën kryesore në borxh, sipas llojit të pronësisë, e zë borxhi privat në masën 97% të totalit.

000/lekë

Rajoni	Buxhetor		Privat	
	Nr. subj.	Vlerë borxhi	Nr. subj.	Vlerë borxhi

Verior	252	572,350	21,935	16,406,884
--------	-----	---------	--------	------------

Burimi: Të dhënat nga DMDTP në Rajonin Verior. Përpunuar nga grupi i auditimit, KLSH.

4. Analizimi i detyrimeve sipas llojit të tatimit, i ndarë në principal/gjobë/interesa dhe ecuria e tyre cdo muaj

Nga të dhënat e vëna në dispozicion dhe të analizuara rezultoi se detyrimet e papaguara mbeten të përqendruara kryesisht tek Tatimi mbi Fitimin dhe TVSH, ndërsa tatime të tjera, si sigurimet shoqërore dhe tatimi në burim, kanë një ndikim më të moderuar në stokun total të borxhit.

4.1. Tatimi mbi Fitimin

Në fillim të vitit 2024, borxhi i regjistruar për Tatimin mbi Fitimin ishte në shumën prej 4,752,632 mijë lekë, duke pësuar ndryshime gjatë vitit si më poshtë vijon:

-Në fund të muajit janar, detyrimi u pakësua me shumën 4,751 mijë lekë, si rezultat i arkëtimit të detyrimeve nga tatimpaguesit për fitimet e realizuara në periudhën e mëparshme.

-Përgjatë muajit shkurt, detyrimi u pakësua me 8,189 mijë lekë.

-Përgjatë muajit mars detyrimi mbi Tatim Fitimin u rrit me 3,062 mijë lekë.

-Përgjatë muajit prill detyrimi u rrit me 242,542 mijë lekë.

-Përgjatë muajit maj detyrimi u pakësua me 31,591 mijë lekë.

-Përgjatë muajit qershor detyrimi u pakësua me 21,484 mijë lekë.

-Përgjatë muajit korrik detyrimi u rrit me 447 mijë lekë.

-Përgjatë muajit gusht detyrimi u rrit me 22,489 mijë lekë.

-Përgjatë muajit shtator detyrimi u pakësua me 20,787 mijë lekë.

-Përgjatë muajit tetor detyrimi u pakësua me 12,329 mijë lekë.

-Përgjatë muajit nëntor u pakësua me 3,826 mijë lekë.

-Përgjatë muajit dhjetor detyrimi u pakësua me 3,878 mijë lekë, ku krahasuar me çeljen e vitit ka pësuar një rritje në shumën prej 161,705 mijë lekë.

Gjithashtu, vlera e këtij detyrimi në datë 31.12.2024 është përkatësisht principal në shumën prej 3,563,835 mijë lekë, gjoba në shumën prej 1,123,256 mijë lekë dhe interesa në shumën prej 227,246 mijë lekë.

4.2. Tatimi mbi Vlerën e Shtuar (TVSH)

TVSH-ja është një nga tatimet me ndikimin më të madh në detyrimet totale.

Në fillim të vitit 2024, borxhi i regjistruar për TVSH-në ishte në shumën prej 7,345,780 mijë lekë, duke pësuar ndryshime gjatë vitit si më poshtë vijon:

-Në fund të muajit janar, detyrimi u rrit me shumën 14,937 mijë lekë, krahasuar me çeljen e vitit 2024.

-Përgjatë muajit shkurt, detyrimi u pakësua me 42,519 mijë lekë.

-Përgjatë muajit mars detyrimi u rrit me 15,660 mijë lekë.

-Përgjatë muajit prill detyrimi u rrit me 19,091 mijë lekë.

-Përgjatë muajit maj detyrimi u rrit me 7,710 mijë lekë.

-Përgjatë muajit qershor detyrimi u rrit me 11,734 mijë lekë.

-Përgjatë muajit korrik detyrimi u rrit me 22,750 mijë lekë.

-Përgjatë muajit gusht detyrimi u rrit me 13,632 mijë lekë.

-Përgjatë muajit shtator detyrimi u rrit me 4,502 mijë lekë.

-Përgjatë muajit tetor detyrimi u rrit me 5,870 mijë lekë.

-Përgjatë muajit nëntor u rrit me 4,190 mijë lekë.

-Përgjatë muajit dhjetor detyrimi u rrit me 13,234 mijë lekë, ku krahasuar me çeljen e vitit ka pësuar një rritje në shumën prej 90,791 mijë lekë.

Gjithashtu, vlera e këtij detyrimi në datë 31.12.2024 është përkatësisht principal në shumën prej 4,485,248 mijë lekë, gjoba në shumën prej 2,181,750 mijë lekë dhe interesa në shumën prej 769,573 mijë lekë.

4.3. Sigurimet Shoqërore

Në fillim të vitit 2024, borxhi i regjistruar për Sigurimet Shoqërore ishte në shumën prej 2,624,858 mijë lekë, duke pësuar ndryshime gjatë vitit si më poshtë vijon:

- Në fund të muajit janar, detyrimi u rrit me shumën 13,464 mijë lekë, krahasuar me çeljen e vitit 2024.
- Përgjatë muajit shkurt, detyrimi u pakësua me 19,818 mijë lekë.
- Përgjatë muajit mars detyrimi u pakësua me 8,094 mijë lekë.
- Përgjatë muajit prill detyrimi u rrit me 47,977 mijë lekë.
- Përgjatë muajit maj detyrimi u pakësua me 46,563 mijë lekë.
- Përgjatë muajit qershor detyrimi u rrit me 11,797 mijë lekë.
- Përgjatë muajit korrik detyrimi u rrit me 63,137 mijë lekë.
- Përgjatë muajit gusht detyrimi u pakësua me 17,713 mijë lekë.
- Përgjatë muajit shtator detyrimi u rrit me 1,591 mijë lekë.
- Përgjatë muajit tetor detyrimi u rrit me 41,707 mijë lekë.
- Përgjatë muajit nëntor u rrit me 4,788 mijë lekë.
- Përgjatë muajit dhjetor detyrimi u rrit me 13,296 mijë lekë, ku krahasuar me çeljen e vitit ka pësuar një rritje në shumën prej 105,569 mijë lekë.

Gjithashtu, vlera e këtij detyrimi në datë 31.12.2024 është përkatësisht principal në shumën prej 2,058,322 mijë lekë, gjoba në shumën prej 502,397 mijë lekë dhe interesa në shumën prej 169,708 mijë lekë.

4.4. Tatimi mbi të Ardhurat Personale (TAP)

TAP ka pasur një trend të qëndrueshëm, me ndryshime të vogla krahasuar me tatimet e tjera gjatë vitit 2024. Çelja e vitit 2024 paraqitet me 74,347 mijë lekë dhe ndryshimet kryesore paraqiten si në vijim:

- Në muajin janar detyrimi është rritur me 1,101 mijë lekë, në muajin shkurt me 397 mijë lekë, në muajin gusht me 2 mijë lekë dhe në muajin nëntor me 95 mijë lekë. Muajt e tjerë paraqitet me ulje, ku ulja më e lartë i takon muajit maj me 710 mijë lekë.

Në fund të vitit, borxhi i TAP rezultoi në shumën prej 74,086 mijë lekë, ku krahasuar me çeljen e vitit ka pësuar një ulje në shumën prej 261 mijë lekë. Gjithashtu, vlera e këtij detyrimi në datë 31.12.2024 është përkatësisht principal në shumën prej 31,254 mijë lekë, gjoba në shumën prej 20,00 mijë lekë dhe interesa në shumën prej 22,824 mijë lekë.

4.5. Deklarata Individuale Vjetore e të Ardhurave (DIVA)

Borxhi për DIVA-n ka qenë relativisht i paqëndrueshëm gjatë vitit 2024, duke reflektuar luhajtje në pagesat dhe menaxhimin e detyrimeve.

- Përgjatë muajit janar borxhi ka pësuar rritje progresive në shumën prej 2,577 mijë lekë;
- Përgjatë muajit shkurt borxhi ka pësuar një rënie në shumën prej 701 mijë lekë;
- Në muajin mars borxhi për DIVA-n ka përsëri një trend rritës në shumë prej 1240 mijë lekë;
- Përgjatë muajit prill, borxhi pësoi një rritje në shumën prej 2,062 mijë lekë, ndërsa në muajin maj, borxhi pati rritjen më të madhe të vitit 2024 në shumën prej 12,178 mijë lekë.

Në muajt vijues qershor-shtator borxhi pësoi rënie progresive në shumën prej 10,780 mijë lekë, ndërsa në muajt tetor- nëntor u rrit për shumën 4,138 mijë lekë, ndërsa në muajin dhjetor pësoi një ulje të lehtë në shumën prej 2,825 mijë lekë.

Në fund të vitit, borxhi i DIVA-s rezultoi në shumën prej 692,370 mijë lekë, ku krahasuar me çeljen e vitit ka pësuar një rritje në shumën prej 56,775 mijë lekë.

4.6. Tatimi në Burim

Borxhi për Tatimin në Burim ka qenë relativisht i qëndrueshëm gjatë vitit 2024, duke reflektuar një nivel të moderuar të arkëtimit dhe menaxhimit të detyrimeve.

-Tatimi në Burim ka pësuar rritje dhe rënie të moderuara, në muajin gusht borxhi rezultoi me rritjen më të madhe në krahasim me muajt e tjerë të vitit, përkatësisht në shumën prej 6,382 mijë lekë.

Në fund të vitit, borxhi i Tatimit në Burim rezultoi në shumën prej 2,475,489 mijë lekë, ku krahasuar me çeljen e vitit ka pësuar një rritje në shumën prej 6,086 mijë lekë.

4.7. Tatime të Tjera

Borxhi për Tatime të Tjera ka pasur një trend të ndryshueshëm gjatë vitit 2024, ku nga muaji në muaj ka pësuar ulje e rritje të moderuara, ndërsa vetëm në muajt shkurt ka pësuar rritje në shumën prej 18,594 mijë lekë.


Në fund të vitit, borxhi për Tatime të Tjera rezultoi në shumën prej 18,622,184 mijë lekë, ku krahasuar me çeljen e vitit ka pësuar një rritje në shumën prej 22,736 mijë lekë.

Vlera e detyrimit për “*Tatime Të tjera*” në datë 31.12.2024 është përkatësisht principal në shumën prej 4,069,767 mijë lekë, gjoba në shumën prej 2,418,719 mijë lekë dhe interesa në shumën prej 249,664 mijë lekë. Në këtë klasifikim, nuk është qartësuar vlera për secilin lloj tatimi përbërës.

Analizë e borxhit sipas moshës

Nga auditimi i detyrimeve tatimore të papaguara, rezultoi se borxhi i akumuluar është i shpërndarë në periudha të ndryshme kohore, duke përfshirë detyrime të krijuara në tre muajt e fundit deri te borxhi me më shumë se dhjetë vjet.

Grafiku nr. 3: Detyrimet e borxhit sipas moshës për Rajonin Verior



Burimi: DMDTP Rajoni Verior, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

• *Borxhi deri në 3 muaj* përbën një kategori që vlerësohet si borxh me probabilitet të lartë rikuperimi, duke qenë se detyrimet janë krijuar së fundmi dhe mund të jenë rezultat i mosrespektimit të afateve të pagesave nga tatimpaguesit aktivë.

Kjo kategori paraqitet në shumën prej 339,464 mijë lekë, ku pjesa më e madhe e borxhit është e lidhur me sigurimet shoqërore në shumën 164,186 mijë lekë, e ndjekur me tvsh në shumën 129,704 mijë lekë.

• Në kategorinë *e borxhit nga 3 deri në 6 muaj*, vërehet një ulje e ndjeshme në vlerën e borxhit, duke arritur në shumën prej 241,395 mijë lekë. Struktura e borxhit në këtë kategori përbëhet në pjesën më të

madhe nga detyrimet ndaj sigurimeve shoqërore në shumën prej 92,094 mijë lekë, e ndjekur nga tvsh në shumën 85,972 mijë lekë dhe tatime të tjera në shumën 27,800 mijë lekë.

- Për detyrimet *nga 6 deri në 12 muaj*, evidentohet një rritje e ndjeshme e vlerës së borxhit, e cila arrin në shumën prej 598,783 mijë lekë, ku rritja më e madhe në këtë kategori vërehet në tatimin mbi fitimin, i cili paraqitet në shumën prej 214,346 mijë lekë. Tatimi mbi vlerën e shtuar (tvsh-ja) vijon të jetë komponent i rëndësishëm në shumën prej 163,072 mijë lekë, si dhe sigurimet shoqërore në shumën 158,747 mijë lekë.
- Analiza e detyrimeve *nga 1 deri në 2 vjet* tregon një total borxhi në shumën prej 1,256,435 mijë lekë, duke reflektuar një kategori të ndërmjetme mes borxhit afatshkurtër dhe atij afatgjatë. Tvsh-ja dhe tatimi mbi fitimin mbeten komponentët kryesorë të këtij borxhi, përkatësisht në shumat prej 525,797 mijë lekë dhe 428,449 mijë lekë.
- Për detyrimet *nga 2 deri në 5 vjet*, borxhi i akumuluar është në shumën 5,386,714 mijë lekë, me peshën më të lartë prej 31.7% ndaj totalit të detyrimeve të papaguara, duke përfaqësuar një rritje të ndjeshme krahasuar me kategoritë e mëparshme. Gjatë kësaj periudhe, tvsh-ja ka vlerën më të lartë të detyrimit në shumën prej 2,453,807 mijë lekë, duke vijuar me tatimin mbi fitimin e cila paraqitet në shumën prej 1,988,665 mijë lekë dhe sigurimet shoqërore në shumën prej 682,094 mijë lekë.
- Borxhi *mbi 5 vjet* rezultoi në shumën prej 4,512,818 mijë lekë. Tvsh-ja dhe tatimi mbi fitimin kanë vlerën më të lartë të këtij borxhi, përkatësisht në shumën prej 1,634,935 mijë lekë dhe në shumën prej 1,443,369 mijë lekë, duke reflektuar një bazë të gjerë të tatimpaguesve që nuk kanë përmbushur detyrimet e tyre për një periudhë të gjatë kohe. Kjo kategori përfaqëson një risk të lartë të humbjes fiskale, pasi propabiliteti i arkëtimit të detyrimeve është shumë i ulët, për shkak të kohës së gjatë të mbartjes së detyrimeve dhe gjasave të larta për mbylljen e aktiviteteve të debitorëve.
- Detyrimet *mbi 10 vjet* përbëjnë shumën prej 4,643,628 mijë lekë, duke përfshirë shumën prej 2,443,284 mijë lekë nga tvsh-ja dhe shumën prej 846,999 mijë lekë nga tatimet e tjera. Tatimi mbi fitimin përbëhet nga shuma prej 789,476 mijë lekë dhe sigurimet shoqërore dhe kontributet shëndetësore paraqiten në shumën prej 512,150 mijë lekë.

5. Evidentimi dhe raportimi mujor i detyrimeve për veprime të mëtejshme nga sektorët përkatës.

Metodologjia në raportimin e borxhit

Nga Sektori i Monitorimit dhe Analizës për Masat Shtrënguese në Drejtorinë e Mbledhjes së Detyrimeve të Papaguara Rajoni Verior për hartimin e evidencave mujore dhe raportimin e borxhit, bazuar në raportet e debitorëve bruto të sjella nga DPT, në fillim të çdo muaji kryen këto veprime:

1. Pastrohet databaza nga detyrimet korrente;

Si shembull, në muajin Janar hiqen sigurimet shoqërore për atë muaj, për të cilat biznesi i madh ka afat deklarimi dhe pagese deri më datë 20 shkurt, ndërsa data e maturimit borxh është data e fundit e muajit shkurt. Biznesi i vogël ka deklaratë 3 mujore në sigurime dhe muaji janar, shkurt mars kanë afat deklarimi dhe pagese deri më datë 20 prill, ndërsa datë maturimi borxh datën 30 prill. Për muajt janar, shkurt, mars hiqet edhe Tatim Fitimi për biznesin e madh pasi afati i deklarimit dhe pagesës është 31 mars, ndërsa data e maturimit borxh është 10 prill. Biznesi i vogël ka afat deklarimi deri më datë 10 shkurt dhe datë maturimi borxh 20 shkurt dhe hiqet nga raporti i muajit janar. Për Deklaratën DIVA me afat deri më datë 31 prill e kështu me radhë sipas afateve ligjore filtrohen të gjitha llojet e tatimit si tatimi në burim dhe renta kanë datë deklarimi datën 14 të muajit pasardhës dhe datë maturimi borxh datë 24.

1. Eliminohen kontrollet tatimore të pamaturuara borxh bazuar në evidencat mujore të kontrollit të sjella nga DRT Rajonale;
2. Evidentohen transferimet/largimet e debitorëve nga Rajoni Verior në Rajonet e tjera dhe shumat përkatëse të detyrimit;

3. Evidentohen transferimet/ardhjet e debitorëve nga Rajonet e tjera në Rajonin Verior dhe shumat përkatëse të detyrimit;
4. Evidentohen detyrimet me marrëveshje pagesë me këste;
5. Evidentohen detyrimet në proces gjyqësor.

U konstatua se:

Afatet e maturimit borxh të kontrollit tatimor janë 40 ditë nga data e njoftim vlerësimit, por ekziston risku i raportimit të saktë për të gjitha rastet, duke qenë se Sektori i Borxhit në DRT i referohet listës që sjell çdo muaj Drejtoria e Kontrollit nga secila DRT. Këto lista nuk rezultojnë të plota duke qenë se ka sistemime të vijueshme nga Sektori i Kontrollit nga Zyra. Gjithashtu, gjobat dhe interesat nuk janë të përfshira në këtë raportim.

E njëjta situatë ndodh edhe me proceset gjyqësore pasi nuk arrijnë të saktësohen periudhat për të cilat gjyqet janë në proces, duke evidentuar riskun e parimit FIFO për mbulimin e detyrimeve. Ndërkohë, detyrimet mund të vijnë të gjenerojnë interesa.

Referuar testeve të kryera për llojin e detyrimit “Tatim fitimi” u konstatua se nga lista e debitorëve të raportuar me datën 31.12.2024 nuk përlllogariten gjobat/interesat e lindura për mosdeklarimet e detyrimeve të periudhës koherente. Nga testimet e realizuara nga grupi i auditimit u konstatua se për llojin e tatimit “Tatim fitimi”, ku subjekti bën vetëdeklarimin, por pagesa kryhet në vitin pasardhës, nga DMDTP e Rajonit Verior, **nuk është pasqyruar në listën e detyrimeve me datë 31.12.2024 një shumë prej 1,116,121 lekë.** Kjo shumë i përket gjobave të aplikuara për mosdeklarimin e deklaratave tatimore të tipit 24-A dhe nuk është evidentuar si detyrim në pasqyrat përkatëse.

Nisur nga kjo situatë grupi i auditimit me qëllim vlerësimin e saktësisë së raportimit të borxhit në datën 31.12.2024, ka kryer verifikime mbi databazën e debitorëve (në proces).

Për subjekte mosdeklarues të cilët duhet të rezultojnë si debitorë më 31.12.2024

Referuar raportit të dërguar nga DMDTP mbi debitorët e datës 31.12.2024, grupi i auditimit ka testuar saktësinë e raportimit, duke krahasuar listën analitike të përcjellë me pagesat e kryera në muajin Janar 2025. Më specifikisht, testimi është kryer për detyrimin mbi TVSH dhe kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, ku janë evidentuar subjekte mosdeklarues të këtyre tatimeve të cilët duhet të ishin klasifikuar si debitorë në muajin Dhjetor 2024.

Nga auditimi u konstatuan **62 raste në vlerë totale 2,354,820 lekë**, si detyrime të paguara për TVSH në muajin Janar 2025 për efekt TVSH muaji Nëntor 2024 dhe më herët, të cilët nuk janë pjesë e debitorëve më 31.12.2024. Rezultoi se vetëm për vitin 2024, kjo vlerë është 1,689,094 lekë. Lista e debitorëve pasqyrohet në Aneksin nr. 3/1 bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

E njëjta situatë evidentohet edhe për detyrimin mbi kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, ku janë testuar bizneset me përjashtim të Biznesit të Vogël me TVSH dhe atij pa TVSH të cilët kanë afat deklarimi dhe pagese 3 muaj. Nga testimi janë konstatuar **180 raste të cilët kanë paguar detyrimin prej 8,608,952 lekë** në muajin Janar 2025 për efekt periudhe Nëntor 2024 dhe më herët dhe nuk janë njohur si debitorë më 31.12.2024. Vlëra vetëm për vitin 2024 është 8,118,045 lekë. Lista e debitorëve pasqyrohet në Aneksin nr. 3/2 bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Subjektet e konstatuara, ndër të tjera, evidentohen të jenë mosdeklarues për periudhat përkatëse, duke shmangur në këtë mënyrë deklarimin kur potencialisht nuk kanë fonde për pagesë. Shmangia sistematike e deklarimit duke u shoqëruar me gjoba në vlerë të ulët për mosdeklarim, sjell riskun e vijueshmërisë së kësaj praktike, pasi edhe nga tabelat e mësipërme evidentohen raste të përsëritura për subjekte të caktuara. Përveç nënvlerësimit të vlerës së borxhit, kjo sjell një boshllëk administrativ, që ul efektivitetin e sistemit të mbledhjes së të ardhurave.

6. Vlerësimi i masave shtrënguese të marra për mbledhjen e detyrimeve tatimore të papaguara.

Akt-Marrëveshjet me Këste

Nga regjistri i akt-marrëveshjeve të Rajonit Verior dhe rakordimi me raportimet e kryera në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve për vitin 2024 rezultoi se përgjatë muajve Janar – Dhjetor 2024 janë lidhur dhe janë anuluar Akt-Marrëveshje si më poshtë:

Muaji	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qeshor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nentor	Dhjetor
Aktive	47	53	58	52	56	67	77	80	79	77	71	51
Anulluar	10	6	1	11	4	2	0	2	2	8	6	16

Burimi: DMDTP në Rajonin Verior.

Në rastet kur, Tatimpaguesi paraqet pranë DRT-së së juridiksionit, një kërkesë me shkrim, për të hyrë në një marrëveshje pagese me këste për detyrimet e papaguara, afatet dhe procedurat që ndiqen janë ato të parashikuara në nenin 77 dhe 78, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar. Kërkesa duhet të trajtohet brenda 10 ditëve kalendarike nga data e paraqitjes.

Trajtimi i kërkesës bëhet nga Inspektori i kontrollit nga zyra që ka në ndjekje tatimpaguesin i cili analizon kërkesën, verifikon situatën e tatimpaguesit lidhur me gjendjen kreditore dhe debitorë, kryen kompensimin e detyrimeve nëse është e nevojshme dhe verifikon statusin e masave shtrënguese, kryesisht nëse kanë filluar procedurat e shitjes në ankand të pasurive të konfiskuara për efekt të detyrimit tatimor të pashlyer. DMDTP mban regjistrin analitik të aktmarrëveshjeve të pagesës me këste, mbi bazën e të dhënave të dërguara nga Rajonet.

Nga auditimi u konstatua se, për periudhën 01.01.2024-31.12.2024 në regjistrin e akt-marrëveshjeve nuk janë mbajtur evidenca për detyrimin total të subjekteve përpara lidhjes së akt-marrëveshje me qëllim raportimin e saktë të detyrimit para lidhjes së akt-marrëveshjeve. Në mungesë të paraqitjes së detyrimit real, grupi i auditimit nuk mund të testojë nëpërmjet databazës nëse vlera e raportuar e pagesës rezultoi sa 20% e detyrimit total.

Nga auditimi me zgjedhje i akt-marrëveshjeve për periudhën u konstatua se detyrimi i subjekteve paraqitet në akt-marrëveshje si vlerë dhe e detajuar sipas zërave, por nuk është i shoqëruar me dokumentacion bashkëlidhur, që të vërtetojë detyrimin në kohë reale nga sistemi C@ts. **Për sa më sipër, u konstatua se akt-marrëveshja është përdorur si një mënyrë për të mos kaluar në masa të tjera shtrënguese nga ana e Drejtorisë së Mbledhjes së Detyrimeve të Papaguara. Nga ana e Drejtorisë së Mbledhjes së Detyrimeve të Prapambetura masat e marra janë me urdhër bllokim të llogarive bankare. Nuk konstatohen masa shtrënguese të plota.**

Referuar verifikimit të akt-marrëveshjeve të lidhura në muajin Nëntor-Dhjetor 2024, rezultoi se janë lidhur 8 akt-marrëveshje, të cilat janë hedhur në sistemin C@ts:

- 4 akt-marrëveshje nga DRT Lezhë;
- 3 akt-marrëveshje nga DRT Shkodër;
- 1 akt-marrëveshje nga DRT Dibër.

Në 3 raste është evidentuar vetëm detyrimi për lidhjen e akt-marrëveshjes, jo i detajuar sipas detyrimit, gjobës dhe interesit, ndërsa në 1 rast nuk është ndarë gjoba/interesi në të regjistruar/ paregjistruar.

Në total, për këto **8 raste evidentohen gjoba të paregjistruara në vlerën 553,889 lekë dhe interesa të paregjistruar në vlerën 204,980 lekë**, duke sjellë nënvlerësim të vlerës së raportuar të borxhit. Lista Akt-marrëveshje të lidhura në muajt Nëntor-Dhjetor pasqyrohet në Aneksin nr. 3/3 bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Veprimet e mësipërme janë kryer në kundërshtim me *Manualin e Mbledhjes së Borxhit*, **Pika 3.2.1 – Dokumentimi i masave të ndërmarrë**: “Për çdo veprim të ndërmarrë nga strukturat e borxhit në drejtim të ndjekjes së detyrimit tatimor të papaguar duhet të mbahet dokumentacion përkatës në dosje, si në format fizik ashtu edhe elektronik. Çdo vendimmarrje administrative apo masë shtrënguese duhet të jetë e dokumentuar dhe e aksesueshme në sistemin elektronik; **Pika 3.2.3 – Raportimi dhe analiza e masave**, “Drejtoria Rajonale dhe strukturat përkatëse të DMDTP janë të detyruara të përgatisin raporte analitike dhe përmbledhëse periodike (muajore, tremujore, vjetore) mbi veprimtarinë e tyre, numrin e masave të ndërmarrë, rezultatet në vlerë dhe në përqindje, si dhe analizën e performancës në lidhje me borxhin tatimor.”

Masat shtrënguese përgjatë vitit 2024

Nga të dhënat e vendosura në dispozicion, grupi i auditimit ka analizuar dhe paraqitur në mënyrë përmbledhëse, llojet e masave shtrënguese të ndërmarrë përgjatë vitit 2024 nga Rajoni Verior, si në Aneksin nr. 3/4 bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Nga të dhënat e pasqyruara në Aneksin nr. 3/4, evidentohet se nga DMDTP në Rajonin Verior janë paraqitur si masa shtrënguese edhe kërkesat për informacion drejtuar RBS dhe ASHK, konkretisht 9,602 raste, të cilat nuk konsiderohen si masa shtrënguese referuar kuadrin ligjor në fuqi, duke rritur në këtë mënyrë artificialisht numrin e masave shtrënguese të ndërmarrë. Gjithashtu, nuk evidentohet në mënyrë të qartë nëse numri i rasteve në tabelën e mësipërme për njoftimet përlllogaritë për secilin debitor si rast unik apo si njoftim i përsëritur.

Nga rakordimi i të dhënave nga sistemi C@TS me evidencat e raportimit të masave shtrënguese të vëna në dispozicion nga DMDTP Rajoni Verior janë konstatuar diferenca, çka tregon se jo të gjitha masat shtrënguese janë hapur në sistem duke ndikuar në kontrollë joefektive dhe transparente për procedurat e ndjekura në lidhje me punën e bërë për rikuperimin e borxhit, dhe mungesën e gjurmës së operacioneve të detyrimit të papaguar të klasifikuar si borxh.

Referuar Aneksit 3/5 bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit, sa i takon “Efektivitetit të masave shtrënguese” përqindja e arkëtimit kundrejt masave shtrënguese rezultoi në një nivel pothuajse të papërfillshëm krahasuar me detyrimin dhe vlerën e vendosur në masë. Për më tepër, rezultoi se nuk janë ezauruar masat si në vijim:

- *Urdhër sekuestrimi*
- *Njoftim transferimi detyrimi tatimor palës së tretë*
- *Njoftim dhe kërkesë për të paguar nga palët e treta në zbatim të nenit 98*
- *Njoftim për transferimin e detyrimit Ortakut, Aksionerit, Administratorit*
- *Konfiskim 50% të xhiros ditore*

Nga sa më sipër konkludohet se, mungesa e efektivitetit të masave shtrënguese të ndërmarrë për arkëtimin e borxhit të tatimpaguesve si dhe moszbatimi i tyre në mënyrë shteruese ka shkaktuar që stoku i borxhit të vijojë me rritje.

DMDTP, Rajoni Verior bazuar në nenin 88 e në vijim të Ligjit nr 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe udhëzimit Nr 24, datë 02.09.2008 në zbatim të tij si autoritet kompetent për mbledhjen e detyrimeve tatimore të papaguara kur konstaton se një tatimpagues nuk ka paguar plotësisht dhe në datën e caktuar detyrimet tatimore, ajo i dërgon atij, me postë rekomandë ose në rrugë elektronike, një njoftim me shkrim, ku kërkon pagesën e plotë të detyrimit tatimor. Nëse tatimpaguesi nuk përdor të drejtën e ankimit dhe nuk paguan detyrimin tatimor, administrata tatimore duhet ta mbledhë tatimin, duke përdorur njërën ose disa prej mënyrave, të parashikuara në këtë kre.

Masat e parashikuara me të cilat DMDTP duhet të mbledhë detyrimin tatimor sipas këtij kreu janë:

1. Verifikimi dhe monitorimi në vend i aktivitetit tregtar të tatimpaguesit, me qëllim konfiskimin në fund të çdo dite të një shume jo më pak se 50 për qind të qarkullimit të realizuar, por jo më shumë se detyrimi tatimor
2. Urdhri i bllokimit të llogarive bankare të tatimpaguesit
3. Urdhër ekzekutimi
4. Masë sigurimi në QKB
5. Masa e sigurimit (Barrë siguruese/hipotekore) të detyrimit tatimor
6. Kërkesë për pezullim të aktivitetit në Doganë
7. Sekuestrimi dhe konfiskimi i pasurisë
8. Shitja e pasurisë së konfiskuar
9. Transferimi i detyrimit tatimor palës së tretë
10. E drejta për të kërkuar detyrimet nga pala e treta
11. Përgjegjësia e ortakut, aksionarit dhe administratorit
12. Deklarimin e detyrimit tatimor si të pambledhshëm
13. Falimenti

Këto masa ndërmerren në mënyre kronologjike ose njëkohësisht me procedurat e tjera të përcaktuara në këtë kre.

Problematikat kryesore në lidhje me masat shtrënguese paraqiten si në vijim:

5. Masa e sigurimit (Barrë siguruese/hipotekore) të detyrimit tatimor

Aktualisht DMDTP, Rajoni Verior merr masat shtrënguese deri në procedurën e vendosjes së masës së sigurimit barrë siguruese.

Gjatë viteve 2020-2023 nga përfaqësuesit e këtij rajoni argumentohet se ka patur mungesë të fondeve për vendosjen e “masave të sigurimit (Barrë siguruese/hipotekore) procedura të cilat me ndryshimet ligjore kaluan me tarifim sipas shërbimeve përkatëse. Edhe pse gjatë vitit 2024 e në vijim u parashikua fond i veçante për këto shërbime problematikat vijuan. Agjencia Shtetërore e Kadastrës edhe pas aplikimeve të kryera nga inspektorët e masave shtrënguese të mbledhjes me forcë komform ligjit dhe pagesës përkatëse nuk kthen një përgjigje, ose kërkon dokumentacion shtesë një pjesë të së cilave DMDTP nuk i disponon (dokument original pronësie për pasuritë objekt kërkesë, kopje ID të pronarit etj). Kërkesa për informacion bëhet sepse inspektori i borxheve nuk i identifikon dot vetë në modulën ASHK për institucionet pasuritë e paluajshme të tatimpaguesit debitor për shkak të mosdixhitalizimit të të gjitha pronave në Rajonin Verior.

6. Kërkesa për pezullimin e aktivitetit në Doganë

Për subjektet me detyrime tatimore të papaguara në bazë të marrëveshjes së Bashkëpunimit mes Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave dhe DPT-së që nga muaji Nëntor 2023 ndërmerret nga strukturat përkatëse pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve.

7. Sekuestrimi dhe konfiskimi i pasurisë

Sipas Nenit 34 pika 2, të ligjit “**Për kundërvajtjet administrative**” mbi të cilin bazohet sekuestrimi dhe konfiskimi i pasurisë nga Administrata Tatimore:

Pika 2. Për sekuestrimin e pasurisë mbahet procesverbal, ku përmenden personat e pranishëm dhe karakteristikat e pasurisë së marrë. Pasuria e sekuestruar transportohet e depozitohet në magazina ose dyqane për shitjen, që ngrihen për këtë qëllim. Vlera e pasurisë caktohet me ekspertë të ngarkuar nga nëpunësi sekuestrues.

Nuk disponohet komunikimi ose shkresë nga DPT ku do transportohen apo depozitohen mjetet e sekuestruara sipas standarit dhe kriterëve në mënyrë që deri në shitjen e tij në ankand të mos kemi zhvlefesim apo dëmtim të mjetit për shkak të kushteve dhe sigurisë së ruajtjes së tyre. Në ligj nuk përcaktohet mënyra sesi do të caktohet ky ekspert, kushtet ligjore që duhet të plotësojë, nëse ka fond të

përcaktuar për këtë procedurë etj. Gjithashtu gjatë procedurës së vendosjen së barrës siguroese në RBS nuk merret informacion nëse mbi këtë pasuri të luajtshme rëndojnë barrë të tjera përveç asaj të vendosur nga DMDTP në mënyrë që të procedohet me sekuestrimin e saj.

Bazuar në nenin 93 të ligjit “Sekuestrimi dhe konfiskimi i pasurisë”

Sekuestrimi i pasurive të tatimpaguesit mbi të cilat me anë të Vendimit të marrjes së masave të sigurisë është vendosur barrë siguroese apo hipoteke, bëhet nga administrata tatimore ditën e parë pasardhëse të punës që llogaritet mbas 40 ditëve nga data kur administrata tatimore i ka dërguar tatimpaguesit, njoftimin për pagimin e detyrimeve tatimore të papaguara prej tij, dhe që e ka njoftuar se ndaj tij do të fillojnë procedurat për mbledhjen me forcë të detyrimit tatimor.

Vendosja e kësaj mase varet nga përgjigjet që marrim nga institucionet me të cilat bashkëpunohet respektimi i afatit prej 40 ditësh për sekuestrimin dhe konfiskimin e pasurisë, në të shumtën e rasteve nuk mund të respektohet.

Për fillimin e procedurës së sekuestrimit të pasurisë nuk plotësohen të gjitha kushtet ligjore dhe llogjistike.

8. Shitja e pasurisë së konfiskuar

Kjo masë shtrënguese vjen pasi të jetë bërë sekuestrimi i pasurisë dhe duke qenë se kjo masë nuk është marrë nuk mund të vijohet me tej me shitjen e pasurisë në përputhje me të gjitha rregullat e parashikuara në ligjin “Për ankandin publik”, procedurë e cila zbatohet nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, si Autoritet Tatimor Qëndror.

9. Transferimi i detyrimit tatimor palës së tretë

Drejtoria/Spektori i Mbledhjes Së Detyrimeve Tatimore të Papaguara në Rajone ka të drejtë të kërkojë përmbushjen e detyrimit të papaguar dhe nga personat e tretë, nëpërmjet transferimit të detyrimit të tatimpaguesit tek këta persona. Transferim i detyrimit tatimor palës së tretë bëhet nga ana e inspektorit përgjegjës në çështje dhe aprovohet nga Drejtori i Drejtorisë përgjegjëse për mbledhjen e detyrimeve tatimore të papaguara.

Persona të tretë të cilëve administrata tatimore u transferon detyrimin, konsiderohen ata persona, të cilet gjatë periudhës së mbledhjes me forcë të detyrimeve kundrejt një tatim paguesi, kanë përfituar prej tij pasuri të ndryshme.

Drejtoria/Spektori i Mbledhjes se Detyrimeve Tatimore të Papaguara në Rajone duhet të ketë parasysh se ligji kërkon domosdoshmërisht përmbushjen e dy kritereve për transferimin e detyrimit:

Së pari detyrimi tatimor i tatimpaguesit të mos jetë arkëtuar plotësisht edhe pas shitjes së pasurive të tatimpaguesit, pasuri ndaj të cilave më parë ishin marrë masat e sigurimit të detyrimit.

Së dyti që personi i tretë t'i ketë fituar këto pasuri prej tatimpaguesit debitor, gjatë periudhës së fillimit dhe zbatimit të procedurave të mbledhjes me forcë të detyrimit tatimor të papaguar. Vetëm në këto raste administrata tatimore transferon detyrimin e papaguar tek personi i tretë.

Duke qenë se nuk është realizuar sekuestrimi, konfiskimi dhe shitja e pasurive të tatimpaguesit, pasuri ndaj të cilave më parë ishin marrë masat e sigurimit të detyrimit nuk plotësohet kriteri i parë për vazhdimin e masës së transferimit të detyrimit tatimor palës së tretë.

Ligji kërkon domosdoshmërisht përmbushjen e dy kritereve për transferimin e detyrimit prandaj administrata tatimore nuk mundet të kryejë këtë procedurë.

10. E drejta për të kërkuar detyrimet nga pala e treta

Administrata tatimore njëkohësisht me procedurat e tjera të vjeljes me forcë të detyrimit tatimor të përcaktuara në ligjin e procedurave tatimore, në ato raste kur ka dijeni që palë të treta kanë për të paguar shuma të caktuara në favor të tatimpaguesit debitor, mund të kërkojë nga këta persona që detyrimet e tyre monetare kundrejt tatimpaguesit, ti derdhin në favor të administratës tatimore.

Nuk disponohet informacion zyrtar që palë të treta kanë për të paguar shuma të caktuara në favor të tatimpaguesit debitor as nga vetë subjekti debitor dhe as nga struktura të tjera të administratës tatimore.

11. Përgjegjësia e ortakut, aksionarit dhe administratorit

Në rastin e personave juridikë, kur pas shitjes së pasurive të personit tatimpagues debitor, administrata tatimore nuk ka arritur ta mbledhë detyrimin tatimor të papaguar kundrejt saj, ajo e transferon detyrimin tatimor të personit juridik tek ortakët, aksionerët dhe tek administratorët e personit juridik.

Duke qenë se nuk është ezauruar sekuestrimi, konfiskimi dhe shitja e pasurisë nuk është e mundur ligjërisht që të kalohet në marrjen e kësaj mase.

12. Deklarimin e detyrimit tatimor si të pambledhshëm

Bazuar në nenin 103 pika 1, të Ligjit nr 9920, date 19.05.2008 “Për Proçedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar dhe udhëzimit Nr 24, date 02.09.2008 në zbatim të tij:

Deklarimi si i pambledhshëm i detyrimeve tatimore, është proces i cili kryhet vetëm në raste ekstreme, dhe vetëm në ato raste kur administrata tatimore ka zbatuar të gjitha masat e mbledhjes me forcë të detyrimeve tatimore të parashikuara nga nenet 88- 101 të Ligjit, dhe nuk është arritur të mbledhet dhe të arkëtohet detyrimi tatimor. Detyrimi tatimor mund të deklarohet i pambledhshëm vetëm në rastet e mëposhtme:

a) Kur megjithëse është bërë shitja e investimeve likuide dhe aktiveve të tjera, nuk është bërë i mundur arkëtimi i detyrimit. Sipas këtij parashikimi administrata tatimore në çdo rast duhet të ketë të evidentuara dhe të provuara që ajo ka kryer të gjitha veprimet e kërkuara nga ligji për vendosjen e masave të sigurisë mbi të gjitha pasuritë e subjektit. Tatimpaguesi duhet gjithashtu të provojë se nuk disponon pasuri të tjera të çdo forme dhe kudo që të ndodhen të cilat mund të përdoren për shlyerjen e detyrimeve,

b) Tatimpaguesi dhe administrata tatimore provojnë me evidencë të saktë se tatimpaguesi nuk disponon asnjë lloj pasurie apo të ardhure që do mund të përdoren për shlyerjen qofte edhe me këste të detyrimit tatimor të papaguar, dhe se edhe veprimtaria e ardhshme e tatimpaguesit, nuk mund të gjenerojë, apo të sjellë të ardhura, të cilat të jenë të vlefshme për përmbushjen e detyrimit tatimor.

c) Kur administrata tatimore nga analiza e situatës financiare dhe pasurore të subjektit tatimpagues arrin në përfundimin se edhe nëse ndaj tatimpaguesit do të fillonte një procedurë likuidimi apo falimentimi, shuma e detyrimit tatimor nuk mund të mbledhet edhe sikur ky proces të përfundonte dhe se pasuria në pronësi të tatimpaguesit, debitorit që gjendet pranë tij apo në përdorim tek personat e tretë, nuk është në gjendje të përmbushë edhe pagimin e kostove administrative të këtij procesi.

Që detyrimi tatimor të konsiderohet i pambledhshëm duhet që të plotësohen të gjitha kushtet e dhëna në paragrafët a), b) dhe c) më lart.

Nga ana e DMDTP, Rajoni Verior nuk janë ezauruar të gjitha procedurat e mbledhjes me forcë për tatimpagues që kanë detyrime tatimore të papaguara.

12. Falimenti

Administrata tatimore në rastet kur kërkon fillimin e procedurës së falimentit në gjykatë, është në rolin e kreditorit dhe në këto kushte kërkesa për fillimin e procedurës së falimentit i referohet nenit 16 të Ligjit nr. 110/2016 “Për falimentin”, i cili përcakton:

1. Gjykata e falimentimit duhet të pranojë kërkesën e kreditorit, nëse kreditori provon se debitori është në gjendjen e paaftësisë paguese. Për të paraqitur këtë kërkesë, kreditori duhet të provojë ekzistencën e një detyrimi të maturuar dhe të papaguar.

2. Gjendja e paaftësisë paguese prezumohet në qoftë se kreditori ka dështuar në ekzekutimin e një detyrimi në një procedurë të ekzekutimit të detyrueshëm gjatë periudhës së ekzekutimit vullnetar, sipas parashikimeve të nenit 517, të Kodit të Proçedurës Civile. Debitori, me anë të paraqitjes së provave, mund të kundërshtojë këtë prezumim nëse vërteton se ka aftësi paguese dhe se nuk ka një detyrim të maturuar e të papaguar ndaj kreditorit.

Për sa më sipër, DMDTP, Rajoni Verior si palë kreditore nuk ka mundur të ezaurojë të gjitha masat shtrënguese në mënyre kronologjike sipas Ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe udhëzimit nr. 24, datë 02.09.2008 në zbatim të tij.

2.1.4. Drejtoria e Mbledhjes së Detyrimeve Tatimore të Papaguara në Drejtorinë e Tatimpaguesëve të Mëdhenj

Struktura e DMDTP, DTM rezultoi një drejtori e krijuar mbi bazën ligjore, e cila ka qendrën në Tiranë.

Drejtoria funksionon e përbërë nga 3 (tre) sektorë:

- Sektori i Monitorimit, Analizës për Masat Shtrënguese,
- Sektori i Zbatimit në Terren të Masave Shtrënguese,
- Sektori i Procedurave Ligjore të Mbledhjes me Forcë.

Struktura për periudhën e vitit 2024, krahasuar me strukturën e miratuar në Drejtorinë e Përgjithshme Tatimore, paraqitet si mëposhtë:

DTM (1+3+7)	Plan sipas urdhrimit KM nr. 69, dt. 26.05.2023	Pas implement. të strukturës dt.01.02.2024	Fakt 31.12.2024	Diferenca Plan /Fakt
Drejtor Drejtorie	1	0	0	1
Sektori i Monitorimit, Analizës për masat shtrënguese				
- Përgjegjës Sektori	1	1	1	-
- Inspektorë	3	1	2	1
Sektori i Zbatimit në Terren të Masave Shtrënguese				
- Përgjegjës Sektori	1	1	1	-
- Inspektorë	2	1	1	1
Sektori i Procedurave Ligjore të mbledhjes me forcë				
- Përgjegjës Sektori	1	0	1	-
- Inspektorë	2	1	2	-
	11	5	8	3

Burimi: Drejtoria e Burimeve Njerëzore në DPT, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

Sa më sipër, u konstatua se struktura e DMDTP në DTM është miratuar me 11 punonjës (1 drejtor drejtorie, 3 përgjegjës sektori dhe 7 inspektorë). Më datë 01.02.2024 rezultojnë 5 punonjës në total, ndërsa më datë 31.12.2024 rezultojnë 8 punonjës, me një diferencë nga plani i miratuar me 3 punonjës. Nga auditimi u konstatua se pozicioni vakant i drejtorit të DMDTP në DTM, nuk është plotësuar me emërim të ri, por me ngarkim të përkohshëm në detyrë.

1 Analizimi i detyrimeve tatimore sipas statusit të tatimpaguesit.

Në fund të vitit 2024, numri i përgjithshëm i tatimpaguesve me borxh në DTM rezultoi të jetë 238, duke përfshirë si subjekte aktive, ashtu edhe ato pasive. Nga analiza e të dhënave vërehet se pesha më e madhe e borxhit tatimor rrjedh nga tatimpaguesit aktivë, të cilët përbëjnë 232 subjekte dhe kanë një vlerë të detyrimeve të papaguara në shumën prej 8,041,742 mijë lekë.

Vetëm 6 subjekte rezultojnë të jenë pasivë, me një borxh të akumuluar në shumën prej 118,788 mijë lekë. Kjo tregon se borxhi i lidhur me bizneset e pezulluara ose të mbyllura nuk është një faktor me peshë në strukturën e detyrimeve të papaguara të kësaj drejtorie.

2. Analizimi i detyrimeve tatimore të ndara sipas pronësisë.

Borxhi tatimor i akumuluar në vitin 2024 ka një shpërndarje midis bizneseve të mëdha, ndërmarrjeve shtetërore dhe enteve buxhetore. Këto shifra janë një tregues i rëndësishëm i disiplinës fiskale të subjekteve ekonomike dhe efektivitetit të administratës tatimore në arkëtimin e të ardhurave të buxhetit të shtetit.

- Bizneset e mëdha përbëjnë pjesën më të madhe të borxhit tatimor të regjistruar deri më 31 dhjetor 2024, me një vlerë prej 8,160,530 mijë lekë, nga të cilat borxhi i ndërmarrjeve shtetërore arrin në shumën prej 4,602,535 mijë lekë ose 56%, e cila përbën një pjesë të konsiderueshme të detyrimeve të papaguara. Borxhi i akumuluar për entet buxhetore të cilat përfshijnë institucione shtetërore dhe agjenci të ndryshme publike, për vitin 2024 arrin në shumën prej 186,142 mijë lekë ose 2%.

3. Analizimi i detyrimeve sipas llojit të tatimit, i ndarë në principal/gjobë/interesa dhe ecuria e tyre çdo muaj

Nga të dhënat e vëna në dispozicion dhe të analizuara rezultoi se detyrimet e papaguara mbeten të përqendruara kryesisht tek Tatimi mbi Fitimin dhe TVSH, ndërsa tatime të tjera, si sigurimet shoqërore dhe tatimi në burim, kanë një ndikim më të moderuar në stokun total të borxhit.

3.1. Tatimi mbi Fitimin

Në fillim të vitit, borxhi i regjistruar për këtë kategori ishte në shumën prej 8,133,995 mijë lekë, duke pësuar ndryshime gjatë vitit 2024 si më poshtë vijon:

-Në janar, detyrimi u rrit në shumën prej 52,746 mijë lekë, si rezultat i shtimit të detyrimeve nga tatimpaguesit për fitimet e realizuara në periudhën e mëparshme.

-Në shkurt, borxhi shënoi një ulje të konsiderueshme në shumën prej 2,812,477 mijë lekë, e shoqëruar dhe me uljen e numrit të rasteve të debitorëve prej 197 raste.

-Në muajin mars dhe prill shënuan një rritje të moderuar, ndërsa maj dhe qershor vijuan me ulje të borxhit, duke reflektuar një trend pozitiv në arkëtim.

-Nga korriku deri në dhjetor, borxhi ka pësuar ulje të vazhdueshme, duke arritur në shumën prej 5,441,529 mijë lekë në 31.12.2024, ku krahasuar me çeljen e vitit ka pësuar një rënie në shumën prej 2,692,466 mijë lekë. Nga krahasimi i numrit të debitorëve në fund vitit me çeljen e vitit, rezultoi se kemi një rënie të numrit të debitorëve prej 170 raste.

Gjithashtu, vlera e këtij detyrimi në datë 31.12.2024 është përkatësisht principal në shumën 420,354 mijë lekë, gjoba në shumën prej 3,650,692 mijë lekë dhe interesa në shumën prej 1,370,484 mijë lekë. Sa më sipër vërehet se peshën më të madhe të këtij detyrimi e zënë gjobat në 67% të vlerës së borxhit për Tatim fitimin.

3.2. Tatimi mbi Vlerën e Shtuar (TVSH)

TVSH-ja është një nga tatimet me ndikimin më të madh në detyrimet totale, duke pësuar ndryshime gjatë vitit 2024 si më poshtë vijon:

- Në muajin janar, detyrimi i papaguar për TVSH-në u rrit në shumën prej 118,917 mijë lekë, por nga grupi i auditimit u konstatua se numri i rasteve ka pësuar rënie të konsiderueshme prej 169 raste.

- Në muajin shkurt, pati një rënie të ndjeshme të detyrimit në shumën prej 1,517,160 mijë lekë, ku u konstatua një rënie në numrin e subjekteve debitore krahasuar me muajin janar prej 788 raste.

- Në muajt pasues mars, prill dhe maj, borxhi ka pësuar ulje në shumën totale prej 514,441 mijë lekë, ndërsa muajin qershor u konstatua një rritje në shumën prej 24,361 mijë lekë, shoqëruar me një rritje të numrit të debitorëve me 148 raste.

- Në korrik dhe gusht, borxhi pësoi ulje në shumën prej 63,971 mijë lekë shoqëruar me një ulje të numrit të debitorëve me 110 raste.

- Në nëntor, u konstatua se borxhi për TVSH-në ka shënuar nivelin më të lartë të rritjes për këtë periudhë në shumën prej 97,137 mijë lekë, shoqëruar me një rritje të numrit të debitorëve me 353 raste krahasuar me muajin tetor.

Në fund të vitit, borxhi i TVSH-së rezultoi në shumën prej 1,757,447 mijë lekë, ku krahasuar me çeljen

e vitit ka pësuar një rënie në shumën prej 1,835,853 mijë lekë. Nga krahasimi i numrit të debitorëve në fund vitit me çeljen e vitit, rezultoi se kemi një rënie të numrit të debitorëve prej 323 raste. Gjithashtu, vlera e këtij detyrimi në datë 31.12.2024 është përkatësisht principal në shumën prej 459,286 mijë lekë, gjoba në shumën prej 1,199,540 mijë lekë dhe interesa në shumën prej 98,621 mijë lekë. Sa më sipër vërehet se peshën më të madhe të këtij detyrimi e zënë gjobat në 68% të vlerës së borxhit për TVSH-në.

3.3. Sigurimet Shoqërore

- Në muajin janar, borxhi për sigurimet shoqërore ka pësuar rënie në shumën prej 11,728 mijë lekë, ndërsa në shkurt dhe mars, pati rritje të papritura dhe ulje të mëdha, duke reflektuar probleme me disiplinën e pagesave.
- Në prill dhe qershor, borxhi u rrit ndjeshëm në shumën prej 34,276 mijë lekë dhe në shumën prej 76,097 mijë lekë sipas muajve respektivë.
- Në periudhën korrik-dhjetor, borxhi ka pësuar rritje dhe rënie në vlera jo të konsiderueshme, ku në fund të vitit, borxhi i sigurimeve shoqërore rezultoi në shumën prej 299,724 mijë lekë, ku krahasuar me çeljen e vitit ka pësuar një rritje në shumën prej 77,167 mijë lekë. Nga krahasimi i numrit të debitorëve në fund vitit me çeljen e vitit, rezultoi se kemi një rënie të numrit të debitorëve prej 825 raste. Gjithashtu, vlera e këtij detyrimi në datë 31.12.2024 është përkatësisht principal në shumën 246,037 mijë lekë, gjoba në shumën prej 41,798 mijë lekë dhe interesa në shumën prej 11,889 mijë lekë.

3.4. Tatimi mbi të Ardhurat Personale (TAP)

TAP ka pasur një trend të qëndrueshëm, me ndryshime të vogla krahasuar me tatimet e tjera.

- Në muajin janar dhe shkurt, borxhi u ul përkatësisht në shumën prej 7,630 mijë lekë dhe në shumën prej 5,587 mijë lekë.
- Në muajin mars, prill dhe maj, rezultoi me ndryshime rritje dhe rënie në vlera jo të konsiderueshme, ndërsa në muajin qershor borxhi pësoi një rritje të konsiderueshme në shumën prej 23,783 mijë lekë, me rritjen e numrit të debitorëve prej 49 raste.
- Në muajin gusht borxhi ka pësuar një rritje të konsiderueshme krahasuar me muajin korrik në shumën prej 19,250 mijë lekë, si dhe në muajin nëntor, detyrimi për TAP pati rritjen më të madhe prej 41,112 mijë lekë, ndërsa në dhjetor pësoi një ulje në shumën prej 13,517 mijë lekë, e shoqëruar me një rritje të numrit të debitorëve prej 36 raste. Borxhi i TAP rezultoi në shumën prej 123,009 mijë lekë, ku krahasuar me çeljen e vitit ka pësuar një rritje në shumën prej 50,960 mijë lekë. Nga krahasimi i numrit të debitorëve në fund vitit me çeljen e vitit, rezultoi se kemi një rënie të numrit të debitorëve prej 301 raste. Gjithashtu, vlera e këtij detyrimi në datë 31.12.2024 është përkatësisht principal në shumën 111,579 mijë lekë, gjoba në shumën 8,408 mijë lekë dhe interesa në shumën prej 3,221 mijë lekë.

3.5. Tatimi në Burim

Borxhi për Tatimin në Burim ka qenë relativisht i qëndrueshëm gjatë vitit, duke reflektuar një nivel më të mirë të arkëtimit.

- Në muajt janar-qershor, borxhi ka pësuar rritje dhe rënie në vlera të moderuara të detyrimeve, në muajt korrik-gusht, borxhi ka pasur rritje në vlerën prej 159,917 mijë lekë, shoqëruar me rritje të numrit të debitorëve prej 308 raste.
- Në muajt shtator-tetor, borxhi ka pësuar rënie në vlerën prej 107,303 mijë lekë, shoqëruar me ulje të numrit të debitorëve prej 119 raste.
- Në muajin nëntor borxhi u rrit ndjeshëm me 47,950 mijë lekë, shoqëruar me rritje të numrit të debitorëve prej 625 raste, ndërsa në muajin dhjetor pësoi një ulje në shumën prej 32,167 mijë lekë,

shoqëruar me ulje të numrit të debitorëve prej 66 raste.

Borxhi i TB rezultoi në shumën prej 283,343 mijë lekë, ku krahasuar me çeljen e vitit ka pësuar një rritje në shumën prej 1,854 mijë lekë. Nga krahasimi i numrit të debitorëve në fund vitit me çeljen e vitit, rezultoi se kemi një rritje të numrit të debitorëve prej 1,580 raste.

Gjithashtu, vlera e këtij detyrimi në datë 31.12.2024 është përkatësisht principal në shumën 459,286 mijë lekë, gjoha në shumën prej 1,199,540 mijë lekë dhe interesa në shumën prej 98,621 mijë lekë. Sa më sipër vërehet se peshën më të madhe të këtij detyrimi e zënë gjohat në 68% të vlerës së borxhit për TVSH-në.

3.6. Tatime të tjera

Gjatë vitit 2024, borxhi për *Tatime të Tjera* ka pasur luhajtje të konsiderueshme si vijon:

- Në muajin janar, pati rritjen më të lartë në shumën prej 121,641 mijë lekë, ndërsa në muajt shkurt dhe mars, borxhi pësoi rënie, përkatësisht në shumën prej 114,786 mijë lekë dhe në shumën prej 76,896 mijë lekë.


- Në muajt në vazhdim borxhi për këtë rezultoi me luhajtje në vlera të moderuara.

Borxhi në zërin “*të tjera*” rezultoi në shumën prej 255,478 mijë lekë, ku krahasuar me çeljen e vitit ka pësuar një rënie në shumën prej 51,096 mijë lekë. Nga krahasimi i numrit të debitorëve në fund vitit me çeljen e vitit, rezultoi se kemi një rënie të numrit të debitorëve prej 90 raste. Për sa më sipër, në lidhje me këtë detyrim, grupit të auditimit ende nuk i është vënë në dispozicion llogaria analitike e këtij detyrimi të llojit të tatimeve të përfshira në këtë zë.

Vlera e detyrimit për “*tatimin në burim dhe të tjera*” në datë 31.12.2024 është përkatësisht principal në shumën prej 118,484 mijë lekë, gjoha në shumën prej 392,782 mijë lekë dhe interesa në shumën prej 27,555 mijë lekë. Sa më sipër vërehet se peshën më të madhe të këtij detyrimi e zënë gjohat në 72% të vlerës së borxhit.

3.7. Analizë e borxhit sipas moshës:

Nga auditimi i detyrimeve tatimore të papaguara, rezultoi se borxhi i akumuluar është i shpërndarë në periudha të ndryshme kohore, duke përfshirë detyrime të krijuara në tre muajt e fundit deri te borxhi me më shumë se dhjetë vjet.



Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të DPT

- *Borxhi deri në 3 muaj* përbën një kategori që vlerësohet si borxh me probabilitet të lartë rikuperimi, duke qenë se detyrimet janë krijuar së fundmi dhe mund të jenë rezultat i mosrespektimit të afateve të pagesave nga tatimpaguesit aktivë. Kjo kategori paraqitet në shumën prej 611,899 mijë lekë, ku pjesa më e madhe janë detyrimet ndaj TVSH-së në shumën prej 219,732 mijë lekë, ndjekur nga sigurimet shoqërore në shumën prej 161,900 mijë lekë dhe Tatimi mbi Fitimin në shumën prej 57,913 mijë lekë.

- Në kategorinë e *borxhit nga 3 deri në 6 muaj*, vërehet një ulje e ndjeshme në vlerën e borxhit, duke arritur në shumën prej 314,673 mijë lekë. Struktura e borxhit në këtë kategori është e ngjashme me moshën e borxhit deri në 3 muaj, ku pjesa më e madhe janë detyrimet ndaj TVSH-së në shumën prej 88,565 mijë lekë.
- Për *detyrimet nga 6 deri në 12 muaj*, evidentohet një rritje e ndjeshme e vlerës së borxhit, e cila arrin në shumën prej 787,903 mijë lekë, ku rritja më e madhe në këtë kategori vërehet në zërin e Tatimit mbi Fitimin, i cili paraqitet në shumën prej 557,997 mijë lekë.
- Analiza e *detyrimeve nga 1 deri në 2 vjet* tregon një total borxhi në shumën prej 691,875 mijë lekë, duke reflektuar një kategori të ndërmjetme mes borxhit afatshkurtër dhe atij afatgjatë. Ndërsa TVSH-ja dhe Tatimi mbi Fitimin mbeten komponentët kryesorë të këtij borxhi.
- Për *detyrimet nga 2 deri në 5 vjet*, borxhi i akumuluar është në shumën prej 1,815,657 mijë lekë, duke përfaqësuar një rritje të ndjeshme krahasuar me kategoritë e mëparshme. Në këtë periudhë kohore, dominon Tatimi mbi Fitimin në shumën prej 1,365,263 mijë lekë, duke treguar se një numër i madh biznesesh nuk ka shlyer detyrimet për fitimet e viteve të kaluara.

Sa më sipër, nisur nga moshja e borxhit, kjo kategori paraqet me një probabilitet të ulët arkëtimi, duke qenë se shumë nga këto detyrime i përkasin subjekteve që mund të jenë mbyllur ose që janë në proces gjyqësor me administratën tatimore.

Borxhi *mbi 5 vjet* borxhi i akumuluar është në shumën prej 3,893,292 mijë lekë. Tatimi mbi Fitimin dhe TVSH-ja zënë pjesën më të madhe të këtij borxhi, përkatësisht në shumën prej 3,030,597 mijë lekë dhe në shumën prej 697,493 mijë lekë, duke reflektuar një bazë të gjerë të tatimpaguesve që nuk kanë përmbushur detyrimet e tyre për një periudhë të gjatë kohe. Kjo kategori përfaqëson një risk më të lartë të humbjes fiskale, pasi probabiliteti i arkëtitimit të detyrimeve është shumë i ulët.

- Detyrimet mbi 10 vjet, krahasuar me detyrimet e mësipërme, paraqiten në vlera të papërfillshme, me një vlerë prej 45,232 mijë lekë.

Konkluzion: Nga analiza e strukturës së borxhit sipas moshës, rezultoi se mbi 80 % e detyrimeve tatimore të papaguara i përkasin kategorive me moshë mbi dy vjet, ku konkretisht 52.64 % i takojnë borxhit të krijuar mbi pesë vjet më parë, ndërsa 27.62 % përfaqëson borxhin e klasifikuar ndërmjet 2 (dy) deri 5 (pesë) vjet. Ky tregues reflekton një përqendrim të lartë të borxhit në kategori me probabilitet të ulët arkëtimi dhe përbën një rrezik të shtuar fiskal për buxhetin e shtetit, duke qenë se një pjesë e konsiderueshme e detyrimeve i përket tatimpaguesve të cilët rezultojnë të jenë mbyllur ose janë në proces gjyqësor me administratën tatimore. Pavarësisht kësaj situatë, nga auditimi u konstatua se nuk janë ndërmarrë masa specifike dhe të strukturuar për trajtimin e kësaj kategorie borxhi me risk të lartë, në kundërshtim me udhëzimin nr. 24, datë 02.09.2008, neni 31, pika 4, i cili përcakton se detyrimet tatimore të papaguara duhet të klasifikohen sipas moshës dhe të trajtohen me përparësi nga strukturat përgjegjëse.

4. Evidentimi dhe raportimi mujor i detyrimeve për veprime të mëtejshme nga sektorët përkatës.

- Metodologjia në raportimin e borxhit

Nga Sektori i Monitorimit dhe Analizës për Masat Shtrenguese në Drejtorinë e Mbledhjes së Detyrimeve të Papaguara në DTM për hartimin e evidencave mujore dhe raportimin e borxhit, bazuar në raportet e debitorëve bruto të sjella nga IT në DPT, në fillim të çdo muaji kryen këto veprime:

Pastrohet databaza nga detyrimet korrente të cilat kanë afat pagese në muajin pasardhës.

Konkluzion: Për shkak të kufizimeve teknike të sistemit C@ts në përpunimin automatik të të dhënave, plotësimi i databazave është kryer në mënyrë manuale. Ky proces, ndonëse i domosdoshëm për vijimin e

punës, ka rritur ngarkesën e punës dhe riskun për gabime njerëzore. Gjithashtu përpunimi i të dhënave manualisht paraqet risk të konsiderueshme në drejtim të saktësisë dhe përputhshmërisë së të dhënave, si dhe mund të ndikojë negativisht në pasqyrimin e plotë dhe të besueshëm të informacionit të nevojshëm për analizat institucionale.

Kjo qasje, përveç rritjes së rrezikut për gabime dhe pasaktësi, ka sjellë edhe mungesë unifikimi në metodologjitë e përdorura gjatë përpunimit dhe raportimit të të dhënave. Si pasojë, janë raportuar të dhëna që nuk janë gjithmonë të krahasueshme ndërmjet institucioneve, çka ndikon negativisht në cilësinë, saktësinë dhe vlerën analitike të informacionit të grumbulluar”.

Subjektet mosdeklaruese të cilët duhet të rezultojnë si debitorë më 31.12.2024 në DTM

Në funksion të vlerësimit të saktësisë së të dhënave të raportuara mbi borxhin tatimor të papaguar në fund të vitit, grupi i auditimit ka kryer një test analitik krahasues midis listës së debitorëve të raportuar nga DMDTP në DTM me datë 31.12.2024 dhe pagesave të kryera nga tatimpaguesit gjatë muajit Janar 2025. Testimi është fokusuar në detyrimet lidhur me tatimin mbi vlerën e shtuar (TVSH) dhe kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore.

Nga analiza është konstatuar se një numër tatimpaguesish, të cilët kishin detyrime të prapambetura për periudhën tatimore përkatëse të muajit Nëntor 2024 dhe muajt më herët, kanë kryer pagesa për këto detyrime në muajin Janar 2025. Nga ana tjetër, këta tatimpagues nuk rezultojnë të përfshirë në listën e debitorëve të raportuar me datë 31.12.2024 nga administrata tatimore.

Nga auditimi u konstatuan 113 raste në vlerë totale 144,446,335 lekë të paguara për TVSH në muajin Janar 2025, për efekt të TVSH-së së muajit Nëntor 2024 dhe më herët, të cilët nuk janë pjesë e debitorëve më 31.12.2024, duke dikuar në pasaktësinë dhe besueshmërinë e informacionit të raportuar mbi stokun e borxhit tatimor në fund të vitit. Lista e debitorëve pasqyrohet në Aneksin nr. 4/1 bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Nga grupi i auditimit u konstatua e njëjta situatë edhe për detyrimet mbi kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, ku janë kryer testimet përkatëse për bizneset VIP. Nga testimi janë konstatuar 160 raste në vlerë totale prej 138,530,316 lekë të paguara në muajin Janar 2025, për efekt të kontributeve e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore të muajit Nëntor 2024 dhe më herët, të cilët nuk janë pjesë e debitorëve më 31.12.2024, duke dikuar në pasaktësinë dhe besueshmërinë e informacionit të raportuar mbi stokun e borxhit tatimor në fund të vitit. Lista e debitorëve pasqyrohet në Aneksin nr. 4/1 bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Vlera e raportuar si borxh më datë 31.12.2024 paraqitet e nënvlerësuar minimalisht në vlerën 282,976,651 lekë.

Nga auditimi u konstatua se, subjektet e sipas Aneksit nr. 4/1 dhe 4/2 kanë qenë mosdeklarues të përsëritur për periudha të njëpasnjëshme, duke shmangur dorëzimin e deklaratave tatimore në rastet kur potencialisht nuk kanë fonde për të kryer pagesën. Ky veprim ka ndikuar në pasqyrimin e pasaktë të detyrimeve në sistem, si dhe ka ulur ndjeshëm mundësinë për marrjen e masave të menjëhershme për mbledhjen e detyrimit.

Në mungesë të një deklarate të dorëzuar, sistemi nuk gjeneron automatikisht borxh të prapambetur, duke krijuar kështu një boshllëk në identifikimin dhe evidentimin e detyrimeve reale. **Për rrjedhojë, përveç nënvlerësimit të stokut të borxhit tatimor, u konstatua edhe dobësim i mekanizmave të kontrollit dhe efektivitetit të sistemit të mbledhjes së të ardhurave, duke ndikuar në raportimin e pasaktë të vlerës së debitorëve me datë 31.12.2024.**

5. Mbi vlerësimin e masave shtrënguese të marra për mbledhjen e detyrimeve tatimore të papaguara.

Akt-Marrëveshjet me Këste

Nga auditimi u konstatua se në DTM janë gjithsej 12 akt marrëveshjeve aktive, të cilat paraqiten në Aneksin nr. 4/3 bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Referuar regjistri të vënë në dispozicion grupit të auditimit u konstatua se:

Përmbajtja dhe hartimi i këtij regjistri nuk kishte elemente për te arritur në një konkluzion për ecurinë e këtyre akt-marrëveshjeve në përputhje me kërkesat ligjore.

Formati i regjistrimit nuk është i miratuar as nga Drejtori i Drejtorisë së Mbledhjes së Detyrimeve Tatimore të Papaguara dhe as një format të miratuar dhe dërguar nga DPT, si rrjedhojë ky format është mbajtur sipas gjykimit të inspektorëve. Një ndër elemente shumë të rëndësishme për të gjykuar për ecurinë e akt marrëveshjeve ishte dhe fakti nëse subjekti gatë kësaj periudhe ka krijuar apo jo detyrime të reja.

Nga auditimi i akt-marrëveshjeve aktive të lidhura me tatimpaguesit e përfshirë në tabelën e sipërcituar, u konstatua se në momentin e lidhjes së tyre janë përfshirë detyrimet tatimore në kohë reale, të cilat përfshijnë jo vetëm detyrimin principal, por edhe gjokat dhe interesat e regjistruara, si dhe gjokat dhe interesat e paregjistruara.

Megjithatë, nga auditimi i raportimit të detyrimit për secilin debitor, u konstatua se raportimi zyrtar i detyrimit të papaguar përfshin vetëm gjokat dhe interesat e regjistruara në sistemin tatimor. Kjo sjell një mospërputhje me realitetin financiar të marrëveshjeve, pasi në urdhrat e pagesës që shoqërojnë këto marrëveshje përfshihet dhe paguhet shuma totale, përfshirë edhe interesat dhe gjokat e paregjistruara.

Kjo mospërputhje mes raportimit dhe përmbajtjes reale të marrëveshjeve krijon mospasqyrim të saktë të detyrimeve, si dhe rrezik për nënvlerësim të stokut të borxhit në raportimet zyrtare.

Nga analiza e të dhënave mbi interesat e paregjistruara në secilën nga akt-marrëveshjet përkatëse, të cilat paraqiten në Aneksin nr. 4/3.1 bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit, sipas zërave u konstatua se, për këto debitorë gjokat dhe interesat janë në 2 (dy) zëra të ndryshëm, përkatësisht gjoka të regjistruara, gjoka të paregjistruara si dhe interesa të regjistruar, interesa të paregjistruara në sistemin tatimor. Në total, për 12 tatimpaguesit e analizuar, vlera e gjobave të paregjistruara arrin në 33,535 mijë lekë, ndërsa interesat e paregjistruara në shumën prej 10,951 mijë lekë. Totali prej 44,486 mijë lekë, ndonëse janë përfshirë në akt marrëveshjet e lidhura ndërmjet palëve, nuk rezultojnë të pasqyruara si detyrim në evidencat zyrtare të raportuara për borxhin tatimor. Nga auditimi i të dhënave të sipërcituara, shuma e gjobave dhe interesave të paregjistruar zë një peshë prej 18% të totalit të gjobave dhe interesave. Pra, situata e mësipërme krijon një mospërputhje midis detyrimit që paguhet nëpërmjet kësteve dhe asaj që pasqyrohet zyrtarisht në sistemin e borxhit të administratës tatimore. Si rrjedhojë, evidencat zyrtare nuk paraqesin një pamje të plotë dhe reale të detyrimit të mbetur dhe të arkëtimit të realizuar për çdo muaj.

Si rrjedhojë, **evidencat zyrtare nuk paraqesin një pamje të plotë dhe reale të detyrimit të mbetur dhe të arkëtimit të realizuar për çdo muaj.**

Veprimet e mësipërme janë kryer në kundërshtim me *Manualin e Mbledhjes së Borxhit*, **Pika 3.2.1 – Dokumentimi i masave të ndërmarrë:** “Për çdo veprim të ndërmarrë nga strukturat e borxhit në drejtim të ndjekjes së detyrimit tatimor të papaguar duhet të mbahet dokumentacion përkatës në dosje, si në format fizik ashtu edhe elektronik. Çdo vendimmarrje administrative apo masë shtrënguese duhet të jetë e dokumentuar dhe e aksesueshme në sistemin elektronik; **Pika 3.2.3 – Raportimi dhe analiza e masave,** ”Drejtoria Rajonale dhe strukturat përkatëse të DMDTP janë të detyruara të përgatisin raporte analitike dhe përmbledhëse periodike (muajore, tremujore, vjetore) mbi veprimtarinë e tyre, numrin e masave të

ndërmarra, rezultatet në vlerë dhe në përqindje, si dhe analizën e performancës në lidhje me borxhin tatimor.”

Masat shtrënguese dhe efektiviteti i tyre për vitin 2024

Në DTM, gjatë vitit 2024 janë ndërmarrë gjithsej 2,480 masa shtrënguese, me një vlerë totale prej 16,075,725 mijë lekë. Nga këto, janë arkëtuar 2,009 masa, në shumën 8,367,962 mijë lekë, ndërsa janë liruar 168 masa, me një vlerë të përgjithshme prej 1,195,290 mijë lekë, të paraqitura në Aneksin nr. 4/4 bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Në analizë masat shtrënguese sipas llojit :

- Njoftimi dhe kërkesa për të paguar është masa më e përdorur, me 2,068 raste të vendosura në shumën 9,052,004 mijë lekë, nga të cilat 1,740 raste janë arkëtuar, duke sjellë të ardhura në shumën prej 7,054,706 mijë lekë. Për këtë masë nuk është regjistruar asnjë rast i liruar.
- Urdhri për bllokimin e llogarive bankare është aplikuar në 153 raste, në vlerën 2,494,695 mijë lekë. Janë arkëtuar 96 raste dhe janë liruar 85 raste, në një shumë prej 665,951 mijë lekë.
- Urdhrat e ekzekutimit janë përdorur në 94 raste, me një shumë 99,053 mijë lekë. Janë arkëtuar 91 raste në shumën 109,024 mijë lekë (duket një mospërputhje në të dhëna, pasi shuma e arkëtuar tejkalon atë të vendosur), ndërsa 2 raste janë liruar në shumën 5,589 mijë lekë.
- Masat e lidhura me barrën hipotekore dhe siguroese janë përdorur në mënyrë më të kufizuar:
 - Njoftimi i përgjithshëm për vendosjen e barrës: 6 raste, 704,628 mijë lekë të vendosura; 2 raste të arkëtuara dhe 2 raste të liruar (nga 5,158 mijë lekë).
 - Njoftimi tatimpaguesit për barrë: 12 raste, 146,106 mijë lekë të vendosura; 2 raste të arkëtuara dhe 2 të liruar (nga 5,529 mijë lekë).
 - Barrë hipotekore dhe siguroese: gjithsej 10 raste të kombinuara, shumica me vlerë të ulët.
- Kërkesa për pezullim të aktivitetit në doganë është aplikuar 96 herë, me 65 raste të arkëtuara dhe 65 të liruar, me një shumë të liruar 416,809 mijë lekë.
- Njoftimi për vendosjen e masës së sigurimit tatimor në QKB: 26 masa janë vendosur në shumën 1,418,515 mijë lekë, ku 10 janë arkëtuar dhe 9 janë liruar, në shumën 80,213 mijë lekë.
- Masa të tjera si urdhrat e sekuestrimit, transferimi i detyrimit tatimor palës së tretë dhe transferimi i detyrimit të Ortaku/Aksioneri/Administratori nuk janë përdorur gjatë kësaj periudhe.

Nga auditimi i të dhënave mbi masat shtrënguese, u konstatua se krahas numrit të lartë të masave të vendosura, rezultoi se vetëm rreth 52% e shumës totale është arkëtuar, ndërsa vlera e lirimeve përbën rreth 7.4% të totalit të masave të vendosura, gjë që tregon një nevojë për forcimin e ndjekjes së ekzekutimit dhe përmirësimin e eficiencës së procesit.

-Nga kryqëzimi i të dhënave për debitorët e raportuar me ato të likuiduar u konstatua se në arkëtimet progresive mujore nuk janë përfshirë vlerat e arkëtimeve që burojnë nga masat shtrënguese, me argumentin se këto detyrime nuk figurojnë në listën e debitorëve të muajit të mbyllur. Një situatë tipike është rasti i TVSH-së, ku detyrimi duhet të shlyhet deri më datë 20 të muajit pasardhës. Nëse tatimpaguesi nuk e shlyen brenda afatit ligjor, por e paguan më vonë – për shembull më datë 28 – si rezultat i masave shtrënguese të ndërmarra, kjo shumë nuk raportohet si arkëtim debitorësh, me arsyetimin se pagesa është kryer brenda të njëjtit muaj kalendarik.

Kjo qasje sjell një reflektim të pasaktë të ndikimit të masave shtrënguese në arkëtim, si dhe zvogëlon artificialisht nivelin e detyrimeve të mbetura. Për më tepër, nënvlerëson rolin e masave shtrënguese në përmirësimin e disiplinës fiskale.

Në zbatim të nenit 89 pika 2 të Ligjit Nr.9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në RSH” i ndryshuar, thuhet;

2. Nëse tatimpaguesi nuk përdor të drejtën e ankimit dhe nuk paguan detyrimin tatimor, administrata tatimore duhet ta mbledhë tatimin, duke përdorur njërën ose disa prej mënyrave, të parashikuara në këtë kre. Gjithashtu, në funksion të mbledhjes së detyrimit tatimor të papaguar të tatimpaguesit, administrata tatimore mund të angazhojë strukturat e saj për të verifikuar dhe monitoruar në vend aktivitetin tregtar të tatimpaguesit, me qëllim konfiskimin në fund të çdo dite të një shume jo më pak se 50 për qind të qarkullimit të realizuar, por jo më shumë se detyrimi tatimor, për të cilin ka filluar procedura e mbledhjes me forcë të detyrimeve tatimore, për llogari të detyrimeve tatimore të pashlyera të tatimpaguesit. Paga e shumës së qarkullimit të sekuestruar kalohet në llogarinë bankare të administratës tatimore ditën e nesërme. Tatimpaguesi, për të cilin administrata tatimore ka filluar mbledhjen me forcë të detyrimeve tatimore të papaguara, nuk mund të kryejë transferim të shumave të parave nga llogaria e tij apo të shesë\ të transferojë aktivet ose kapitalet e shoqërisë, me përjashtim të rasteve kur, nëpërmjet shitjes\ transferimit të aktiveve, synohet shlyerja në masën 100 për qind e detyrimit tatimor të papaguar”. Nga auditimi rezultoi se nga Sektorit i Monitorimit, Analizës për Masat Shtrënguese nuk ishin dërguar/përgatitur lista tatimpaguesish të veçantë, të planifikuar për konfiskim të 50% të qarkullimit të realizuar (por jo më shumë se detyrimi), tek sektori i procedurave ligjore të mbledhjes me forcë për zbatim, referuar neneve 35 dhe 36 pikat 7 të rregullores së brendshme miratuar me Urdhër nr.192, datë 12.08.2020, dhe Manualit të Mbledhjes me Forcë.

Bazuar në nenet 31 dhe 32, pikat 6 të rregullores së brendshme të Administratës Qendrore të Tatimeve dhe Manualit të Mbledhjes me Forcë në zbatim të programit të auditimit grupi i auditimit kërkoi sektorit të procedurave ligjore të mbledhjes me forcë evidencë mbi tatimpaguesit, të cilët i janë nënshtruar verifikimit dhe monitorimi në vend të aktivitetit tregtar tatimpaguesve me detyrime të papaguara, me qëllim konfiskimin e jo më pak se 50% të qarkullimit të realizuar (por jo më shumë se detyrimi).

Nga DMDTP për vitin 2024 rezultoi se vetëm në një rast është kryer procedura e verifikimit dhe monitorimi në vend të aktivitetit tregtar, tatimpaguesve me detyrime të papaguara, me qëllim konfiskimin e jo më pak se 50% të qarkullimit të realizuar (por jo më shumë se detyrimi).

Kjo situatë vë në pah një boshllëk të rëndësishëm në zinxhirin e ndjekjes së ekzekutimit të masave shtrënguese, duke sjellë nevojën për përmirësimin e mekanizmave të ndjekjes, efektivitetit të administratës tatimore dhe rishikimit të procedurave të aplikimit dhe ndjekjes së masave shtrënguese.

Bazuar në manualin e mbledhjes së detyrimeve të papaguara, miratuar me shkresën nr.11912 prot., datë 29.06.2021, pika 3.3.2, përcaktohet: “.....inspektorët e sektorit të monitorimit dhe zbatimit në terren të masave shtrënguese në DMDTP në rajone, duhet të plotësojnë në mënyrë të vazhdueshme regjistrin e masave shtrënguese të marra ndaj tatimpaguesve dhe të ngarkojnë çdo akt administrative në funksion të masave shtrënguese brenda javës të çështjet e menaxhimit të borxhit të hapur për ndjekjen e mbledhjes së detyrimeve. Ndërkohë që strukturat drejtuese kontrollojnë zbatimin e këtyre detyrave.”, pika 4.2.2, përcaktohet: “...gjithashtu përdoruesi i sistemit, ka të drejtë të ngarkoj në këtë folder, çdo dokument (akt administrative), që administron organin tatimor të cilët kanë të bëjnë me çështje të dhe menaxhimin e mbledhjes së borxhit tatimor..”.

Nga rakordimi i të dhënave nga sistemi C@TS me evidencat e raportimit të masa shtrënguese të vëna në dispozicion nga drejtoria janë konstatuar diferenca, çka tregon se jo të gjitha masat shtrënguese janë hapur në sistem duke ndikuar në kontrole joefektive dhe transparente për procedurat e ndjekura në lidhje me punën e bërë për rikuperimin e borxhit, dhe mungesën e gjurmës së operacioneve të detyrimit të papaguar të klasifikuar si borxh.

Kjo vjen si rrjedhojë e mungesës së personelit në 3 (tre) sektorët e përbërës të tij gjatë gjithë periudhës 2024.

Grupi i auditimit bazuar në mbajtja e regjistrit të masave ligjore shtrënguese të zbatuara konstatoi:

Sektori përgjegjës dispononte një regjistër të miratuar për pasqyrimin e këtyre masave, po nuk është i plotë dhe nuk rakordon me evidencat e raportuara çdo muaj për masat shtrënguese.

Megjithatë, analizimi i dokumentacionit përkatës vërtetoi mangësi të theksuara në përmbajtjen dhe përditësimin e të dhënave të regjistrit, konkretisht:

Në rubrikën "Subjekti" dhe "NIPT" ishin të pasqyruara vetëm një herë për tatimpagues me masa të përsëritura, duke shkaktuar:

- Mospasqyrim të borxheve të reja në periudha të ndryshme;
- Mospërfshirje të masave të përsëritura brenda vitit;
- Mungesë të saktësisimit të periudhës së krijimit të borxhit.

Në rubrikën "Periudha e krijimit të borxhit" dhe "Lloji i tatimit" rezultuan të paplotësuara ose të pasakta.

Në rubrikën "Shuma e detyrimit" nuk ishte e rifreskuar me të dhënat mujore.

Në rubrikën "Marrëveshje për pagesë me këste" nuk korrespondonte me evidencat e marrëveshjeve të lidhura.

Në rubrikën me arkëtime në përgjithësi nuk pasqyrohej asnjë lloj informacioni (e paplotësuar).

Në rubrikën sistemime rezultoi të mos pasqyrohej asnjë lloj informacioni (e paplotësuar).

Në rubrikën "Proces gjyqësor", "Arkëtime", "Sistemime", "Gjendja në fund" rezultuan të paplotësuara.

Në rubrikën gjendja në fund rezultoi të mos pasqyrohej asnjë lloj informacioni (e paplotësuar).

Në rubrikën "Çbllokim bankar" përmbante të dhëna që nuk përputheshin me evidencat e raportuara.

Mosplotësimi i saktë dhe i vazhdueshëm i rubrikave përkatëse në regjistrin e masave ligjore shtrënguese të aplikuara ndaj secilit tatimpagues ndikon në mospërputhje midis evidencave të mbajtura nga drejtoria dhe raporteve periodike të DMDTP, duke ndikuar në cilësinë e raportimeve dhe në mos dokumentimin e gjurmës së auditimit.

Konkluzion: Nga auditimi i dokumentacionit dhe procedurave të ndjekura nga DMDTP në DTM u konstatua se mungon një mekanizëm i mirëstrukturuar dhe funksional për raportimin periodik dhe për analizimin e masave shtrënguese të ndërmarra në funksion të arkëtimit të borxhit tatimor. Moskrijimi i raporteve mujore apo vjetore analitike, të cilat të evidentojnë numrin e masave të zbatuara, ndikimin financiar të tyre dhe subjektet me borxhe prioritare, përbën një mangësi thelbësore në menaxhimin e borxhit dhe në vlerësimin e efektivitetit të veprimeve tatimore. Gjithashtu, mungesa e bashkërendimit ndërmjet sektorëve përgjegjës për ndjekjen e borxhit dhe teknologjisë së informacionit kufizon shkëmbimin në kohë reale të të dhënave dhe ndjekjen horizontale të ecurisë së proceseve. Veprimet e mësipërme janë kryer në kundërshtim me Manualin të Mbledhjes së Borxhit, neni 3.2.1 dhe 3.3, ku përcaktohet domosdoshmëria e raportimit të rregullt dhe të analizës së strukturuar mbi ecurinë e detyrimeve dhe efektshmërinë e masave të marra.

IV. GJETJET DHE REKOMANDIMET

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se gjendja e detyrimeve tatimore të papaguara në fillim të vitit 2024 paraqitet në vlerën rreth 161,743 milion lekë, që i përket një numri prej 4,954,180 rastesh, dhe në fund të vitit 2024 këto detyrime rezultojnë në vlerën rreth 162,213 milion lekë, që i përket një numri prej rreth 4,971,708 rastesh. Detyrimet e shtuara gjatë vitit 2024 janë 470 milion lekë. Arkëtimet paraqiten në vlerën 2,191 milion lekë. Subjekte në proces gjyqësor rezultojnë 5,918 raste me detyrim total 13,178 milion lekë. Subjekte me status aktiv janë në numër 81,830 me vlerë detyrimi 41,552 milion lekë ose 26 % e totalit të detyrimeve të papaguar. Subjektet me status pasive janë numër 120,557 raste, me vlerë 120,983 milion lekë ose 74 % mbi totalin e detyrimeve të papaguar. Për sa i përket gjendjes së stokut

të detyrimeve të papaguara në afat sipas llojit të tatimit, rezultoi se zëri TVSH zë peshën më të madhe në stokun e detyrimeve të papaguara në afat me një vlerë prej rreth 57,009 milion lekë ose rreth 35% të detyrimeve të papaguara. Rajoni Qendror ka detyrimet më të larta krahasuar me rajonet e tjera, për të gjitha llojet e tatimeve, ku është llogaritur detyrimi+ gjoba+ interesi ose 78% të detyrimeve të papaguara. Në total për të gjithë rajonet, principali i detyrimeve tatimore të akumuluarua përben rreth 62 % të vlerës totale të detyrimeve tatimore, penalitetet (gjobat) 33 % dhe kamatëvonesat (interesat) 5 %. Peshën më të madhe të stokut të detyrimit sipas moshës e zënë detyrimet me moshë borxhi mbi 5 vite, të cilat zënë rreth 54 % të totalit të detyrimit. Duke qenë se më shumë se gjysma e detyrimit të trashëguar në vite është mbi 5 vjet, situata paraqitet jo efektive mbi mënyrën e rikuperimit me forcë të detyrimeve të papaguara tatimore, me pasojë rritjen e riskut të parashkrimit të mbledhjes së tyre. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1, faqet 13-54 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

1.1. Rekomandimi: Drejtoritë e Mbledhjes së Detyrimeve Tatimore të Papaguara në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve të analizojnë situatën e krijuar përse i përket rritjes së stokut të detyrimeve të papaguara tatimore vit pas viti, duke ndjekur të gjitha procedurat ligjore me qëllim rikuperimin e detyrimeve të papaguara tatimore në shumën prej 162,213 milion lekë, si dhe të marrë masa për parandalimin e rritjes së mëtejshme të tyre.

Menjëherë

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i ecurisë, performancës dhe efektivitetit të masave të marra për menaxhimin e borxhit tatimor, rezultoi se në datën 31.12.2024, vlera totale e borxhit të papaguar pranë Drejtorisë së Mbledhjes së Detyrimeve Tatimore ishte 162,535,463 mijë lekë, nga e cila 133,009,648 mijë lekë i përkasin detyrimeve me moshë borxhi mbi dy vjet. Të dhënat sipas rajoneve tregojnë një përqendrim të lartë të borxhit në kategorinë e detyrimeve të mbartura prej më shumë se dy vjetësh, përkatësisht:

- Për Rajonin Qendror: Borxhi nga 2 deri në 5 vjet është 22,939,845 mijë lekë (18.4% e totalit), borxhi mbi 5 vjet 59,613,087 mijë lekë (47.7%), dhe detyrimet mbi 10 vjet 24,695,384 mijë lekë (19.8%). Totali i këtyre kategorive përfaqëson 85.9% të borxhit të përgjithshëm.

- Për Rajonin Verior: Borxhi nga 2 deri në 5 vjet është 5,386,714 mijë lekë (31.7%), borxhi mbi 5 vjet 4,512,818 mijë lekë (26.58%), dhe detyrimet mbi 10 vjet 4,643,628 mijë lekë (27.35%). Totali përben 85.63% të borxhit të rajonit.

- Për Rajonin Jugor: Detyrimet nga 2 deri në 5 vjet janë 2,737,314 mijë lekë (22%), borxhi mbi 5 vjet 7,253,712 mijë lekë (58%) dhe mbi 10 vjet 116,593 mijë lekë (1%), duke arritur në total 81.8% të borxhit të rajonit.

Mosha e borxhit të papaguar mbi 2 vjet, me një peshë prej 81.8% ndaj totalit të detyrimeve përfaqëson një risk të lartë të humbjes fiskale, pasi probabiliteti i arkëtimit të detyrimeve është shumë i ulët, për shkak të kohës së gjatë të mbartjes së detyrimeve, me pasojë rritjen e riskut të parashkrimit të mbledhjes së tyre. Sa më sipër veprime në kundërshtim me Ligjin Nr. 9920/2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, nenet 91, 102/1, 102/3 dhe 103; dhe Manualin i Mbledhjes së Detyrimeve Tatimore të Papaguara, pikat 2.3.6, 3.1, 3.2.1, 3.3.1, 3.3.4 dhe 4.1.3. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1, faqet 13-54 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

2.1 Rekomandimi: Drejtoritë e Mbledhjes së Detyrimeve Tatimore të Papaguara në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, të marrin masa për hartimin dhe zbatimin e një plani të posaçëm veprimi për trajtimin e borxhit të vjetër, me fokus në tre kategoritë kryesore të borxhit (mbi 2, 5 dhe 10 vjet), të cilat përbëjnë 81.8% të totalit të detyrimeve, me qëllim arkëtimin dhe marrjen e masave për parandalimin e rritjes së mëtejshme të tyre.

Menjëherë e në vijimësi

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procesit të ndjekjes dhe ekzekutimit të masave shtrënguese nga administrata tatimore, u konstatua se ka mangësi në zbatimin, regjistrimin dhe dokumentimin e këtyre masave. Konkretisht:

- Pjesa më e madhe e masave shtrënguese të vendosura nuk janë pasqyruar në sistemin elektronik C@TS, duke krijuar mospërputhje mes të dhënave të raportuara dhe atyre të regjistruara në sistem.

- Regjistri i masave shtrënguese të mbajtur nga sektori përkatës rezultoi i papërditësuar dhe jo i saktë, me të dhëna si: subjektet, periudha e borxhit, shuma e marrëveshjes me këste, gjendja përfundimtare, etj.

- Nga auditimit i masave shtrënguese u konstatua mospërdorimi i instrumenteve të parashikuara në ligj për mbledhjen me forcë, siç është procedura e konfiskimit të jo më pak se 50% të qarkullimit ditor, pasi sektori i monitorimit dhe analizës për masat shtrënguese nuk ka realizuar analizimin dhe evidentimin e tatimpaguesve me risk të lartë, të cilët duhet t'i nënshtrohen masës së sekuestrimit të xhiros së kasës. Për rrjedhojë, nuk është hartuar dhe dërguar lista përkatëse pranë sektorit të mbledhjes me forcë për ndjekjen e procedurave ligjore, e cila ka sjellë moszbatim të plotë të masave shtrënguese që parashikon legjislacioni tatimor, duke ndikuar negativisht në efektivitetin e procesit të mbledhjes së detyrimeve tatimore të papaguara dhe duke krijuar mungesë në realizimin e të ardhurave të planifikuara.

- Masa si “Vendosjen e masës së sigurimit të detyrimit tatimor (barrë siguruese/hipotekore); Pezullimi i aktivitetit në doganë; Sekuestrimi dhe konfiskimi i pasurisë; Shitja e pasurisë së konfiskuar; Transferimi i detyrimit tatimor palës së tretë dhe përgjegjësia e ortakut/administratorit; Kërkimi i detyrimeve nga palët e treta; Deklarimi i detyrimeve si të pambledhshme Procedurat e falimentit” janë zbatuar në mënyrë të pjesshme dhe jo tërësore, duke rezultuar joefektive në kontrollin dhe reduktimin e stokut të borxhit tatimor.

- Gjithashtu, u konstatua një mosreflektim i saktë i arkëtimit nga masat shtrënguese në evidencat e raportimeve mujore, duke sjellë nënvlerësim të efektivitetit të këtyre masave dhe pasqyrim të pasaktë të detyrimeve të mbetura.

Këto problematika pasqyrojnë dobësi në sistemin e monitorimit, mungesë të ndjekjes nga strukturat përkatëse dhe burime të pamjaftueshme njerëzore, të cilat ndikojnë negativisht në efektivitetin dhe transparencën e mbledhjes së detyrimeve tatimore të papaguara, mungesën e gjurmueshmërisë në procesin e mbledhjes me forcë; raportime jo të sakta mbi borxhin e mbetur dhe ndikimin real të masave të ndërmarra. Sa më sipër veprime në kundërshtim me Ligjin Nr. 9920/2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 91, 92, 102/2 dhe 103 dhe Manualin i Mbledhjes së Detyrimeve Tatimore të Papaguara, pikat 2.3, 3.1, 3.2.1, 3.3 dhe 4.5. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1, faqet 13-54 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

3.1 Rekomandimi: DMDPT të marrë masa për përmirësimin e ndjekjes dhe dokumentimit të masave shtrënguese, duke siguruar pasqyrimin e plotë dhe në kohë të të gjitha masave shtrënguese në sistemin C@TS, me qëllim garantimin e saktësinë së të dhënave për monitorimi dhe raportimi; përmirësimin dhe përditësimin në mënyrë të vazhdueshëm të regjistrimit të masave shtrënguese, duke përfshirë të dhëna të detajuara për secilin tatimpagues dhe për çdo masë të aplikuar; përfshirjen në raportimet mujore edhe vlerat e arkëtuara nga masat shtrënguese, pavarësisht muajit të pagesës/ arkëtimit, për të reflektuar ndikimin real të tyre në uljen e borxhit tatimor dhe rritjen e disiplinës fiskale/përmirësimin e përmbushjes së detyrimeve tatimore.

Menjëherë e në vijimësi

3.2 Rekomandimi: DMDPT të marrë masa për forcimin e kapaciteteve menaxheriale dhe inspektuese në sektorët përgjegjës, të hartohen plane pune mujore me objektiva të qarta për evidentimin dhe referimin e tatimpaguesve me risk të lartë, si dhe të përmirësohet bashkëpunimi ndërsektorial në funksion të zbatimit të të gjitha masave të mbledhjes me forcë.

Menjëherë e në vijimësi

4. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procesit të përgatitjes së evidencave dhe raportimit të borxhit tatimor të papaguara nga Drejtoria e Mbledhjes së Detyrimeve të Papaguara (DMDTP) në Drejtorinë e Tatimeve, u konstatua se mungon një metodologji e standardizuar dhe funksionale për përpunimin, pasqyrimin dhe analizimin e të dhënave mbi borxhin. Përpunimi i të dhënave mbi debitorët realizohet në mënyrë manuale, për shkak të kufizimeve të sistemit C@TS, duke rritur riskun për gabime njerëzore, pasaktësi dhe mungesë uniformiteti në përpunimin e të dhënave, si dhe duke ndikuar negativisht në krahasueshmërinë dhe cilësinë e informacionit ndërmjet institucioneve

- Nga Sektori i Monitorimit dhe Analizës për Masat Shtrenguese në Drejtorinë e Mbledhjes së Detyrimeve të Papaguara, u konstatua se në pasqyrat e debitorëve të raportuara me datë 31.12.2024 nuk janë përfshirë gjobat dhe interesat e llogaritura për mosdeklarimet e detyrimeve të periudhave të konsideruara si “koherente”. Konkretisht, në Rajonin Jugor, është evidentuar një mospërputhje në vlerën 7,281,646 lekë, Rajonin Qendror vlera prej 2,912,724 lekë, Rajoni Verior në vlerën 1,116,121 lekë, që lidhet me tatimin mbi fitimin. Kjo shumë i përket gjobave të aplikuara për mosdeklarimin e deklaratave të tipit 24-A, të cilat nuk janë pasqyruar si detyrim në evidencat përkatëse.

Gjithashtu u konstatua se në evidencat e raportimit, detyrimet e papaguara pasqyrohen **sipas numrit të rasteve dhe jo sipas numrit të subjekteve tatimpaguese**, gjë që ndikon në interpretimin e saktë dhe të plotë të informacionit, si në identifikimin e detyrimeve të prapambetura, ashtu edhe në realizimin e një analize të plotë në lidhje me shpërndarjen dhe madhësinë e reale të borxhit tatimor. Sa më sipër veprime në kundërshtim me Ligjin Nr. 9920/2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 91, neni 102, neni 103 dhe Manualin i Mbledhjes së Detyrimeve Tatimore të Papaguara, pikat 3.3.1, 3.3.4, 3.3.5 dhe 3.3.6. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1, faqet 13-54 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

4.1 Rekomandimi: DPT të marrë masa për përmirësimin e funksionalitetit të sistemit C@TS për të mundësuar përpunimin automatik të të dhënave mbi borxhin dhe për të eliminuar nevojën për ndërhyrje manuale të databazës, DPT të marrë masa që DMDPT në bashkëpunim me drejtorinë e teknologjisë së informacionit ti mundësohet akses dhe analizë të përbashkët të të dhënave në kohë reale, me qëllim raportim të saktë dhe të krahasueshëm ndërmjet strukturave të administratës tatimore.

Menjëherë e në vijimësi

4.2 Rekomandimi: DPT të marrë masat për unifikimin e evidencave të raportimit të detyrimeve të papaguara, ku të përfshihet numrit i subjekteve debitore, në mënyrë që të mundësohet një vlerësim më i saktë të përmbushjes së detyrimeve tatimore nga subjektet dhe i nevojave për ndërhyrje administrative.

Menjëherë e në vijimësi

4.3 Rekomandimi: DPT deri në implementimin e përmirësimeve të sistemit C@TS, të marrë masa për hartimin e udhëzimeve të unifikuara për përpunimin manual të të dhënave, të cilat të sigurojnë trajtim të njëtrajtshëm, të krahasueshëm dhe të dokumentuar në të gjitha rastet. Gjithashtu, të merren masa për forcimin e mekanizmave të kontrollit të brendshëm për të minimizuar riskun e gabimeve njerëzore dhe për të garantuar cilësinë dhe besueshmërinë e informacionit/dhënave të raportuar.

Menjëherë e në vijimësi

5. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi vlerësimin e saktësisë së raportimit të borxhit në datën 31.12.2024, nga testimet e kryera, krahasimi i listës të debitorëve të raportuara me datën 31.12.2024 me listën e subjekteve, të cilat kanë kryer pagesat gjatë muajit janar 2025, në të katër rajonet (Jugor, Verior, Qendror dhe Drejtoria e Tatimeve për Tatimpaguesit e Mëdhenj - DTM) u evidentuan parregullsi në pasqyrimin e detyrimeve tatimore për një numër të konsiderueshëm subjektësh.

Konkretisht janë evidentuar raste të shumta të tatimpaguesve, të cilët kanë kryer pagesa gjatë muajit janar 2025 për detyrime që i përkasin periudhave para dhjetorit 2024 (kryesisht nëntor dhe më herët), por që nuk janë përfshirë në listat/evidencat zyrtare të debitorëve të datës 31.12.2024. përkatësisht:

- Për Rajonin Jugor: 25 tatimpagues për TVSH në vlerën 6,273,511 lekë dhe 100 raste për kontributet e sigurimeve në vlerë 18,607,606 lekë.

- Për Rajonin Verior: 62 raste për TVSH me vlerë 2,354,820 lekë, si dhe 180 raste për kontributet e sigurimeve në vlerë totale 8,608,952 lekë.

- Për Rajonin Qendror: 356 raste për TVSH në vlerë 21,820,081 lekë dhe 570 raste për kontributet e sigurimeve me vlerë 39,338,245 lekë.

- Për Drejtorinë e Tatimpaguesve të Mëdhenj (DTM): 113 raste për TVSH në vlerë 144,446,335 lekë dhe 160 raste për kontributet e sigurimeve në vlerë 138,530,316 lekë.

Situata e përshkruar lidhet me mosdeklarimin sistematik nga ana e tatimpaguesve, të cilët shmangin deklarimin në periudha kur nuk kanë mundësi reale pagese. Kjo praktikë ka kaluar pa u evidentuar për shkak të mungesës së vetëdeklarimit, mungesës së mekanizmave efektivë për identifikimin e mosdeklaruesve dhe mungesës së bashkëpunimit ndërmjet strukturave të DPT-së, përfshirë edhe Drejtorinë e Kontrollit nga zyra dhe Drejtorinë e IT-së, pasi nga databaza, e cila përpunohet manualisht këto subjekte nuk evidentohen si mosdeklarues/debitorë pasi rezultojnë me vlerën 0.

Mungesa e përfshirjes së këtyre subjekteve në listat e debitorëve **ka sjellë nënvlerësim të borxhit tatimor të raportuar në vlerën 174,894,747 lekë për TVSH-në dhe në vlerën 205,085,119 lekë për kontributet e sigurimeve**, duke ndikuar negativisht në pasqyrimin real të detyrimeve të papaguara në fund të vitit; ulje e transparencës dhe besueshmërisë së të dhënave financiare; Kufizim të efektivitetit të masave shtrënguese, për shkak të mosidentifikimit në kohë të subjekteve që shmangin detyrimet; si dhe risk të lartë të përsëritjes së sjelljes së mosdeklarimit, për shkak të penaliteteve të ulëta dhe mungesës së ndërhyrjes së menjëhershme nga administrata tatimore. Sa më sipër veprime në kundërshtim me Ligjin Nr. 9920/2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 91, neni 103 dhe Manualin i Mbledhjes së Detyrimeve Tatimore të Papaguara, pikat 2.3.6, 2.3.7, 3.1, 3.2.1, 3.3.1, 3.3.4, 3.3.5 dhe 3.3.6. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1, faqet 13-54 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

5.1 Rekomandimi: Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve të marrë masat për ngritjen dhe zbatimin e një mekanizmi të integruar identifikimi të tatimpaguesve mosdeklarues në bashkëpunim ndërmjet Drejtorisë së Kontrollit nga zyra, Drejtorisë së IT-së dhe DMDTP për zhvillimin dhe integrimin në sistemin C@TS një funksionalitet automatik për identifikimin e tatimpaguesve mosdeklarues, përfshirë edhe ata që paraqiten me vlerë 0 në deklaratë, por nuk kanë realizuar deklarimin e detyrueshëm ligjor.

Menjëherë e në vijimësi

5.2 Rekomandimi: DPT dhe Drejtoria e Kontrollit nga Zyra të rishikojnë dhe forcojnë praktikat ekzistuese të kontrollit për vlerësimin në kohë të detyrimeve të tatimpaguesve mosdeklarues, duke garantuar pasqyrimin korrekt dhe në kohë të detyrimeve në evidencat zyrtare të borxhit tatimor.

Menjëherë e në vijimësi

5.3. Rekomandimi: DMDTP-të, në bashkëpunim me Drejtorinë e IT-së dhe strukturat e tjera përkatëse, të ndërtojë dhe administrojë një bazë të dhënash të përbashkët për identifikimin dhe monitorimin e subjekteve mosdeklarues, e cila të jetë funksionale në kohë reale dhe e aksesueshme për të gjitha drejtoritë, me qëllim rritjen e efektivitetit në zbatimin e masave shtrënguese dhe përmirësimin e menaxhimit të borxhit.

Menjëherë e në vijimësi

6. Gjetje nga auditimi: Nga auditimit i dokumentacionit të akt-marrëveshjeve për pagesë me këste të lidhura me tatimpaguesit gjatë vitit 2024, u konstatua se:

6.1. Regjistri i mbajtur për akt- marrëveshjet nuk ishte i standardizuar, nuk kishte një format të miratuar nga Drejtoria përgjithshme e Tatimore apo Drejtori i DMDTP, por ishte plotësuar sipas gjykimit të stafit përkatës, pa përmbajtje të plotë dhe elementë kyç për ndjekjen e ecurisë së marrëveshjeve.

Gjithashtu, në regjistrin e vënë në dispozicion mungonte informacioni lidhur me:

- Detyrimin total të subjektit para lidhjes së akt-marrëveshjes, duke pamundësuar raportimin e saktë të detyrimeve përpara lidhjes së marrëveshjeve. Për shkak të mungesës së këtyre të dhënave, grupi i auditimit nuk mundi të verifikonte nëpërmjet databazës nëse vlera e raportuar e pagesës përputhet me 20% të detyrimit total.

- Krijimin e detyrimeve të reja gjatë periudhës së zbatimit të akt-marrëveshjeve për pagesë me këste, mungesë e cila kufizonte mundësinë për ndjekje efektive të performancës së respektimit të marrëveshjeve nga ana e tatimpaguesve dhe krijonte hapësirë për vonesa të qëllimshme në përmbushjen e detyrimeve tatimore, duke cenuar parimin e trajtimit të barabartë dhe të drejtë në fushën fiskale.

6.2. Nga auditimi i dokumentacionit për akt-marrëveshjet e lidhura gjatë muajve nëntor dhe dhjetor 2024, u konstatuan mospërputhje ndërmjet numrit të marrëveshjeve aktive për pagesë dhe regjistrimeve përkatëse në sistemin elektronik c@ts, duke ndikuar në gjurmueshmërinë e marrëveshjeve për shlyerjen e detyrimeve, përkatësisht:

- Për Rajonin Jugor, nga 15 marrëveshje aktive, vetëm 10 rezultojnë të ngarkuara në sistemin c@ts, ndërsa 5 marrëveshje mungojnë në evidencën elektronike.

- Për Rajonin Qendror, nga 55 marrëveshje aktive, janë të regjistruara vetëm 46, duke lënë jashtë sistemit 9 marrëveshje.

- Gjithashtu, u evidentuan pasaktësi në trajtimin e detyrimeve brenda akt-marrëveshjeve, konkretisht:

- Për Rajonin Jugor në një rast nuk është ndarë detyrimi sipas kategorive përkatëse (detyrim, gjobë, interes), dhe në dy raste të tjera mungon ndarja ndërmjet zërave të detyrimeve të gjobë/interes i regjistruar dhe atyre të paregjistruar.

- Për Rajonin Qendror në shtatë raste nuk është ndarë gjoba/interesi në të regjistruar/ paregjistruar.

- Për Rajonin Verior, në tre raste është evidentuar vetëm detyrimi për lidhjen e akt-marrëveshjes, jo i detajuar sipas detyrimit, gjobës dhe interesit, ndërsa në 1 rast nuk është ndarë gjoba/interesi në të regjistruar/ paregjistruar. Sa më sipër veprime në kundërshtim me Manualin e Mbledhjes së Detyrimeve Tatimore të Papaguara, pikat 3.3.1, 3.3.4, 3.3.5 dhe 3.3.6. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1, faqet 13-54 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

6.1 Rekomandimi: DPT të marrë masa për të siguruar pasqyrimin e plotë dhe të saktë të të gjitha akt-marrëveshjeve në sistemin C@ts, përfshirë ngarkimin në kohë dhe në mënyrë të saktë të të dhënave që lidhen me detyrimet përkatëse. Gjithashtu nga çdo DRT që harton aktmarrëveshjet, të merren masat për ndarjen e qartë të zërave financiarë (principal, gjoba dhe interesi), duke siguruar që të gjitha komponentët e përfshirë në marrëveshje të regjistrohen në evidencat zyrtare të raportimit të borxhit tatimor.

Menjëherë e në vijimësi

6.2 Rekomandimi: DPT të marrë masa për hartimin dhe miratimin e një formati standard të regjistrimit për ndjekjen e akt-marrëveshjeve për pagesë me këste, i cili të përfshijë të dhëna të plota mbi subjektin, vlerën totale të detyrimit (përfshirë penalitetet e paregjistruara), arkëtimet, detyrimet e reja të krijuara gjatë periudhës, si dhe informacion mbi respektimin e kushteve të marrëveshjes. Të përgatiten raporte periodike analitike për ecurinë e akt-marrëveshjeve, të cilat të evidentojnë nivelin e zbatimit, rastet e prishjes së marrëveshjeve, rastet e përsëritjes, si dhe ndikimin e tyre në arkëtimet mujore dhe vjetore.

Menjëherë e në vijimësi

7. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se në sistemin tatimor ekzistojnë gjoba dhe interesa të llogaritura nga sistemi ndaj tatimpaguesve, të cilat nuk pasqyrohen në mënyrë të plotë dhe të saktë në

evidencat zyrtare të detyrimeve të papaguara. Këto zëra nuk raportohen në raportin analitik të detyrimeve të papaguara të gjeneruar nga sistemi informatik C@TS, pasi ato konsiderohen si të paregjistruara – domethënë, janë të përlogaritura nga sistemi, por ende të pakontabilizuara në llogaritë individuale të tatimpaguesve. Gjoha dhe interesat përkatëse shfaqen në raportin “Detyrime në kohë reale” dhe reflektohen gjithashtu në urdhërpagesat për pagesën e detyrimeve tatimore. Megjithatë, kontabilizimi i këtyre zërave ndodh vetëm në momentin kur tatimpaguesi kryen pagesën përkatëse. Deri në atë moment, këto detyrime nuk janë pjesë e evidencës zyrtare dhe nuk përfshihen në analizat dhe raportimet standarde të detyrimeve të papaguara tatimore. Mospasqyrimi i këtyre detyrimeve në mënyrë të integruar dhe të sinkronizuar me raportimet zyrtare krijon mospërputhje midis detyrimeve reale dhe atyre të raportuara, e cila ndikon negativisht në: saktësinë dhe transparencën e informacionit fiskal për administratën tatimore dhe tatimpaguesit; vlerësimin e saktë të detyrimeve të papaguara tatimore; evidentimin dhe ndjekjen e duhur të arkëtimeve në kohë për detyrimet përkatëse; përgatitjen e raporteve financiare dhe statistikore mbi performancën fiskale të administratës tatimore.

- Nga analiza e të dhënave mbi gjohat dhe interesat e përfshira në akt-marrëveshjet për këstet e lidhura me debitorët në drejtoritë rajonale të tatimeve, u konstatua se një pjesë e këtyre detyrimeve nuk është pasqyruar në evidencat zyrtare të sistemit tatimor. Konkretisht, gjohat dhe interesat figurojnë në dy zëra të ndarë: të regjistruara dhe të paregjistruara, gjë që ndikon në nënvlerësimin e stokut real të borxhit tatimor. Nga auditimi rezultoi se:

Për Drejtorinë e Tatimpaguesve të Mëdhenj (DTM): Për 12 tatimpagues, totali i gjobave dhe interesave të paregjistruara është 44,486 mijë lekë (gjoha: 33,535 mijë lekë; interesa: 10,951 mijë lekë), duke përbërë 18% të totalit të këtyre zërave, të cilët megjithëse janë përfshirë në akt-marrëveshjet për këste, nuk pasqyrohen në sistem si detyrim zyrtar.

Për Rajonin Qendror: Në 55 raste të analizuara, janë evidentuar gjoha të paregjistruara në vlerën 14,550,475 lekë dhe interesa të paregjistruar në shumën 6,604,258 lekë, çka ka sjellë nënvlerësim të konsiderueshëm të borxhit të raportuar.

Për Rajonin Verior: Për 8 raste janë konstatuar gjoha të paregjistruara në vlerën 553,889 lekë dhe interesa të paregjistruar në shumën 204,980 lekë, duke ndikuar negativisht në saktësinë e të dhënave të raportuara.

Për Rajonin Jugor: Për 12 tatimpagues, totali i gjobave dhe interesave të paregjistruara është 5,295 mijë lekë (gjoha: 3,442 mijë lekë; interesa: 1,852 mijë lekë). Krahasuar me vlerën e përgjithshme prej 10,092 mijë lekë, rezulton se 52.46% e kësaj vlere nuk pasqyrohet në sistemin tatimor, pavarësisht se është përfshirë në marrëveshjet për këste dhe konsiderohet pjesë e detyrimit të arkëtueshëm.

Mungesa e pasqyrimin të këtyre detyrimeve **ka sjellë nënvlerësim të borxhit tatimor të raportuar në vlerën 71,694 mijë lekë**, duke ndikuar negativisht në pasqyrimin real të detyrimeve të papaguara në fund të vitit; ulje e transparencës dhe besueshmërisë së të dhënave financiare. Sa më sipër veprime në kundërshtim me Ligjin Nr. 9920/2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, nenet 91, 102/3 dhe 103; dhe Manualin i Mbledhjes së Detyrimeve Tatimore të Papaguara, pikat 3.3.1, 3.3.4, 3.3.5 dhe 3.3.6. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1, faqet 13-54 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

7.1 Rekomandimi: DPT të marrë masa për garantimin e cilësisë dhe besueshmërisë së të dhënave në sistemin informatik C@TS, duke siguruar që të gjitha gjohat dhe interesat e llogaritura nga sistemi të pasqyrohen dhe të regjistrohen në kohë reale në llogaritë individuale të tatimpaguesve, si dhe të jenë pjesë integrale e raporteve analitike të gjeneruara për përpunimin dhe llogaritjen e detyrimeve të papaguara, duke mundësuar kontabilizimin automatik dhe të menjëhershëm të të gjitha detyrimeve të llogaritura, përfshirë dhe ato që janë aktualisht të paregjistruara; me qëllim përmirësimin e cilësisë së raportimit financiar, transparencën në pasqyrimin e detyrimeve tatimore, duke kontribuar në rritjen e efektivitetit së administratës tatimore.

8. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i kryer në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve dhe në Drejtorinë e Mbledhjes së Detyrimeve Tatimore të Papaguara në Rajone, mbi vlerësimin e ecurisë, performancës dhe efektivitetit të masave të marra në lidhje me borxhin tatimor, u konstatua një mospërputhje ndërmjet përkufizimeve zyrtare të termave dhe praktikave të ndjekura nga strukturat e administratës tatimore. Sipas përkufizimeve të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve në faqen zyrtare të DPT-së, borxh tatimor cilësohet:

-Detyrimi tatimor i vetë deklaruar nga tatimpaguesi dhe i papaguar brenda afatit ligjor.

-Detyrimi tatimor i vlerësuar nga administrata tatimore në përfundim të një kontrolli tatimor, verifikimi apo çdo procedure tjetër ligjore, i papaguar brenda afatit ligjor.

Megjithatë, në Manualin e Drejtorisë së Mbledhjes së Detyrimeve Tatimore të Papaguara mungon një përkufizim i qartë i këtij termi dhe përdoret në mënyrë të përgjithshme “detyrime të papaguara”. Termat “borxh tatimor” dhe “detyrime të papaguara” nuk janë sinonime në kuptimin ligjor e fiskal. Detyrimet e papaguara përfshijnë të gjitha detyrimet që ende nuk janë shlyer, por që mund të mos jenë të maturuara ende për të konsideruar si borxh tatimor.

Përdorimi i paqartë i këtyre termave sjell konfuzion në vlerësimin real të borxhit tatimor, duke penguar ndjekjen e saktë të detyrimeve që kërkojnë masa shtrënguese. Mungesa e një përkufizimi të unifikuar ndikon negativisht në raportimet periodike, vlerësimin e performancës dhe planifikimin e mbledhjes, e cila vështirëson analizën e riskut, ndarjen e borxheve të arkëtueshme nga ato të pashlyeshme dhe përcaktimin e prioriteteve të fillimit të marrjes së masave shtrënguese.. Gjithashtu, krijon paqartësi në komunikimet institucionale dhe raportet zyrtare, duke kufizuar ndjekjen efektive nga audituesit e brendshëm dhe të jashtëm. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1, faqet 13-54 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

8.1 Rekomandimi: Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve të marrë masa të përditësojë dhe harmonizojë përkufizimet e përdorura në të gjitha aktet dhe dokumentet udhëzuese, përfshirë Manualin e Mbledhjes së Detyrimeve Tatimore të Papaguara, duke përcaktuar qartë dhe në mënyrë të unifikuar termi “borxh tatimor”, i ndarë nga koncepti më i gjerë i “detyrimeve të papaguara”, duke u bazuar në përkufizimet zyrtare ekzistuese, me qëllim rritjen e saktësisë në analizat dhe raportimet mbi borxhin tatimor, si dhe përmirësimin e vlerësimit të performancës së strukturave përkatëse.

Menjëherë

Për sa më sipër paraqitet ky Raport Përfundimtar Auditimi.

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT